



# NJË MIJË DITËT E “REPUBLIKËS SË SHTATË”



## Dhe fati i familjes Alizoti

YLLI POLOVINA

2022

**Ylli Polovina**

**NJË MIJË DITËT E  
“REPUBLIKËS SË SHTATË”**

**Dhe fati i familjes Alizoti**

**2022**

**© COPYRIGHT TË GJITHA TË DREJTAT JANË TË REZERVUARA. ASNJË PJESË E KËTIJ VËLLIMI NUK MUND TË RIPRODHOHET, MEMORIZOHET APO PËRCILLET NË NDONJË FORMË A ME NDONJË MJET ELEKTRONIK, MEKANIK, ME ANË TË FOTOKOPJES, NË DISK OSE NË MËNYRA TË TJERA, PËRFSHIRË DHE KINEMANË, RADION, TELEVISIONIN, PA AUTORIZIMIN ME SHKRIM NGA AUTORI.**

## PASQYRA E LENDËS

Bëjmë histori, por e shkruajmë keq  
Dy motrat Alizoti, një brune dhe një bionde  
“Enver-Tito”  
Qe e vërtetë dëshira e Enver Hoxhës për ta bashkuar  
vendin e vet me Jugosllavinë?  
Ndodhi në 20 shkurt 1945  
Si u përdor masakra e 4 shkurtit 1944 për të kryer atë  
Gjyqit Special në prill 1945  
Regjimenti “Kosova”  
Fejzi Alizoti kundër vrasjes me intrigë të Esat Pashë  
Toptanit  
“Fejzi bej, unë do iki, po [Enveri] ty ka me të vra të parin”  
“Jam plak, nuk kanë përse të më vrasin”  
Babë e bir në burg  
Më 3 mars të vitit 1945  
Sipas Enver Hoxhës, i pari ndër të dënuarit prej Gjyqit  
Special ishte Fejzi Alizoti  
17 të dënuar me vdekje  
Gazeta “Bashkimi “ e 15 prillit 1945: pushkatimi u bë  
Kur një të dënuari i këputet litari apo nuk e zë plumbi, i  
falet jeta  
Tre muaj kryetar i Këshillit të Epërm Korporativ Fashist  
Jetëshkrim i një varianti tjetër  
Mustafa Kruja: Hiqe qafe Enver Hoxhën!  
Hasan Alizoti: I kam dhënë fjalën, nuk e bëj dot.

Takimi top sekret në Manastirin e Ardenicës  
Alizotët at e bir, Fejzi dhe Hasan, shpëtojnë Alqi Kondin  
Në Vjenë i kishte luftuar me armë bolshevikët  
Tentativë për ta vrarë  
Ramiz Alia i mbrojtur nga prefekti  
Fejzi Alizoti: Nuk dua ta takoj Miladin Popoviçin  
Loja me sinjalin e tre zjarreve  
Iknin të tjerët, por ai jo  
Në fillim thirrjet “Në litar, në litar!”, më pas shpërthyen  
duartrokitje  
Antiamerikanizmi më agresiv i pas Luftës së Dytë ishte  
jugosllav  
Jakobs shkruan  
Jakobs shkruan sërish  
Enver Hoxha: “A është në interesin tonë ta kërkojmë  
Kosovën?”  
Doktrina anglo-amerikane e frenimit të rusëve  
172 avionë gjuajtës dhe bombardues amerikanë shkelin  
hapësirën ajrore jugosllave  
Hesht deri më 7 tetor 1946, pastaj shpërthen kundër  
anglo-amerikanëve  
Delegacioni jugosllav mbron Shqipërinë  
“Lavdërime të veçanta meritojnë punëtorët e kantierëve të  
Kuçovës”  
Delegati britanik Hud  
Frymë shumë armiqësore kundër Italisë  
“Puljen dhe Istriën e kërkojnë jugosllavët, kurse ne nuk na  
japin Kosovën”  
Edhe dy italianë të dënuar rëndë si agentë anglo-  
amerikanë  
“Organizata tekniko-sabotatore”  
Nga procesverbali i deklaratës në hetuesi të Zyraka Manos

Bianka Balliçi  
U pushkatua shtatzënë  
Ikja e Misionit Politik Amerikan  
Nga fjala e Enver Hoxhës në 12 tetor 1947  
Riza Alizoti dekorohet  
Kitara e Rizait dhe puthja e tij në ballë  
Bie në dashuri me anglezen Kathleen Mary Yeates  
Arrestohet nga italianët  
Refuzon punën në Jugosllavi  
Beratasi Kostaq Stefa thotë: “Po arrestojnë njerëz që kanë  
të bëjnë me amerikanët”  
Enver Hoxha: Nuk i varim ne, varen vetë  
Stalini tha  
Ishte goditje kundër qëllimeve të udhëheqësve jugosllavë  
Studiuesit Bernard Zotaj dhe Marenglen Kasmi thonë  
Stalini: Shqiptarët mund të jenë besnik si qentë  
Shqipërinë si “Republikë të Shtatë” e dëshironte më shumë  
Bashkimi Sovjetik  
Abdyl Këllezi kritikon Jugosllavinë  
Bullgaria “Republika e Tetë”?  
Me veprimtari sabotuese të drejtpërdrejtë  
Nafta nuk del vetë, kërkon pajisje  
Vrasja e Stanisllav Zuberit  
Deklaratë e Koçi Xoxes  
Sipas librit “Vaji i Gurit” të Miranda Haxhisë  
Agjent i spiunazhit amerikan që më 1925!!  
Gjyqi kundër “Grupit të Deputetëve”  
Nuri Huta  
Kërkojmë dënimin e tyre me vdekje  
Enver Hoxha me uniformë ushtarake  
Ne, marangozët dhe muratorët  
Shkëlqesisë së Tij, Mareshallit Josif Broz Tito

Dy telegrame solidariteti për dënime me vdekje

Ditën e enjte, 23 shtator 1947

Raport i ambasadorit italian në Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Sofje, pushkatohet Nikolla Petkov

Telegramin i datës 24 shtator 1947, ora 7 pasdite

Kapiteni i Parë dhe Kapiteni i Dytë

Shoqëritë ekonomike të përbashkëta shqiptare dhe jugosllave

Për nxjerrjen dhe fabrikimin e naftës

“Republika e Shtatë” niste nga përvetësimi jugosllav i naftës

Në hetuesi Mihallaq Zixhishti i pati djegur dhe sytë me cigare

Jugosllavët shkelin kufirin italian

Imagjinoni, shokë

6 tetor 1947, Enver Hoxha flet para popullit në Përmet

Dhe në Berat

7 tetor, Enver Hoxha mban një fjalim përpara punëtorëve të Kuçovës

Sërish 7 tetor 1947, fjalë e mbajtur në një miting në Lushnje

Sovjetikët dhe jugosllavët ofendojnë qëllimshëm Presidentin amerikan

Ambasadori italian në Paris, Pietro Kuaroni

8 tetor, Enver Hoxha thotë para popullit të Elbasanit

Përndjekja nga titizmi i politikanit Dragoljub Jovanović

9 tetor 1947

Përsëri 9 tetor 1947

Më 10 tetor

Italiani Paolo Saxhoti do të akuzonte edhe të tjerët, por megjithatë do të pushkatohej



Rikujtesë

Me varje dhe me vdekje

Varje edhe në Rubik, tre ditë mbajtur në litar

Lyerja me sapun e lakut të litarit, si asnjë mundësi për të shpëtuar

11 tetor 1947, pema e vidhit përballë “Birra Korça”

Diku te një përrua

14 tetor 1947

16 tetor 1947, “Komandanti udhëheqës e organizator i luftës dhe i të gjitha fitoreve të popullit t’onë”

Shifra 39

“Dje, më 20 nëntor 1947 reth orës 19.45 Ministri i Industrisë dhe Kryetari i Komisionit të Planit Nako Spiru aksidentalisht vrau veten”

Mareshalli Tito

“Dje arriti në Beograd Gjen. Kol. Enver Hoxha”

“Rezultate të shkëlqyera të popujve të Jugosllavisë”

Falen 465 të burgosur armiq të popullit

Ditë e mërkurë, 30 qershor 1948

Në Beograd dhe në Tiranë

Një raportim i Tuk Jakovës

Arsyet e vërteta

Andrea Xega

Në emër të popullit je i arrestuar

Diane Jacqueline Belkiz

Fati pa fund i dhimbshëm i Verës

Fejziu junior

Motrat Nezihe dhe Sevim

Vite të gjata heshtjeje

Një ditë përroi pati nxjerrë

Në telefonin e shtëpisë në Camborne të Truros ra telefoni

Të dua shumë!

Fitoi vetëm me një votë më shumë  
Na solli dritë  
Elegji

## **Bëjmë histori, por e shkruajmë keq**

Historia e shqiptarëve, duke qenë edhe ca si ndryshe prej të tjerëve, është e mbushur plot me potere individësh të fortë, shumica manipulues të saj, gënjeshtarë të palodhur. Po ku gjen në të njëjtën kohë edhe akte fisnikërie dhe përgjegjësie të mahnitshme.

Si edhe marrina po aq madhështore.

Shumë e vështirë t'i ndash nga njëra tjetra të qenën me të paqenën, realen me të shpikurën.

Në këtë po aq larmi sa edhe kaos, të duhet të dallosh e të veçosh atë që është vlerë kombëtare, por edhe mirë edukuese, frymëzuese po ashtu.

Sepse me gjithë njollat që bien si zift përvëlues mbi të, historia jonë përbën krijimin tonë më të jashtëzakonshëm e tërheqës.

Historia që kemi prodhuar është kryevepra jonë.

Atje është fiksuar gjithë identiteti ynë dhe bota jashtë nesh, e cila përditë e më shumë po bëhet një “fshat i madh”. Ajo ka mjaft interes të na kontaktojë dhe për pasojë të na njohë, të na dojë dhe vlerësojë.

Prandaj shkrimi i historisë së shqiptarëve nëpër libra apo pasqyrimi në median me pamje, kinematografi dhe televizion e deri në pikturë apo vepra skulpturore, duhet të jetë pika e parë e programit të një rilindjeje kombëtare të vitit dymijë.

Mirëpo e trishtueshmja rezulton me faktin që edhe në këtë thesar të madh kombëtar vazhdon të shkaktohet një rrëmujë tipike.

Duke shpëtuar nga regjimi ku prodhohej vetëm historiografi zyrtare, është kaluar në skajin tjetër, ku kjo, për një mijë arsye e rrethana, nuk ja del të përballojë sistemimin e të vërtetave.

Tani shkruhet shumë dhe secilit çfarë i pëlqen.

Kur pothuaj askush nuk verifikon e përdor ndonjë kriter shkencor apo moral.

Të pajisur me mjete financiare dhe me vullnetin karakteristik të të paditurve, duke e zbuluar urinë e shtypit për sensacione, shtrembërimi i historisë sonë tashmë nuk është aspak më i vogël se gjatë diktaturës së para nëntëdhjetës apo periudhës autoritare të Ahmet Zogut. Vala e madhe e deformuesve vjen sidomos prej disidencës gjoja.

Kokë e këmbë false.

Paturpësisht e manipuluar.

Pseudodisidencë e të përkëdhelurve prej diktaturës së dikurshme, mashtrues të të gjitha kohërave, që po mbushin të tretën e një shekulli dhe nuk po pakësohen.

Por veç fryhen e shtohen.

## **Dy motrat Alizoti, një brune dhe një bjonde**

Një dekadë në parë pata një bisedë të rastësishme me dy motrat Alizoti, Nezihenë dhe Sevimin.

Menjëherë, që në fjalët e para, më lanë një mbresë ngulitëse.

Në vetvete i thirra me emrat dashamirës “Brunia” dhe “Bjondia”.

Me gjithë moshën e epërme (Nezihe kishte lindur në 3 nëntor 1942, kurse Sevimi, ndjesë pastë, në 11 gusht 1944), ato në fytyrë ndriçonin nga hijeshia.

Ishin me një bukuri të dliërë aristokratike.

Me gjithë persekutimin e rëndë politik që familja e tyre pati kaluar në tre breza, këto mbesa të Fejzi Alizotit të pushkatuar nga shteti bolshevik dhe bija të Riza Alizotit, të vrarë nga po ai nëpërmjet varjes me litar, kishin brenda vetes një vetëpërmbajtje.

E cila u vinte nga mirësia njerëzore, por edhe prej diturisë.

Pjesëtarë të familjes me shpenzimet e tyre i kanë botuar gjyshit Fejzi librin “Kujtimet e Jetës sime politike, 1891-1921”.

Ato shënime patën shpëtuar, sepse shumica u botuan në gazetat “Demokratia” dhe “Besa” gjatë viteve tridhjetë. Ndërkohë nuk e gëzuan dot këtë fat kujtime të tjera të tij për vitet 1922-44, sepse të frikësuar nga dy vrasjet njëra pas tjetrës, ato u dogjën nga pjesëtarët e familjes.

Gjatë shkëmbimit të mendimeve Nezihe, mjaft bashkëpunuese me arkivat, tha se po përgatisnin një libër

të dytë të Fejziut dhe se ne të do të vendoseshin të gjitha fjalimet e tij në parlamentet e kohës, si deputet i disa legjislaturave që ishte.

Siç patën bërë edhe tek Kujtimet, edhe në këtë botim nuk do të ndërhyjnë.

Do t'i paraqisnin fjalimet e tij ashtu siç i kishte shqiptuar.

Nuk do t'i hiqnin apo rrumbullakosnin asnjë fjalë.

“Lexuesit le t'i gjykojnë vetë!”, shtuan Neziheja dhe Sevimi.

Sjellje e admirueshme.

Maksimalisht paanësi.

Korrektësë e madhe ndaj historisë.

### **“Enver-Tito”**

Bashkimi Sovjetik dhe Stalini menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore projektuan ngritjen e tre federatave me shtetet që kishin çliruar me anë të Ushtrisë së Kuqe dhe për rrjedhojë po i mbanin nën kontroll.

Njëra federatë ishte ajo mes Polonisë dhe Çekosllovakisë, e dyta lidhte territoret e Hungarisë dhe të Rumanisë.

E treta do të bashkonte fillimisht Jugosllavinë me Bullgarinë dhe Shqipërinë.

Ndërsa dy të parët ranë në përgjumje, i fundit pulsonte gjallëri.

Sidomos ai i tretjes së të gjithë shqiptarëve brenda shtetit jugosllav.

Partia Komuniste e këtij vendi, e kryesuar nga Tito, e kishte nisur një proces të tillë që gjatë luftës, me dy të dërguar të saj të posaçëm, këshilltarë supremë, Miladin Popoviçin dhe Dushan Mugoshën.

I pari që më i çliruar nga prirjet për t'i bërë keq pavarësisë së shqiptarëve, i dyti ndiqte një vijë të kundërt.

Ai që edhe njeri i shërbimeve të fshehta.

Po ashtu edhe i veprimeve të dhunshme e shtypëse ndaj shtresave të pasura, gjithçkaje që nuk ishte komuniste e bolshevike.

Qeveria e Shqipërisë së pas Luftës, që në fillim të vitit 1945, duhej të përballonte dy sfida të mëdha: brenda vendit të forconte autoritetin e vet e veçanërisht të rriste rezen e forcës së pushtetit.

Kjo ishte njëkohësisht edhe ambicia personale e Enver Hoxhës, lufta për kultin e tij.

Sfida e dytë, ajo me jashtë vendin, ndihmonte të parën: duhej realizuar njohja ndërkombëtare e kësaj qeverie.

Ja pse një aleancë me shtetin jugosllav, më të afërtin gjatë viteve të luftës çlirimtare, ishte mjaft i domosdoshëm.

I vetmi më i mundshëm jo vetëm mes fqinjëve.

Edhe pse historishkrues të ndryshëm shprehin mendimin se Josip Bros Tito nuk e kish shumë pasion këtë bashkim dhe prirej më shumë nga ai me Bullgarinë, gjithsesi çështjen shqiptare dëshironte ta zgjidhte sa më shpejt.

Para se Enver Hoxhës në takimin e tij të parë me të në Beograd, 25 qershor 1946, t'ia deklaronte në variantin Kosova të bashkohej me një Shqipëri të pavarur, kishte lënë të kuptohej se qe efektiv edhe ai i bashkimit të Kosovës me Shqipërinë brenda federatës jugosllave, si republikë e shtatë e saj.

Madje dinaku i shquar Tito këtë të fundit dëshironte ta kryente sa më shpejt, pa u vonuar asnjë ditë, para se vendet perëndimore ose Rusia të ndërhyjnë dhe ta pengonin planin.

Një pjesë e madhe e elitës politike komuniste jugosllave e dëshironte këtë zgjidhje të çështjes shqiptare në Ballkan.

Mbështetës së bashkimit me Jugosllavinë kishte shumë eksponentë edhe në Partinë Komuniste të Shqipërisë.

Kjo tezë nuk përbënte pakicë ose, siç është sajuar më pas, qe vetëm kurs i Koçi Xoxes.

Ja pse mori formë të kuptimshme dhe nuk ish aspak slogan i shpikur propagandistik çifti i parullave “Jugosllavi-Shqipëri” dhe “Enver-Tito”.



## **Qe e vërtetë dëshira e Enver Hoxhës për ta bashkuar vendin e vet me Jugosllavinë?**

Sipas procesverbalit të një bisede të kryer në Moskë, në 27 maj 1946, midis Stalinit dhe Titos, kryekomunisti sovjetik e pyeti kolegun e tij jugosllav nëse qe vërtetë dëshira e Enver Hoxhës për ta bashkuar vendin e vet me Jugosllavinë.

Tito ia pohoi.

Nuk ka prova se tek kryekomunisti i sllavëve të jugut ndodhej i dëshiruari i dytë i nxitjes së projektit të humbjes së sovranitetit të Shqipërisë dhe se i pari qe patjetër Enver Hoxha.

Gjithsesi në këtë kuadër analize paraqet rëndësi ajo që mendonte Stalini.

Në bisedën e 27 majit ky e këshilloi Josip Brozin që në planin e realizimit të bashkimit të dy vendeve njerëzit e Beogradit të përdornin sa më shumë frymë miqësore ndaj atyre të Tiranës.

Me pak fjalë Josip Visarionoviçi në parim qe dakord, por me këtë rast na duhet të saktësojmë: pak ditë para se takimi i mësipërm të kryhej, shefi i sektorit të Ballkanit në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Bashkimit Sovjetik, Lavrenti Lavrishçev, kishte përgatitur një raport.

Ai titullohej: “Mbi çështjen e marrëdhënieve jugosllavo-shqiptare”.

Aty Lavrishçev mbronte pikëpamjen se sovjetikët duhej të qenë për një afrim të Jugosllavisë me Shqipërinë, por jo gjer në përfshirje territoriale të kësaj të fundit në Federatë.

Kjo ishte në përputhje me çfarë patën rënë dakord britanikët dhe sovjetikët (sadopak edhe fuqitë e mëdha) që në ndarjen e zonave të ndikimit të pas Luftës Jugosllavia dhe Shqipëria të ndaheshin barabar, nga 50 për qind, mes Perëndimit kapitalist dhe Lindjes socialiste.

Ndërkohë Lavrenti Lavrishev si edhe shefi i tij, Stalini, mendonin se aleati i tyre kyç në Ballkan dhe më tej, nuk mund t'i zgjidhte njëherësh çështjen e ndërlikuar të Triestes me Italinë dhe atë shqiptare, edhe pse kjo e fundit dukej më e lehtë.

## **Ndodhi në 20 shkurt 1945**

Hapi i parë që Tito hodhi për ta afruar Shqipërinë si pjesë të nevojshme të territorit të Federatës së tij sllave, ndodhi në 20 shkurt 1945.

Kur ende nuk pati përfunduar Lufta e Dytë Botërore.

Më parë se të ndodhte kryengjarja e ndarjes të zonave të influencës, takimi i Jaltës.

Në 20 shkurt u firmos një traktat mes dy vendeve.

Prej palës shqiptare qenë Myslym Peza, Bedri Spahiu, Medar Shtylla dhe Omer Nishani, në atë jugosllave bashkë me Josip Bros Titon gjendej edhe Josip Smodlaka, politikan kroat shumë afër tij, në para luftë ambasador në Vatikan, Berlin dhe Madrid.

(Në 1943 ai u bashkua me lëvizjen partizane. Qe i specializuar si këshillues për punët e jashtme. U bë ministër pa portofol në Qeverinë e Përkohshme të Jugosllavisë Federale Demokratike (1945-46).

Ai ishte gjithashtu përfaqësues i Jugosllavisë në Këshillin Aleat për Italinë).

Siç shihet edhe nga përbërja e delegacionit të qeverisë së Beogradit dhe sidomos prej njërës klauzolë të këtij traktati për të cilën historiografia komuniste ka heshtur, Jugosllavia merrte përsipër mbrojtjen e territorit të shtetit shqiptar në rast se ai sulmohej prej një fuqie të huaj.

Duket si mirësi, por në thelb është një mundësi e rrezikshme për të shkaktuar e justifikuar pushtimin.

## **Si u përdor masakra e 4 shkurtit 1944 për të kryer atë Gjyqit Special në prill 1945**

Teksti mbyllës i faqes së parë të “Bashkimit” të 4 shkurtit 1945, theksonte, i futur në kuadrat: “Sot ora 10 Meeting i Madh në Kinema Kosova. Flet Gjeneral Leutenant KOÇI XOXE”.

Dy faqet e brendshme të premtuara si shtesë për numrin special përmbanin shkrimin “Gjaku don gjak”, marrë, siç në krye e paraqet gazeta, prej “Bashkimi i Kombit”, Viti i II, Nr.20, datë 4-II-1944”.

Në fund të kolonës së tretë të tij ka një “SHËNIM: NJË VIT SI SOT këlyshët e zaptonjësit nazifashist xhveshën shpatën dhe vendosën të çfarosnin lëvizjen e një populli që kërkonte të jepte jetën për liri. U derdhën si bisha të tërbuara mbi popullatën e kryeqytetit, vranë, therrnë, varnë e çnderuan...”

Në krah të këtij shkrimi me dy pjesë të montuara, dje dhe sot, Lame Kodra (Sejfulla Malëshova) firmoste një tjetër artikull, i cili titullohej “4 shkurt 1944”.

Ai është krejt i përgjithshëm dhe propagandistik.

Në të nuk ka gjithashtu asnjë të dhënë për çfarë realisht ndodhi në 4 shkurt.

Xhaferr Devën e quan agent të Gestapos, duke e nënkuptuar si shkaktarin numër një të masakrës.

“Bashkimi” i 6 fruer, e martë, me germa shumë të mëdha në krye të faqes së parë boton titullin “Fjala e Gjeneral Leutenant Koçi Xoxe në meetingun e madh të kryeqytetit. I

tërë Populli kujton 4 Shkurtin me Demonstrata të mbëdha në të gjitha qytetet e Shqipërisë”.

Nëntitulli kumton: “Populli kërkon me këmbëngulje dënimin e kriminelëve të luftës-Kërkon nga Aleatët dorëzimin e kriminelëve të arratisur në Itali”.

## **Regjimenti “Kosova”**

Sipas Abaz Alizotit, nipit të Fejzi Alizotit, në afërsi të Hotel Dajtit në Tiranë, në bulevard, ndodhej një barakë me ngjyrë jeshile.

Prej andej rreth mesditës së 3 shkurtit 1944 u dëgjuan disa krisma.

Pas pak ranë të tjera.

Banesa e Alizotëve ishte afër, në krahun tjetër, diçka më tutje nga vendi ku sot janë tre bustet e vëllezërve Frashëri. E tërë familja, përfshi edhe vetë Fejziun mbi shtatëdhjetë vjeçar, ndodheshin në shtëpi.

Dritaret kryesore shihnin nga të dy krahët, sidomos në kahun e bulevardit, pikërisht andej ku ndodhej edhe kasollja e blertë.

Prapa banesës Alizoti qe shtëpia e kryetarit të Partisë Fashiste, Tefik Mborjes.

Përballë gjendej ajo e kolonelit Bilal Nivica.

Kadri Cakrani, i cili banonte në Pallatet Moskate, vend që ishte skaj i Tiranës dhe prej aty niste fusha e hapët, po kalonte ato çaste në bulevard, hipur në një “Fiat”.

Në krah kishte ndihmësin e vet, një të afërm, i cili qe veshur me tesha të Kadriut.

Persona që ndodheshin tek kasollja jeshile, numri i të cilëve fillimisht për fëmijën e vogël Abaz nuk kuptohej dot, shtinë mbi makinë.

Cakranin nuk e kapi asnjë plumb.

Pas një farë kohe nga kasollja e blertë qëlluan sërish. Në shenjë këtë herë vunë të nipin e Xhafer Devës, një njëzetë vjeçar.

E plagosën rëndë dhe i riu, këmbadoras, i përgjakur, mezi mbërriti tek dera e shtëpisë së Xhaferr Devës, e cila ishte aty ku sot pothuaj është shtëpia e dikurshme e Enver Hoxhës.

Tek dera ra në komë, por jetë ndërroi në spital. Pas kësaj, siç në familjen Alizoti e morën vesh pak më vonë, Deva telefonoi kolonelin Bajazit Boletini, të birin e Isa Boletinit, dhe e urdhëroi që bashkë me mbi një mijë të armatosurit që kishte, regjimentin “Kosova”, të bënte “piaca pulita”, pra siç i tha konkretisht: “Bëje tym për çfarë të të dalë përpara!”

Ndërkohë me rrëmujë të madhe dhe rendur me një frymë, në qendër të Tiranës mbërritën një masë e madhe kosovarësh të regjimentit dhe iu drejtuan kasolles jeshile. Ata që ndodheshin fshehur atje dolën prej andej dhe tashmë u pa se qenë katër persona.

Që të katër mbanin pardesy ngjyrë qumështi.

Duke vrapuar për t’iu larguar furisë së ardhësve, ata u futën pas një pingu gurësh që ndodheshin atje ku sot janë dy kullat.

Ky vend gjendej në krahun tjetër të shtëpisë së Alizotëve dhe Abazi i vogël vrapoi tek dritaret e asaj ane.

Prej këtij grumbulli i gurëve që afër, pesëdhjetë metra e shumta, dhe pamja ishte si në pëllëmbë të dorës.

Ata me pardesytë karakteristike shiheshin qartë.

Që të katër qenë të rinj.

Ndërkaq kosovarët e shumtë po u afroheshin me shpejtësi. Nuk i mbanin pushkët krahaqafë, por rripat i patën hedhur mbi zverk dhe të dy krahët vendosur sipër armëve.

Ata bënë ulërima të çuditshme, bërtitje të mëdha, vikama të vërteta.

Në këtë moment doli nga banesa e tij me pistoletë në dorë koloneli Bilal Nivica, duket për të vënë qetësi, por konkretisht kur pa rrëmujën mbeti pa ditur çfarë të bënte. Në të njëjtën kohë ia behu një oficer shqiptar nga të ushtrisë qeveritare.

Ai menjëherë shkoi tek dera e banesës së Alizotëve dhe trokiti.

U tha të zotëve se do të dërgonte dy vetë për të vendosur në tarracën mbi garazhin e shtëpisë së tyre një mitraloz me dy këmbë.

Prej andej sheshi përballë, drejtimi i Hotel Dajtit, shihej krejtësisht.

Të dy ushtarakët e tjerë erdhën menjëherë dhe e instaluan armën e rëndë, por nuk qëlluan.

Në këtë kohë shoferi i të atit të Abazit, prefektit Hasan Alizoti, i cili e kishte emrin Nasi, pati shkuar në furrë të merrte një tepsi me byrek, dhe me të në dorë, tashmë po kthehej.

Oficeri shqiptar sapo e pa iu hodh mbi shpinë, e shtriu për tokë dhe i vuri revolverin në kokë.

“Kush je, çfarë je!”, i klithte.

Ky edhe pse i tha se shoferi i kujt që, u desh të dilte nga shtëpia vetë Hasani për ta bindur oficerin ta lëshonte.

Këto momente në derën e shtëpisë Alizoti pati trokitur një vajzë e re dhe kishte kërkuar ndihmë të fshihej.

Kishte me vete një trastë me bomba dore dhe ata e futën në bodrum.

Ndërkaq kosovarët patën mbërritur tek pirgu i gurëve dhe nisën vrasjen e katër atentatorëve të rinj.



Nuk i qëlluan me plumba, por me kondakë, shkelma dhe grushta, duke ja hedhur secilin njëri-tjetrit që ta vazhdonin masakrimin.

I godisnin dhe i shanin, deri sa më në fund të katër personat e veshur me pardesy ngjyrë qumështi dhanë shpirt.

Pas kësaj përreth ra qetësi.

Alizotët i thanë vajzës që kishin fshehur në bodrum, se tashmë mund të largohet pa asnjë rrezik.

Iku duke i falënderuar të zotët e shtëpisë.

Asnjëherë ajo vajzë, edhe pas çlirimit nga nazigjermanët, nuk u ndje.

Ishte gjallë apo jo, sepse kohë lufte qe?

Apo heshti sepse mbi familjen Alizoti ra e rëndë akuza për bashkëpunim me pushtuesit dhe tradhti kombëtare?

Por as Alizotët nuk e kërkuan për të lehtësuar sadopak gjendjen e tyre.

## **Fejzi Alizoti kundër vrasjes me intrigë të Esat Pashë Toptanit**

Fejzi Alizoti ka qenë, edhe gjatë pushtimit, në qeveritë bashkëpunuese, një ministër finance.

Ndërkohë jeta e tij ka edhe një fragment shkëlqimtar.

Pas dorëheqjes së detyruar të Ismail Qemalit, në administratën e të cilit bënte pjesë, u caktua nga bashkësia ndërkombëtare, Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit, si “drejtor”.

Kjo donte të thoshte kryeministri i ri i qeverisë së Vlorës.

Pra Fejzi Alizoti është kryeministri i dytë i shtetit shqiptar dhe për këtë është heshtur.

Për një simbolikë, përcjellje kuptimi se sa e paudhë është shprishja e historisë dhe sa e bukur e vërteta e saj, kur shkruhet pa ndërhyrë, sa dinjitet i jep ajo në këtë mënyrë identitetit shqiptar, po citojmë nga libri “Kujtimet e Jetës sime politike, 1891-1921)” këtë fragment:

“Në këtë qytet (Vlorë-shënimi ynë) mbeta në Shtëpinë e Ismail beut në Skelë.

E para punë që më ngarkoi Ismail beu ishte studimi i situatës së refugjatëve kosovarë dhe atyre të viseve të Gjirokastrës.

Midis Esat Pashës, Myfit beut dhe Ismail beut mbretëronte një ftohtësi e cila për mua vinte nga egoizmi, ashtu edhe mos heqja e reputacionit të Ismail beut si formues i shtetit shqiptar.

Situatën e keqësonte dhe Syrja bej Vlora nga provokacionet që bënte për të shtuar moskënaqësinë e popullit.

Shqipëri i thuhej kësaj cope që nga Llogaraja afër Sevasterit, në kufi të Tepelenës dhe Vlorës. Afër ndodheshin fuqitë greke në Vjosë.

Ushtria turke ndodhej akoma në viset të tjera të shkelura nga serbët dhe malazezët.

Fuqitë e interesuara për Shqipërinë Austro-Hungaria dhe Italia duke përfituar nga gjendja bënin politikat e tyre. Për të shpëtuar nga intrigat, Isa Boletini, Sali Gjuka dhe Luigj Gurakuqi kishin vendosur që kur Esat Pasha (Toptani) të shëtiste në skelën me urë mbi det ta shtinin dhe ta mbysnin.

Po për këtë duhej të merrnin miratimin e Ismail beut.

Të tre këta më drejtohen mua për t'ia referuar dhe për t'i marrë miratimin.

Unë Ismail beun dhe Esat Pashën i kisha kushëri. Mbroja gjithmonë pikëpamjen e Ismail beut, por nuk isha i mendimit për vrasje.

Megjithatë mendimin e këtyre zotërinjve ia referova beut.

Ai mu përgjigj se në rast do të veprohej me vrasje të njëri-tjetrit për formimin e shtetit shqiptar do merrte valixhet dhe do ikte”.

**“Fejzi bej, unë do iki, po [Enveri] ty ka me të vra të parin”**

Në prill 2017 Fejzi Alizoti i riu (junior), në një intervistë do të pohonte se “Kur Bahri Omari festonte 50-vjetorin e tij, qe i pranishëm edhe Enver Hoxha.

Në një çast erdhi edhe Qazim Mulleti, atë kohë prefekti i Tiranës.

“Zoti Bahri, i tha këtij mënjanë, kanë dalë disa persona që vrasin njerëzit mbrapa shpine.

Ai kunati yt është i pari që i bën këto gjëra.

Thuaqi që të ndalë, se do ta ekzekutoj”.

Më pas në festimin e ditëlindjes erdhi edhe Fejzi Alizoti dhe me që e mori vesh çfarë Qazim Mulleti i kish thënë Bahri Omarit, iu drejtua prefektit të Tiranës me fjalët “Po ti, mer burrë, shkon nëpër festa dhe u prish festën të tjerëve?”

Përgjigja e Mulletit ishte kjo:

“Fejzi bej, unë do iki, po [Enveri] ty ka me të vra të parin”.

**“Jam plak, nuk kanë përse të më vrasin”**

Sipas një varianti shpjegimi, të përgjithshëm dhe pa cituar emra, është shkruar se “Një ditë nga fundi i tetorit të vitit 1944, përpara hotel “Dajti”-t, dy-tre miq të tij (ish-ministra në qeveritë shqiptare të periudhës së Monarkisë) e ftojnë të hipte në automjetin e tyre për t’u larguar nga Shqipëria përpara se partizanët e Enver Hoxhës të hynin në Tiranë.

“Jam plak, 76 vjeç, çfarë do të më bëjnë mua komunistët, nuk i kam bërë asgjë në dëm të Shqipërisë”, iu përgjigj Fejziu miqve të tij që morën rrugën e largimit jashtë Shqipërisë.

Sipas nipit, Abaz Alizotit, Shefqet Verlaci, më i pasuri në Shqipëri, i shkoi në shtëpi mikut të tij dhe i tha drejtpërsëdrejti: “Fejzi, hajde me ne, mos rri këtu!”

I shkoi edhe Safet Libohova, i vëllai i të shoqes së të birit, Hasanit, nënprefekt në Libohovë.

Ky i tha troç: “Eja të ikim, mos rri këtu, sepse komunistët të kanë dënuar me vdekje”.

“Jam plak, nuk kam ku vete”, iu përgjigj Fejziu.

“Para nuk kam, shtoi, do të rri këtu. Çfarë të më gjejë të më gjejë”.

## **Babë e bir në burg**

Në kryeqytet familja Alizoti shtëpinë e kishte tek ura e madhe mbi Lanë afër Hotel Dajtit.

Ato kohë aty kanë qenë disa vila, ku pas lufte banuan Myslim Peza dhe Adil Çarçani.

Jo e para vilë nga rruga, por e dyta, qe strehë e Alizotëve. Në pasditen e 16 nëntorit 1944 shtatë gjermanë patën mbetur të izoluar tek cepi i urës, atje ku ishte baraka me ngjyrë jeshile, e ndërtuar prej italianëve.

Ata vazhdimisht shtinin mbi partizanët.

Prej këtij zjarri të dendur këta nuk guxonin të bënin përpara.

Pastaj mbërriti një çast, sapo kish rënë nata, kur gjermanët e lanë barakën, kërcyen rrugën dhe trokitën në derën e banesës së Alizotëve.

Kërkuan nëse mund të strehoheshin për pak kohë, për t’iu dorëzuar më vonë partizanëve, veç jo në ato momente të nxehta, sepse kishin për t’i vrarë në vend.

Hasani, djali i madh i Fejziut, i cili i dëgjoji pa u hapur derën, u shpjegoi në gjuhën e tyre se nuk mund ta bënte dot këtë gjë.

Në shtëpi kishte fëmijë dhe gra, madje qe edhe babai i tij shumë plak.

Shtatë gjermanët u rikthyen sërish tek baraka jeshile dhe vazhduan të rezistonin.

Mbijetuan deri në mëngjes herët, ora gjashtë, kur më në fund, përballë partizanëve të shtuar numerikisht, u vranë njëri pas tjetrit.

Për aq sa shihej qartë nga dritaret e banesës së familjes Alizoti, nacionalçlirimtarët nisën t’i grabitnin pa i lënë radhë njëri-tjetrit.

U hiqnin unazat dhe kërkonin ç’tu gjenin nëpër xhepa.

Pa shkuar ora shtatë e asaj dite, 17 nëntor, jashtë vilës së tyre Alizotët dëgjuan se si fitimtarët e thërritnin njëri-tjetrin me zë të lartë dhe gëzim: “O Rrapo” apo “O Çelo!”

Ishte e qartë: e kishin marrë qendrën e Tiranës dhe komanda e tyre pati hyrë dhe vendosur në Hotel Dajti.

Atje më i madhi nuk dukej se qe Mehmet Shehu, por Dali Ndreu.

Pa u afruar ora nëntë tek porta e vilës mbërriti një grup partizanësh dhe thanë se do të bënin një kontroll. Gjetën tri pushkë dhe pyetën se të kujt qenë.

Hasani iu përgjigj se njëra qe e trupprojës së tij.

“Kush është i pari i shtëpisë?”, pyetën ardhësit prerë, pa pritur sqarimin e plotë.

Hasani tregoi të atin.

“Epo ky do të vijë me ne”, thanë ata.

“Ky është plak njeri, ndërhyri Hasani, do të vij unë me ju”.

Partizanët e vunë në mes dhe e morën me vete.

Ndërsa iknin rrugës lart, drejt qendrës, Hasani pa gjithkund të vranë dhe kuaj të ngordhur.

Kur iu avitën Kullës së Sahatit dhe Xhamisë, një gjerman i plagosur dhe i shtrirë tek dera e njëres prej godinave, të cilat më pas u bënë ministri të ndryshme, filloi t’i qëllonte me mitraloz.

Hasani i thirri: “Mua më kanë arrestuar, mos qëllo se do të më vrasësh!”

“Ik ti se do t’i vras ata të tjerët!”, u përgjigj gjermani. Atëherë Hasani u thotë partizanëve: “Jepjani vrapit dhe fshihuni pas godinës tjetër!”

Këta ia dhanë vrapit vërtetë dhe shpëtuan nga breshëritë e gjermanit të plagosur.

Kur mbërritën në Hotel Kontinental, i cili ishte fare afër dhe deri një ditë më parë pati qenë komandë e gjermanëve, Hasanin e futën në bodrum.

Në dhomën nëntokësore, ku i ndrynë, ndodhej edhe një oficer nazist.

Ky filloi t’i thoshte me alarm se pas një gjysmë ore hoteli do të hidhej në erë.

“E kam minuar vetë unë!” këmbëngulte gjermani.

Atëherë Hasani nisi t’i binte me grusht derës dhe të thërriste dikë për ta dëgjuar.

Më në fund u shfaq një partizane dhe kjo mezi e kuptoi përse duhej të njoftonte komandantin e saj për ta hapur sa më shpejt derën.

Pas kësaj oficeri vrapoi menjëherë tek eksplozivi dhe ndërsa dolën jashtë ndërtesës të gjithë ata që kishin qenë brenda, e çminoi.

Por Hasanin dhe nga dy të tjerë që sapo i kishin arrestuar, për shkak se burgu akoma nuk qe marrë nga që atje bënte rezistencë kokëfortë Osman Gazepi me disa nga të vetët, i mbyllën tek Pallati i Zogut.

Këtu kishte miell dhe sheqer dhe ardhësit gjetën mundësi, për t’u ushqyer, të paktën të gatuanin hallvë.

Ndërkaq Hasani nuk e dinte që një orë pasi e patën arrestuar, një grup partizanësh kishte rihyrë në shtëpinë e tyre dhe marrë të atin.

Ishte ftohtë dhe plaku shtatëdhjetë e gjashtë vjeçar mori me vete një brucë.



Bashkë me të tjerë të porsa arrestuar i vendosën për më shumë se një javë në tarracat e Pallateve Moskate.

Natë e ditë me roje ngryseshin e gdhiheshin, ndërkaq nuk u mor vesh kurrë nëse hanin ndonjë copë bukë.

Më në fund ndërtesa e “Burgut të Ri” qe marrë dhe i futën të gjithë në birucat e tij.

Në një kaush të madh u gjetën pranë njëri-tjetrit, për një rastësi apo qëllim të prapë të pushtetarëve të rinj, baba e bir.

### **Më 3 mars të vitit 1945**

Gazeta “Bashkimi”, midis të tjerash do të shkruante:  
“Sot Fejzi Beu me shokë gjendet në shportën e tradhëtisë, gjendet para gjyqit të drejtësisë, para gjyqit të popullit, i akuzuar ashtu siç është “tradhëtar e fytyrë fëlliçur”. Krokodili i paskrupullt, e i paturp, i pa “parole d’honneur”, siç është Fejzi Alizoti – sot ka rënë në usta!”

**Sipas Enver Hoxhës, i pari ndër të dënuarit prej Gjyqit Special ishte Fejzi Alizoti**

Në librin e tij me kujtime “Kur u hodhën themelet e Shqipërisë së re”, 1984, Hoxha thotë:

“Që të vihej në vend dhe të realizohej drejtësia dhe hakmarrja popullore ndaj gjithë atyre që kishin lyer duart e tyre me gjakun e bijve më të mirë të vendit, që kishin djegur, që kishin shërbyer si bashkëpunëtorë të pushtuesit, duke shitur gjithçka, po mbi të gjitha atdheun, në mars të vitit 1945 u hap gjyqi special.

Para tij dolën një numër i madh kriminelësh e tradhtarësh, në mes të cilëve anëtarë të qeverive kuislinge, krerë të Ballit Kombëtar, spiunë të fashizmit, si: Fejzi Alizoti, Tefik Mborja, Shuk Gurakuqi, Bahri Omari, Kolë Tromara, Hilmi Leka, Ibrahim Biçaku e të tjerë”.

### **17 të dënuar me vdekje**

Angazhimi i Fejzi beut në politikë duke u zgjedhur si deputet i Gjirokastrës dhe ministër i Financave në qeverinë e Iljaz Vrionit në vitin 1927, si dhe sekretar shteti e ministër i Financave në qeverinë pro pushtuesve italianë të kryesuar nga Shefqet Vërlaci në vitin 1941, veçanërisht i emëruar edhe si Komisar i Jashtëzakonshëm i qeverisë shqiptare në Kosovën e bashkuar me Shqipërinë, secila sipas rëndesës së vet politike, të gjitha u bënë shkak që ai të dilte para “Gjyqit Special”.

Pas mbarimit të këtij gjyqi, më 13 prill të vitit 1945, prokurori Bedri Spahiu dhe kryetari i gjyqit Koçi Xoxe, kërkuan dënimin e tij me vdekje.

Kështu në listën e gjatë prej 60 personash Fejzi Alizoti që i pari në radhën e 17 personave të dënuar me vdekje.

Pas kësaj dite atë dhe të tjerët i vunë në një qeli përballë birucës së mëparshme.

Hasani me të atin shkëmbenin mesazhe me copëra të vogla letre, të cilat i futnin nëpër brimat e kyçit të dyerve sa herë që dilnin për të shkuar në banjë.

Abazi, i biri i Hasanit, i ruan ende ato copëra pusullash tronditëse.

Djali tjetër i Fejziut, Rizai, erdhi që nga Kuçova ku punonte gjeolog në naftënxjerrje për ta takuar babanë e vet.

Priti dy ditë, por nuk e mundësuan.

Thuhej se të dënuarit i kishin zhvendosur në një banesë afër, shtëpi e tregtarit Ali Qorraliu, ku u patën dhënë për të ngrënë e sidomos pirë që të ishin të trullosur.

**Gazeta “Bashkimi “ e 15 prillit 1945: pushkatimi u bë**

“Kryesia e Këshillit Antifashist, në mbledhjen e pardjeshme, refuzoi kërkesën që kishin paraqitur 17 kriminelët e luftës, të dënuar me vdekje nga Gjyqi Special i Kryeqytetit.

Pas rrëzimit të tij, mbrëmë në darkë, ora 19/19', të 17 të dënuarit u ekzekutuan.

Të ekzekutuarit janë: Fejzi Alizoti, Terenc Toçi, Aqif Permeti, Gustav Murdez, Koço Kote, Hilmi Leka, Reshit Merlika, Beqir Valteri, Javer Hurshiti, Dik Çami, Ismail Golemi, Zef Kadarja, Tasim Bishqemi, Shyqyri Borshi, Daut Çarçani, Kol Tromara dhe Bahri Omari”.

## **Kur një të dënuari i këputet litari apo nuk e zë plumbi, i falet jeta**

Referuar Abaz Alizotit, të nesërmen, në ditën e 14 prillit “të shtatëmbëdhjetët e dënuar me vdekje i hipën në kamionë dhe i dërguan tek Kodra e Priftit.

Atje i ekzekutuan.

Pesëmbëdhjetë prej tyre i zunë plumbat, ndërsa arbëreshi Terenc Toçi pati rënë përdhe pak çaste më parë nga një infarkt zemre.

76-vjeçarin Fejzi Alizoti plumbat e kishin marrë njëri në pëllëmbë të dorës së djathtë dhe tjetri e kish fshikur në grykë, në fikthin e gurmazit.

Qe rrëzuar dhe ato çaste u dëgjua zëri i tij i dobët, tek i thoshte Bedri Spahiut: “Edhe zoti nuk më dënoi me vdekje. E drejta ndërkombëtare e ka që kur një të dënuari i këputet litari apo nuk e zë plumbi, i falet jeta”.

Por tjetri nxori pistoletën dhe pasi i kërciti fjalët “Nuk ka falje për ty”, e qëlloi në kokë”.

Sipas Mërgim Korçës, ky referuar korrektësisht rrëfimit të meshtarit të pranishëm në vendin e pushkatimit, “Zjarr” thirri komandanti i skuadrës dhe breshëria e predhave i shtriu për tokë të 17 viktimat.

Mbas breshërisë, heshtje.

Heshtja e vdekjes.

Dhe heshtjen e theu zëri i mekur i Fejzi Alizotit: “Zoti më mëshiroi. Falmëni tani edhe ju sipas ligjeve ndërkombëtare”.

Avitet Bedri Spahiu, e shikon ashtu të shtrirë për tokë të pafuqishëm, të llangosur me gjak e pluhur e të lidhur me dy të vdekur, dhe me zë sadisti që kurrë me gjak nuk u ngop, i thotë: “Nuk njohim ne ligje ndërkombëtare, ne njohim ligjet tona”.

Nxjerr koburen e tij dhe qëllon gjithë mllef atë kufomë akoma të gjallë!”

Në pas vitet nëntëdhjetë të shekullit të shkuar, pas një autokritike publike të kryer nga Bedri Spahiu përse u lidh me komunizmin, ka pasur një solidaritet politik prej vetë të persekutuarve nga regjimi i para nëntëdhjetës, si edhe prirje për ta fshehur të vërtetën e rolit të tij në këtë vrasje të Fejzi Alizotit.

Ky manipulim është lehtësuar edhe prej heshtjes që për këtë episod ka mbajtur vetë Bedriu.

Modeli i këtij falsifikimi pak a shumë është i tillë: “Thuhet se në çastin e pushkatimit, ku ai që i veshur me një pardesy të bardhë, ishte i vetmi që nuk e kapën plumbat. Pas disa gërvishtjesh të lehta, ai iu drejtua skuadrës së pushkatimit, duke u thënë: “E shikoni që më fali edhe plumbi, sepse jam i pafajshëm...”?!

Pas fjalëve të tij, një oficer i lartë që më vonë mori gradën e gjeneralit, iu afrua dhe e qëlloi disa herë me pistoletë në kokë”.

Edhe një hollësi tjetër në strategjinë e heshtjes.

Thuhet pa u provuar se “Me fillimin e largimit të gjermanëve nga Tirana në vjeshtën e vitit 1944, Fejzi Alizoti, lajmërohet prej Bedri Spahiut që të largohet nga Shqipëria, se ishte në listën e njerëzve që do të pushkatoheshin”.

Ndërkohë shmangien e rolit të tij në rivrasje prokurori i përgjakshëm i gjyqit special, e baraspeshon me pohimin e



fakteve të tjera nga skena e ndodhur: “Kur komandanti i skuadrës së pushkatimit dha urdhër, një lëvizje u pa në rreshtin e të dënuarve, të cilët i kthyen krahët tytave të armëve, siç kish urdhëruar komandanti.

Vetëm një njeri pati guximin t’i kundërvihet urdhrit: “Jo, askush nuk duhet t’i kthejë krahët nga tytata, pasi pas shpine vriten vetëm tradhtarët.

Këtë do ta vërtetojë historia”.

Ky ishte Bahri Omari...”

## **Tre muaj kryetar i Këshillit të Epërm Korporativ Fashist**

Sipas enciklopedisë online Wikipedia, Fejzi Alizoti emrin e plotë e kish Mehmed Fevzi bej Alizoti.

Në të shkruhet:

“U lind në Janinë më 8 korrik 1869, burime të tjera thonë se u lind në Gjirokastër më 22 shtator 1876. Qe i biri i Hasan bej Alizotit dhe i Zybejte hanëmit nga Kokajt e Delvinës.

Mësimet e para i mori në qytetin e lindjes, ndërsa shkollën e mesme (ryzhdijen) në Janinë

Shkollimet e larta i vijoi në Shkollën Civile e Administratës Mbretërore "Mülkiye-i-Sehahané" për ekonomi dhe administratë civile më 1891.

Dërgohet me shërbim administrativ në Bejrut ku dha edhe mësim historie e gjeografie në idadien e vendit.

Më 1897-99 nisi si kajmekam ndër provincat arabe, ndërsa më pas më 1899-1903 në sanxhaqet e Vilajetit të Selanikut.

Më 1903-1904 qe mytesarif në Tripoli, më pas në Ortogrul pranë Stambollit (1904), në Korçë (1904-1906), Sardi të Kurdistanit (1906), sekretar i përgjithshëm i Ejaletit të Tripolitanisë (pranverë 1907) dhe zëvendësisht vali i Biltizit (1906-1908), mytesarif i Prizrenit (1908-1909), Urfa (1909), Ajdin (1910-1911), Sakez në Egje (1911-1912), Prishtinë (1912) deri kur pushtohet gjatë Luftës së Parë Ballkanike nga serbët.

Pas një qëndrimi në Shkup dhe Selanik, shkoi në Stamboll. Në prill të 1913 u dëbua nga Stambolli si anëtar i Komitetit Shqiptar të atjeshëm dhe shkoi në Rumani.

Në qershor shkoi në Shqipëri dhe në periudhën shtator-nëntor 1913 u caktua prefekt i Beratit, ku zëvendësoi Mehdi bej Frashërin.

Në periudhën nëntor 1913 e deri në janar të 1914 shërbeu si ministër i Punëve të Brendshme dhe zëvendësisht i Luftës. Në periudhën janar-mars 1914 qe i ngarkuar Drejtor i Përgjithshëm i administrimit gjatë periudhës kalimtare në Vlorë pas dorëheqjes së Ismail Qemalit.

Me grupin e kryesuar nga Esad pashë Toptani, me Aziz pashë Vrionin, Mehdi bej Frashërin dhe Mehmet pashë Derallën pritën dhe i uruan mirëseardhjen Princ Vedit.

Nga maji deri në shtator 1914 ishte këshilltar në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Në shtator 1914 ishte kryeadministrator i Shkodrës. Malazetët kur e pushtuan për së dyti qytetin, e arrestuan dhe burgosën në korrikun e 1915. Me ardhjen e ushtrive austro-hungareze janarin e 1916, u lirua dhe drejtoi drejtorinë e financave gjatë pushtim-administrimit austro-hungarez po në Shkodër deri më 1918.

Si drejtor financash ishte në të njëjtën kohë edhe drejtor i përgjithshëm dhe kryesonte mbledhjet e administratës qendrore shqiptare. U largua nga Shkodra pas marrjes në administrim të qytetit nga francezët bashkë me krerët e tjerë që shërbyen në administratën qendrore, për t'i shpëtuar arrestimit.

Më 1918 mori pjesë në punimet e Kongresit të Durrësit si delegat i Beratit, prej ku doli ministër i Financave në qeverinë e Turhan pashë Përmetit.

Në qeverinë 1927 drejtuar nga ministri i Drejtësisë Petro Poga, gjatë periudhës së Republikës Shqiptare, shërbeu si ministër i Financave dhe zëvendësisht i Punëve të Jashtme. Pas pushtimit italian, në prill 1939 u caktua ministër sekretar shteti i Financave në qeverinë e Shefqet Vërlacit, deri kur u zëvendësua nga Qemal Vrioni pas afro një vit pasi paraqiti vetë dorëheqjen.

Me propozimin e Vërlacit, u emërua Ministër Shteti në Mbretërinë Italiane.

Më 3 qershor 1939 qe ndër firmosësit e Statutit Themeltar të Mbretënisë Shqiptare të rishikuar nga italianët. Më 1940 merr pjesë në Komisionin për Rivendikimet Shqiptare, të kryesuar nga Xhemil Dino, Mustafa Kruja, Dhimitër Berati, Tahir Shtylla dhe vetë Alizoti.

Vetë do të kryesonte një nëndarje, atë të Komitetit për Rivendikimet në ish Vilajetin e Manastirit ose Komitetin e Maqedonisë dhe do të ishte anëtar i Komitetit për Rivendikimet në ish Vilajetin e Shkodrës ose Komiteti i Kufijvet me Malin e Zi.

Më 11 qershor 1941 Delegata e Kufinit ku ishte pjesë Alizoti, priten në audiencë nga Musolini. Më 8 korrik 1941, duke zëvendësuar Carlo Umiltá, emërohet komisar civil i qeverisë shqiptare në Kosovë. Këshilli i Ministrave i Shqipërisë pasi e emëroi që në takim Duçja.

Alizoti me këtë emërim, ushtronte në viset e Kosovës, Dibërës dhe Strugës, pushtetet civile që i ishin dhënë qeverisë shqiptare nga Duçja më 29 qershor 1941.

Dhjetorin e 1941 me administrimin e qeverisë Kruja, posti i komisarit civil pezullohet dhe krijohet Ministria e Tokave të Lirume, në krye të së cilës u emërua Tahir Shtylla.

Me dekret mëkambësor të Alberto Parianit, më datë 1 qershor 1943 u emërua anëtar i Këshillit Qendror të

Ekonomisë Korporative, ndërkohë që më 16 maj 1943 qe kryetar i Këshillit të Epërm Korporativ Fashist, deri më 4 gusht 1943.

U arrestua në nëntor të 1944, u dënua me vdekje nga Gjyqi Special, 1945”.

## **Jetëshkrim i një varianti tjetër**

Referuar një jetëshkrimi të përhapur në internet për opinionin publik “Fejzi Alizoti u shkollua duke mbaruar “Mylqijen”, e cila nxirrte kuadro për administratën otomane, si jurist, financier e diplomatë, etj.

Në atë shkollë, që asokohe njihej si një nga më prestigjozet e Turqisë, ishte shkolluar dhe babai i Fejziut, Hasan Alizoti, i cili qe diplomuar në Fakultetin e Drejtësisë së kryeqendrës së Perandorisë Osmane dhe pas përfundimit ushtroi profesionin e avokatit po në Stamboll”.

Po ashtu: “Pas një kohe të gjatë shërbimi në vende të huaja më në fund, në 1905, Porta e Lartë e emëroi me detyrën e prefektit në qytetin e Korçës.

Këtu punoi deri në vitin 1912.

Gjatë kësaj periudhe Fejzi Alizoti u kujdes shumë për arsimin shqip dhe arriti të rihapë një shkollë shqipe që ishte mbyllur prej turqve.

I lidhur ngushtë me shumë nga patriotët më të dëgjuar të asaj krahine si edhe duke shfrytëzuar postin e tij zyrtar, Fejziu liroi nga burgjet shumë shqiptarë që mbaheshin të izoluar nga kisha greke.

Në këtë kahe Fejzi Alizoti shkoi edhe më tej: u bë një nga organizatorët kryesorë të vrasjes së një prifti grek, i cili nxiste qëllime shovene ndaj dy qyteteve kryesore të Shqipërisë së Jugut: Korçës dhe Gjirokastrës.

Pas vrasjes së priftit grek, filluan dhe konfliktet e para të Fejziut me qeverinë turke”.

Më tej thuhet: “Pasi kishte marrë pjesë në ngritjen e flamurit në Gjirokastër dhe zgjedhur delegat për në Kuvendin e Vlorës që shpalli pavarësinë kombëtare, në qeverinë e Ismail Qemalit Fejziu u caktua në postin e sekretarit të shtetit”.

Në vijim: “Me rënien e qeverisë së Durrësit, ai u vendos në Shkodër, ku së bashku me Luigj Gurakuqin, ishte pjesë në një komision financiar në administratën e atij qyteti, ku dhe arrestohet më pas prej serbëve.

Me ndërhyrjen e forcave austro- hungareze, Fejziu mundi të lirohet nga arresti i serbo-malazezëve, dhe me krijimin e qeverisë së Lushnjes në vitin 1920, ai nuk bashkëpunoi me të.

U largua nga Shqipëria dhe u vendos në Itali.

Në vitin 1924, me rikthimin e Zogut në pushtet, Fejzi Alizoti u rikthye në atdhe dhe u zgjodh si deputet i Gjirokastrës. Në 12 shkurt 1927 në kabinetin e drejtuar nga Iljaz Vrioni mori detyrën e ministrit të Financave”.

Në një paragraf tjetër të këtij jetëshkrimi të përhapur për Fejzi Alizotin këmbëngulet se “Pas pushtimit të Shqipërisë nga Italia fashiste në prillin e 1939-ës, Fejziu për afro dy vite u largua krejtësisht nga politika. Në vitin 1941, pas shumë ndërhyrjesh të disa miqve të tij politikanë të njohur, ai pranoi detyrën e Komisarit të Jashtëzakonshëm për Kosovën, të cilën ia ngarkoi qeveria e Mustafa Krujës.

Në këtë detyrë ai punoi për tre vite dhe me kapitullimin e Italisë, u kthye në Tiranë”.

**Mustafa Kruja: Hiqe qafe Enver Hoxhën!**

**Hasan Alizoti: I kam dhënë fjalën, nuk e bëj dot.**

Enver Hoxha midis shumë të pathënave të jetës së vet politike nuk ka rrëfyer edhe një takim që ka kryer në fshehtësi me kryeministrin Mustafa Kruja, mandati i të cilit u ushtrua prej janarit 1942 deri në të njëjtin muaj të vitit të mëpasshëm.

Qe ky i fundit, i cili ndërmori një cikël takimesh sekrete me drejtues të Lëvizjes Nacionalçlirimtare për të gjetur një kompromis mosluftimi me ta.

Kontakti me Hoxhën, duke qenë se nuk ka burime të shkruara dhe na është pohuar vetëm nga i biri i Fejzi Alizotit, Abazi, ka të ngjarë të ketë ndodhur në periudhën e gjysmës së parë të motit 1942.

Ndoshta kur ende E. H. nuk qe zgjedhur shefi i partisë së komunistëve dhe po ashtu i armatës së saj partizane.

Takimi mes Mustafa Krujës dhe Enver Hoxhës u bë në rrugën me emrin e sotëm “Siri Kodra”, në shtëpinë e një komunisti nga Libohova, emrin të cilit Abaz Alizoti nuk e mban mend.

Ai pohon se, sipas asaj që i ka thënë i ati, Hasani, i cili ishte ndërmjetësi i realizimit të këtij kontakti, të dy bashkëbiseduesit vajtën në takim natën, në errësi të plotë dhe biseduan gjatë.

Megjithatë nuk ranë dakord për asgjë.

Qenë në pozita shumë të kundërta.



Kur Mustafai u ngrit të ikte dhe po dilte nga dera e dhomës, saktësisht duke filluar të zbriste shkallët poshtë, i tha Hasan Alizotit turqisht këto fjalë: “allta kellanen xhani ceksen”.

Këto donin të thonin: “Të fundit i daltë shpirti”.

Kjo në turqisht nënkuptonte “Hiqe qafe këtë!”

Ndërkaq Hasani iu përgjigj:

“I kam dhënë fjalën, nuk e bëj dot”.

## **Takimi top sekret në Manastirin e Ardenicës**

Hasan Alizoti ishte këtë kohë prefekt i Beratit, pra nëpunës i caktuar prej vetë kryeministrit Mustafa Kruja.

Një ditë atij i erdhi në rrugë private një mesazh tepër i veçantë, as i imagjinuar.

E kërkonte për një takim “kokë më kokë” një oficer madhor britanik.

Anglezi me këtë rast i pati përcjellë edhe temën e bisedimeve: “Problemet e kohës”.

Ai e analizoi gjatë ofertën e rrezikshme po ta merrnin vesh eprorët e tij e sidomos ata të strukturave fashiste italiane, përfshi edhe Mëkëmbësinë, por duke qenë adhurues i demokracive perëndimore, pranoi.

Takimi u krye në Manastirin e Ardenicës.

Oficeri i lartë britanik erdhi deri në bregdet me një mjet lundrues, ndoshta i zbarkuar prej ndonjë nëndetëseje.

Prej andej mbërriti në Manastir.

Nga çfarë tha dhe si u soll gjatë bisedës shfaqti personalitetin e një njeriu të kulturuar. Fliste frëngjisht dhe me këtë gjuhë që të dy shkëmbyen mendime rreth luftës që po zhvillohej jo vetëm në Shqipëri.

Në fund anglezi shqiptoi: “Misioni im është t’ju rekomandoj: të lutem shumë, mos ia prish qejfin Lëvizjes Nacionalçlirimtare!”

Pas kësaj u ndanë secili në punën e vet.

Ndërkaq më vonë Hasan Alizoti do të merrte vesh se po ai ushtarak, si edhe të tjerë, nuk e kishin të parin këtë takim të fshehtë me prefektë të veçantë shqiptarë.

Gjithsesi kjo bisedë e bëri Hasanin të kuptonte më mirë se për shtetet perëndimore antifashiste ato çaste bashkëpunimi me grupet e armatosura të inkurajuara apo të drejtuara edhe prej komunistëve, kishte një rëndësi shumë jetike, madje edhe për vetë ekzistencën e demokracisë.

Përballja strategjike me bolshevizimin hë për hë duhej pezulluar, sepse Hitleri dhe Musolini, po ta fitonin Luftën e Dytë Botërore, do ta mbytnin demokracinë kudo ndodhej, në Londër apo deri edhe në Uashington.

Tashmë e patën kryer këtë dhunë në Paris, Vjenë, Pragë, Varshavë, Bruksel...

Falë këtij takimi Hasan Alizoti kuptoi kahun e lëvizjes së ngjarjeve në ato momente dhe vendosi të ndjekë këtë kurs, me pak fjalë të zbatojë çfarë i propozoi oficeri i lartë britanik.

## **Alizotët at e bir, Fejzi dhe Hasan, shpëtojnë Alqi Kondin**

Në Berat edhe më parë kësaj bisede ai qe munduar të qëndronte jashtë përplasjes mes palëve, në një pozicion baraspeshimi, përherë për të siguruar një jetë të qetë të banorëve dhe sipërmarrjeve të tyre ekonomike.

Megjithatë ndaj të rinjve të rezistencës antifashiste, komunistë ose jo, shprehte anësim.

Kur ndodhte që ata binin pre e italianëve, sidomos e një drejtuesi lokal karabinerie, individ i egër, marshallit Antonio Martini, mendohej t'i shpëtonte nga thonjtë e tij.

Në një rast iu bë krah, në mos edhe nismëtar, edhe vetë i ati, Fejzi Alizoti.

Në atë kohë Fejziu qe emëruar në Kosovë si komisar civil për tokat e çliruara. Mbante afër edhe dy oficerë të milicisë shqiptare.

Njëri ishte Xhevat Libohova, kunat i të birit, Hasanit, domethënë vëllai i gruas së këtij, Hiqmetes.

Tjetri oficer milicie shoqërues i Fejziut qe Xhelal Staravecka.

Që të dy ishin njerëz të aksionit dhe sapo Hasani nisi punën e prefektit në Berat, i ati ia dërgoi në përforcim.

Kur PKSH vendosi që nga Tirana për të organizuar rininë e saj antifashiste në Berat të dërgonte Alqi Kondin, njerëzit e marshall Martinit e arrestuan që të nesërmen e mbërritjes. Ia filluan menjëherë torturimin e rëndë.

Atëherë Fejzi Alizoti e telefonoi të birin dhe i tha: “Bëj çfarë të duash, por Alqin, djalin e doktor Kondit, ta lirosh!”

Hasani thirri menjëherë drejtuesit e kuesturës dhe tërthorazi e pyeti për të arrestuarit që kishin.

Ata i përmendën edhe emrin e Alqi Kondit.

“Me çfarë pune të ndaluar është marrë?”, i pyeti.

“I ka pohuar vetë fajet që të gjitha”, iu përgjigjën shkurt.

“Atëherë ma bini këtu ta pyes njëherë vetë!”

Ia sollën të nesërmen.

Porsa hyri në zyrën e prefektit Alqi nderoi me dorën lart si fashist. Ishte me shumë plagë e shenja të gjakosura. Mezi qëndronte në këmbë.

“Ule dorën”, i tha Hasan Alizoti.

Kondi i ri u hutua, sepse nuk e priste këtë prej një prefekti të emëruar nga fashistët.

“Je shqiptar, shtoi ky, dhe ne kemi nderim tjetër”.

Në vijim Hasani e këshilloi që sapo të rikthehej në burg të kërkonte një vizitë mjekësore për gjendjen e tij shumë të rëndë shëndetësore.

“Madje bërtit, i tha, thirr me të madhe deri sa të të sjellin doktorin”.

Alqi Kondi veproi si i tha prefekti dhe fitoi mundësinë të shtrohej në spitalin e burgut të Tiranës. Hasani informoi të atin për sa kishte bërë si edhe lajmëroi njerëzit në kryeqytet të Lëvizjes Nacionalçlirimtare.

Këta shumë shpejt organizuan arratisjen e Alqi Kondit. Ndërkaq pas takimit sekret me oficerin e lartë britanik Hasan Alizoti kishte nisur komunikimet e fshehta me drejtuesit lokalë të rezistencës së armatosur antifashiste: Kahreman Yllin, Mestan Ujanikun, Gjin Markun, Zylyftar Veleshnjën, Ramiz Aranitasin.

Iu krijuan mbresa pozitive prej tyre.

Kahreman Ylli iu duk njeri jashtëzakonisht i kulturuar, Mestani vërtet i pashkollë, por mjaft të drejtë. Gjin Markun e vlerësonte si inteligjent, kurse Ramiz Aranitasin si shumë trim dhe të ndershëm.

## **Në Vjenë i kishte luftuar me armë bolshevikët**

Hasan Alizoti në rininë e tij e pati luftuar me armë bolshevizmin.

Kjo kishte ndodhur në Vjenë, menjëherë pas triumfit të revolucionit proletar dhe marrjes nga kryengritësit rusë të Pallatit të Dimrit në Shën Petërsburg.

Në 1914 i ati i pati siguruar Hasanit një bursë në Vjenë për të studiuar në një shkollë ushtarake.

Atje e zuri edhe Lufta e Parë Botërore me situatën kaotike që ajo solli.

Në 1917-1918 u shtri nëpër Evropë dallga e revolucionit rus.

Pasi “të kuqtë” morën Budapestin, pra një pjesë të perandorisë austrohungareze, kjo dallgë erdhi edhe në Vjenë.

Një pjesë e vendasve u ngritën të rrëzonin Habsburgët dhe për të mbrojtur pallatin e tij nga revolucionarët bolshevikë i nxorën të gjithë studentët ushtarakë të armatosur, përfshi edhe bursistët shqiptarë, të cilët ato çaste qenë dhjetë vetë me kujdestar një major austriak.

Pas goditjes me armë kryengritësit u tërhoqën dhe Vjena nuk u bë një Shën Petersburg i dytë.

## **Tentativë për ta vrarë**

Kur mbaroi Lufta e Parë botërore, në 1918, Hasan Alizoti përfundoi studimet ushtarake.

U kthye në atdhe dhe detyrimisht do të hynte në punë, sepse ndryshe nuk jetonte dot.

Fillimisht shërbeu si doganier në një pikë më në veri të Morinës, e cila lidhej me Kosovën.

Më pas u transferua në Ministrinë e Financave dhe në këtë dikaster qeveritar mbërriti deri sekretar i ministrit Kol Thaçi.

Më vonë, viti 1927, do të emërohej sekretar i dytë në Legatën Shqiptare në Athinë.

Në vijim u emërua prefekt në Ballsh, qytezë ku zuri miqësi të madhe me të atin e Liri Belishovës, ndërsa kjo e fundit qe fëmijë në vitet e para të shkollën fillore.

Në familjen e Abaz Alizotit edhe sot ruhet një foto e nxënësve të vegjël të Ballshit.

Pas këtij qyteti Hasani u transferua nënprefekt në Libohovë, më tej nënprefekt në Zerqan.

Pastaj hyri Italia.

Pushteti i ri fashist e mbajti ca kohë pezull, por dalloj shpejt se kishte të bënte me një nëpunës të lindur për punë administrimi shtetëror dhe i ofroi qytetin e Beratit.

Në skaj të vitit 1942 italianët e pikasën që në luftën e tyre ndaj Lëvizjes Nacionalçlirimtare në Berat diçka nuk shkonte.



U shkoi në mendje edhe mundësia e një dopioloje të prefektit.

Ndërkaq në Vlorë gjendja u dukej edhe më e dalë prej duarve të tyre. Prefekti i këtij qyteti, Lele Koçi, i përkushtohej më shumë se Hasan Alizoti mbështetjes së rezistencës të lidhur me LNÇI.

Prandaj dërguan në Vlorë mercenarin Halil Alia, i cili kreu terror mbi qytet, vrau në 2 janar 1943 patriotin e famshëm Qazim Koculi si edhe prefektin Lele Koçi.

(Siç dihet i revoltuar nga këto vrasje të frymëzuara prej komandës së pushtimit kryeministri Mustafa Kruja dha dorëheqje të menjëhershme).

Ndërkaq njësitë mercenare të fashistëve italianë, pasi përgjakën Vlorën dhe rrethinat që mbështetnin Lëvizjen Nacionalçlirimtare, iu kthyen qendrës tjetër të rezistencës: Beratit.

Sapo hynë në qytet filluan të shtinin në ajër me mitraloza dhe pastaj drejt rrugëve.

Në kushtet e këtij terrori që mund të përfundonte si në Vlorë, me të vrarë të tjerë, në mos edhe me jetëshuarjen e tij, një togë italiane të drejtuar nga një toger, i cili kishte për detyrë mbrojtjen e institucioneve, Hasan Alizoti e përdori për të frenuar mercenarët e Halil Alisë.

Një autobлиндë që këta e kishin në dispozicion, e vuri para prefekturës dhe lajmëroi popullatën që të mos kishte qarkullim njerëzish. Kur vërtet jashtë banesave nuk kishte gjë të gjallë dhe përdhunësit kur panë autobлиндën i rralluan të shtënat, në rrugën kryesore u shfaq një siluetë.

Ishte Hiqmetja, e shoqja e prefektit.

Familja Alizoti e kishte shtëpinë tek banka, pra pothuaj në fillim të rrugës kryesore që të çonte pas të paktën treqind metrave deri tek ndërtesa e prefekturës.

Bashkëshortja, e alarmuar se mos kryhej edhe në Berat vrasja e qëllimshme e prefektit, tek ecte fillikat i ndjeu plumbat që filluan t’i binin fare afër.

Ishin vetëm dy mercenarë që e kishin këtë zell.

Sapo i pa ku qenë struktur, prapa Hotel Kolombos, u bërtiti: “Po të jeni trima u shtini burrave!”

Pas kësaj ata ja mbathën.

Një çast më pas në mbrojtje të Hiqmetes vrapuan disa ushtarë italianë.

## **Ramiz Alia i mbrojtur nga prefekti**

Ditë më parë se të ndodhte dorëheqja e Benito Musolinit në Romë dhe shumë shpejt këtë ngjarje do ta pasonte edhe kapitullimi i Italisë, në Berat u kryen me të pabesë disa arrestime dhe vrasje të antifashistëve komunistë më të spikatur.

Mes tyre edhe të disa emrave të njohur si Margarita dhe Kristaq Tutulani, Kristaq Capo po ashtu, të tjerë.

Ishte goditja më e madhe që autoritetet fashiste të pushtimit i dhanë njërës prej qendrave më të mëdha të rezistencës në Shqipëri, siç qe ky qytet.

Prej operacionit të rrufeshëm të arrestimeve, më pas edhe të pushkatimeve, një pakicë qëndrestarësh mundën të shpëtojnë.

Mes tyre edhe Ramiz Alia.

I dërguar nga Tirana ai qe i ngarkuari i PKSH-së për rininë. Si ia doli të mos binte prehë e karabinierëve të stërvitur për gjurmime dhe prangime të kundërshtarëve të regjimit ka mjaft variante.

Njërin prej tyre e rrëfen edhe vetë Alia në librin e tij të kujtimeve “Jeta ime”.

Në të pasi thotë se në Berat ishte që “nga gjysma e muajit prill deri në fund të muajit qershor 1943”, saktëson “isha gjysmë ilegal”.

Më tej Ramiz Alia shkruan se “Për të mos rënë në sy të policisë fashiste, detyrohesh të mos rrija gjithnjë në të njëjtën bazë”.

Pastaj: “...në fund të muajit qershor, vetëm dy muaj e gjysmë pasi gjendesha në Berat, rreziku i arrestimit u bë konkret. Në ditën e fundit të qershorit, autoritetet fashiste shpallën shtetrrëthimin e qytetit, ndërsa policia u lëshua nga të katër anët për të arrestuar kuadro drejtues të Partisë dhe të Rinisë, si edhe aktivistë të tjerë të Lëvizjes”. Për arrestimin e Kristaq dhe Margarita Tutulani Alia shkruan se “Ata qëndruan në qytet dhe u strehuan në baza të sigurta, të njohura prej tyre. Megjithatë pas disa ditësh, policia arriti t’i zbulojë se ku fshiheshin ata dhe i arrestoi. Më 7 korrik, duke i transferuar nga Berati për gjoja në kampin e përqendrimit në Porto Romano, rrugës, në afërsi të Kavajës, pushtuesit fashistë i vranë mizorisht”.

Ndërkaq në libër nuk ka asnjë rresht për një rrethanë tjetër, rreth të cilës Alia nuk foli dhe shkroi asnjëherë.

Sipas Abaz Alizotit, i ati i tij, prefekti Hasan, që kur i ngarkuari për rininë i PKS-së u nis për në Berat, mori prej udhëheqësve të saj porosinë për ta lehtësuar të vepronte dhe njëkohësisht ruajtur prej goditjes së italianëve.

Kështu ai thirri një shkruar publik të qytetit dhe i besoi Ramiz Alinë si me gjoja statusin e të punësuarit në zyrën private të këtij.

Në atë pozicion i riu komunist do të që formalisht dhe shkruar publik nuk duhej t’i kërkonte llogari se ku ndodhej.

Ndryshe, rrëfen Abaz Alizoti, prefekti i pati thënë: “Po e hape gojën do të të ikë koka!”

Nga thëniet e të atit, Abaz Alizoti mban mend se ky shkruar publik e kishte mbiemrin Gallani dhe nuk mund të jetë tjetër njeri veç Vangjel Gallanit, i cili këtë kohë që avokat dhe kishte me të vërtetë një zyrë në qendër të qytetit të

Beratit.

Ndërkohë duhet thënë se kur ndodhën arrestimet e krerëve të rezistencës së Lëvizjes Nacionalçlirimtare në qytet, Hasani nuk ndodhej këtu, por me një vizitë pune në Romë. SIMI, i cili këtë kohë rezultoi që ia njihte prefektit punën e fshehtë dhe e mbante të izoluar sa të mundte, goditjen e kishte dhënë ndërsa ky nuk ndodhej.

Kur Hasan Alizoti u rikthye nga Roma mbeti i tronditur nga çfarë i kishin punuar në passhpinë dhe shkoi që të nesërmen në burg.

Atje fashistët ende mbanin të arrestuar shumë veprimtarë të tjerë të rezistencës.

I takoi të gjithë një për një e qeli për qeli.

Ata nuk kishin bërë gjeste të rënda ndaj trupave të pushtimit, por kryesisht “gjëra rinie”, veprime më shumë romantike.

Dha urdhër dhe u liruan të gjithë.

Kjo bëri bujë.

## **Fejzi Alizoti: Nuk dua ta takoj Miladin Popoviçin**

Kur Popoviçi në pranverë të vitit 1943 iu afrua ilegalisht Beratit, i tha Gjin Markut se donte të takonte Hasan Alizotin.

Takimi mes komunistit të rëndësishëm jugosllav me shumë ndikim në PKSHP dhe prefektit u krye pa asnjë problem. Nga biseda Alizoti do të dilte me përshtypje të mirë për Popoviçin.

Por pas pak kohe i erdhi kërkesa se ky i fundit dëshironte të takonte edhe të atin.

Hasani i ktheu përgjigjen se këtë gjë nuk mund t’ja premtonte: “Babai ka qëndrimin e tij, por unë do t’i them”. Kur çfarë kërkonte Miladini ia komunikoi të atit, Fejziu u mendua një çast, por më në fund ra dakord.

Takimi do të bëhej në banesën e Hasanit në Berat dhe që të dy, në kohë të ndryshme, në ditën e caktuar u ndodhën aty.

Veç qëndruan në dhoma të ndryshme.

Kur u duk se gjithçka ishte gati për bisedën dypalëshe, Fejziu papritmas refuzoi: “Unë nuk do ta takoj, sepse po e takova do të merret vesh e çfarë mbetet për mua kur të dalë një gjë e tillë”.

## **Loja me sinjalin e tre zjarreve**

Komanda ushtarake italiane, e vendosur në kazermat e Uznovës në Berat, në fund të pranverës 1943, pas disa disfatave që kishte pasur për ta shfarosur qëndresën e armatosur kundër tyre, vendosi të bënte një operacion të madh spastrimi në krahinën e Therepelit.

Në mbledhjen planëzuese tepër sekrete, duke qenë se ishte brenda detyrave dhe kompetencave të tij të ngarkuara nga qeveria e Tiranës si edhe nga vetë Mëkëmbësi italian në Shqipëri, mori pjesë edhe prefekti Hasani.

Pasi u vendos edhe data e ora e fillimit të operacionit ndëshkimor, u shtua me këtë rast edhe një veprim plotësues.

Nga ajri njësitë partizane dhe territoret mbështetëse të tyre jo vetëm do të mitraloheshin, por prej avionëve ushtarake do t'u hidheshin edhe bomba.

Me që do të ish prag mbrëmjeje kjo lypte saktësim të qartë të vendndodhjes së trupave italiane në mënyrë që mbi to të mos binte asnjë ciflë predhe.

Me këtë qëllim, për t'i ndihmuar pilotët të mos gaboheshin, u ra dakord që komanda ushtarake italiane në territorin e trupave të saj të ndizte tre zjarre të mëdhenj, të dallueshëm lehtësisht jo vetëm prej flakëve, por edhe tymit.

Kështu avionët italianë duhej të mitralonin dhe t'i hidhnin bombat në krahun tjetër, ku ishte zona e errët.

Këtë kod sinjalesh Hasan Alizoti ia dha Gjin Markut, në zonën partizane të të cilit të tre zjarret mbrojtës u përflakën më shpejt.

Vetëm më pas, pas hutimit, u ndezën zjarret tek italianët. Hataja ndodhi menjëherë: shumicën e bombave pilotët nisën t'i lëshonin mbi trupat e tyre.

Abazi pohon se pasojat e kësaj vetëkërdie, edhe pse fëmijë i vogël, i kishte përjetuar personalisht në Berat, duke i parë nga dritarja e shtëpisë, e cila ishte buzë rrugës kryesore.

Poshtë saj ecnin, të shpartalluar si mos më keq, me uniformat shqyer, italianët, tek lëviznin pa mundur dot të qëndronin në rresht për të shkuar drejt vendndodhjes së garnizonit të tyre në Uznovë.

Ngjarja e rëndë u hetua menjëherë nga italianët dhe u hamendësua se nxjerrësi i sekretit të tre zjarreve duhej të qe i vetmi shqiptar i ndodhur në topmbledhje: prefekti.

Pas fillimisht krijimit të dyshimit, veçanërisht Shërbimi i Fshehtë Ushtarak Italian, SIMI, ishte më se i bindur që tradhëtuesi qe Hasan Alizoti.

Kështu vendosën vrasjen e tij me anë duarsh të tjera, larg Beratit.

I nisën izolimin.

I vunë roje të shumta, gjoja për siguri, në hyrje të godinës së prefekturës.

“Të mos hyjë njeri!”, bërtisnin këta italisht.

Atëherë Hasani foli në telefon me kryeministrin Eqrem Libohova dhe me të atin, Fejziun dhe ata e këshilluan të largohej sa më shpejt nga Berati e të rikthehej në Tiranë. Kështu u organizua me dy kamionë të mbushur me shqiptarë, skraparllinj kryesisht, që morrën rrugën për në kryeqytet.

Rrufeshëm italianët e gjetur në befasi nga kjo lëvizje e



Hasan Alizotit lajmëruan bashkëpunëtorin e tyre të punëve më të zeza, Isa Toskën.

I thanë t’u dilte në rrugë, para Urës së Kuçit, dy kamionëve dhe t’i asgjësonte me armë.

Por këtë pritë e mori vesh kryetari i komunës Fier-Shegan, një karbunaras, Ahmet Shehu, mik i Fejzi Alizotit.

Ky mori forcat e tij dhe shkoi tek Ura e Kuçit.

I tha Isa Toskës: “Ik, se ndryshe këtu vete gjaku gjer në gju!”

Krimineli i njohur i mori të vetët dhe iku.

Nuk e zbatoi porosinë që i dhanë italianët, ata që edhe e patën armatosur deri në dhembë.

### **Iknin të tjerët, por ai jo**

Pas Beratit Hasan Alizoti do të emërohej prefekt në Shkodër.

Pastaj erdhën gjermanët dhe këta, edhe pse e liruan nga detyra, gjithsesi vijuan ta pagonin.

E konsideronin kandidaturë në rezervë.

Kështu nuk kaluan vetëm muajt e fundmotit 1943, por pothuaj tërë viti pasardhës.

Në shtator ata që kishin mbështetur pushtuesit për të luftuar komunistët, përfshi edhe qeveritarë, filluan të iknin jashtë vendit.

Hasani veproi si Fejziu: nuk iku.

Ku ta linte vetëm të atin?

### **Në fillim thirrjet “Në litar, në litar!”, më pas shpërthyen duartrokitje**

Kur Hasan Alizoti në fund të prillit, bashkë me nëntë të tjerë, doli në gjyq në sallën e kinemasë në vendin ku sot ndodhet selia e Partisë Socialiste, kryetar gjyqi qe Bilbil Klosi dhe prokuror Gjon Banushi.

Populli në sallë thërriste pa pushim: “Prefekt i fashizmit në litar!”

Kur u dhanë dënimet nëntë qenë me pushkatim, kurse kur u shpall ai i Hasanit prokurori shqiptoi: “Ka qenë prefekt i fashizmit dhe bashkëpunëtor i okupatorit, por e shikoj në lidhje të ngushtë me krerët e Lëvizjes Nacionalçlirimtare”. Pas kësaj salla e madhe e kinemasë e mbushur plot filloi të duartrokiste.

Tre vjet burg kërkoi Gjon Banushi, dy e bëri Bilbil Klosi.

Në 29 nëntor 1945 u njoftua amnistia e parë dhe një ndër ata të ndodhur në fillim të listës ishte Hasan Alizoti.

Kështu bëri gjithsej një vit burg.

Pjesa tjetër e jetës së tij janë shpërngulja me forcë nga Tirana për në Durrës dhe më në fund 30 vjet qëndrimi në Lushnjë, me punë në një nga sektorët e fermës, në Savër kryesisht.

Në 1978 Hasan Alizoti ndërroi jetë, kurse e shoqja, Hiqmetja, në 1985.

## **Antiamerikanizmi më agresiv i pas Luftës së Dytë ishte jugosllav**

Në shtator 1945 u firmos një traktat mes Shqipërisë dhe Bashkimit Sovjetik.

Sipas tij, qeverisë së Tiranës do t'i jepej furnizim me grurë si edhe kompetenca teknike, përfshi edhe specialistë, për nxjerrjen e naftës dhe të mineraleve.

Vetë Shqipëria në shkëmbim do t'i jepte Moskës duhan, bakër, fruta të thata dhe vaj.

Për ndonjë furnizim me naftë të rusëve nuk bëhej fjalë.

Që gjatë vitit 1945 në qeverinë e Enver Hoxhës kishte filo-jugosllavizëm duket qartë, por filo-sovjetizmi është shumë më i zbehtë.

Madje këto çaste filo-sovjetizmi nuk do të thoshte patjetër edhe frymë anti-perëndimore.

Stalini bënte shumë kujdes me anglo-amerikanët, dy aleatët e mëdhenj të tij gjatë Luftës së Dytë.

Ishin titistët, komunistët jugosllavë, në vijë të parë kundër amerikanëve.

## **Jakobs shkruan**

Në 29 janar 1946 përfaqësuesi amerikan në Shqipëri, J.E.Jacobs i shkruante Sekretarit të Shtetit në Departamentin e SHBA:

“...Unë paraqes ndjenjën jo shoqërore në rritje të regjimit këtu, kundrejt SHBA”.

## **Jakobs shkruan sërish**

Në 28 shkurt 1946 J.E.Jacobs i shkruante Sekretarit të Shtetit në Departamentin e SHBA gjithashtu: “Duket qartë se Shqipëria është kthyer në shtet satelit të BS dhe Jugosllavisë...”

Këto dy shtete shpresojnë që Shqipëria të pranohet anëtare e OKB, duke i shtruar kështu një tjetër votë bllokut sovjetik.

Në rast se në sesionin tjetër të OKB-së, Shqipëria nuk pranohet, atëherë ajo do të kthehet në një njësi të Federatës Jugosllave.

Unë jam i sigurt se shumica e shqiptarëve kundërshtojnë infiltrimin e dominimit sovjetik, si dhe bashkimin me Federatën Jugosllave”.

**Enver Hoxha: “A është në interesin tonë ta kërkojmë Kosovën?”**

Në këtë shkurt 1946, në një plenum të PKSH-së boshti i mëparshëm i marrëdhënieve ndërkombëtare të Shqipërisë lëvizi edhe më shumë në favor të jugosllavëve.

Në dhjetor të këtij viti, në një plenum tjetër, kursi i ri u çimentua.

U hodhën themelet e një bashkimi ekonomik mes dy vendeve.

Është çasti kur Enver Hoxha shqipton fjalët direktive: “A është në interesin tonë ta kërkojmë Kosovën?”

Kjo gjë nuk është progresiste...

Jugosllavia demokratike është më progresiste se ne...

Është në interesin tonë që Jugosllavia të jetë e fortë”.

## **Doktrina anglo-amerikane e frenimit të rusëve**

Ende nuk qe mbushur një vit nga përfundimi i Luftës së Dytë Botërore, ishte shkurt e mars 1946, kur vendet e fuqishme perëndimorë hartuan doktrinën, e cila u quajt politika e frenimit të rusëve.

Ishte shkurt kur u hartua “Telegrami i gjatë”, i të Ngarkuarit me Punë të SHBA në Moskë, George Kennan.

Qe mars kur u mbajt në Universitetin e Fultonit në shtetin e Misurit të Amerikës fjalimi i famshëm i Winston Churchill, i cili paralajmëroi se mes Perëndimit dhe Lindjes ishte ngritur një perde ndarëse.

U quajt Perde e Hekurt.

Kishte filluar konflikti i Luftës së Ftohtë.

Doktrina e Kenan ishte edhe më aktive se ajo e kryeministrit anglez.

Thelbi i saj u shpreh me fjalët: “Gjithkund ku gjykohet e nevojshme duhen bërë përpjekje për të kufizuar fuqinë sovjetike”.

Kjo doktrinë është e gjithëpushtetshme edhe sot.



## **172 avionë gjuajtës dhe bombardues amerikanë shkelin hapësirën ajrore jugosllave**

Bindja se politika jugosllave e Titos ndaj qytetit të Triestes për ta futur tërësisht brenda territorit të vet, nuk ish gjë tjetër veç zbatim i drejtpërdrejtë i asaj sovjetike, i nxiti amerikanët të kërkojnë një mënyrë për të treguar forcë në zonën kufitare mes Jugosllavisë, Italisë dhe Austrisë.

Avionët amerikanë filluan të fluturonin në territorin jugosllav në korridorin që të çonte nga Udine në Vjenë dhe anasjelltas.

Midis 16 korrikut dhe 8 gushtit 1946, jo më pak se 172 gjuajtës dhe bombardues shkelën hapësirën ajrore jugosllave.

Në 9 gusht avionët jugosllavë e detyruan një C-47 amerikan të ulej afër Lubjanës.

Në datat 19 dhe 21 të të njëjtit muaj në qiellin e Jugosllavisë u diktuan edhe dy avionë të tjerë.

Këtë herë ngjarja pati përfundim tragjik.

Të dy aeroplanët luftarakë amerikanë u goditën dhe u rrëzuan.

Në SHBA njerëzit shpërthyen në britma zemërimi.

Përshtypja e përgjithshme e popullit në SHBA ishte se pas këtij incidenti të rëndë qëndronte Bashkimi Sovjetik, i cili që i interesuar të mbante një gjendje tensioni në jetën e politikës ndërkombëtare.

Prandaj edhe mendonin unanimisht që kundërveprimi i Shteteve të Bashkuara të ishte i menjëhershëm, i qartë dhe i vendosuri.

Dhe kështu ndodhi.

Qeveria amerikane i ndaloi qytetarët e saj të hynin në Jugosllavi dhe i bënë Titos një protestë diplomatike, e cila kishte formën dhe përmbajtjen e një ultimatumit.

E vërteta që se sovjetikët dhe Stalini nuk e miratonin aspak sjelljen e ashpër të jugosllavëve, sepse gjykonin se veprime të ngjashme mund të sillnin në rajone të gjëra, pse jo edhe në të gjithë botën, pasoja të rënda dhe të paparashikueshme.

Ndërkohë, me gjithë protestat formale të qeverisë jugosllave, shkeljet ajrore të aviacionit luftarak amerikan vijuan tërë muajin e gushtit.

Në 30 gusht i Ngarkuari me Punë i Jugosllavisë në Uashington, i drejtoi Sekretarit Amerikan të Shtetit një protestë të prerë mbi vijimin e shkeljeve të hapësirës ajrore dhe mos pranimin e asnjë faji nga qeveria e Republikës Federale Jugosllave për rrëzimin e avionëve amerikanë.

Uashingtoni u përgjigj nëpërmjet ambasadës së vet në Beograd.

Kërkonte që qeveria e mareshallit Tito të shpallte ndjesën e vet.

Në të njëjtën ditë Josip Brosi e bëri këtë hap, por duke këmbëngulur në të drejtën e Jugosllavisë për të vepruar ashtu siç bëri.

### **Hesht deri më 7 tetor 1946, pastaj shpërthen kundër anglo-amerikanëve**

Kaloi tërë viti 1945, shumica e atij 1946, dhe Enver Hoxha nuk shqipton apo shkruan ndonjë fjalë mospëlqimi ndaj anglo-amerikanëve.

Qe muaji shtator 1946 kur në fjalimin e tij, si edhe në bisedën me gazetarët gjatë dhe pas punimeve të Konferencës së Paqes në Paris, Hoxha u soll po njëlloj.

Fjalët e para kundër anglo-amerikanëve i tha vetëm më 7 tetor 1946, në raportin e tij “Mbi aktivitetin dhe detyrat e reja të Frontit”, të mbajtur në Mbledhjen e Dytë të Këshillit të Përgjithshëm të Frontit Demokratik”.

Ja fragmenti i parë: “Gjatë periudhës së luftës populli ynë konstatoi shumë gjëra që s'ishin në rrugën e aleancës antifashiste nga ana e rretheve reaksionare anglo-amerikane, që orvateshin të përçanin bllokun dhe të ngadalësonin luftën.

Këto veprime të këtyre rretheve reaksionare kishin reperkusionet edhe te ne, ku me anë të shtypit, të radios, ose me anë agjentësh, ata orvateshin të shpëtonin tradhëtarët dhe kuislingët nga llumi ku kishin rënë kokë e këmbë, t'i rehabilitonin këta njerëz të shitur dhe të rimerrnin kështu pozitat e falimentuara të reaksionit të brendshëm shqiptar.

Mirëpo këto orvatje ishin të kota dhe falimentuan, pse populli ynë ishte i vendosur deri në fund që të mos linte më

të ngjallehin ata që e kishin shtypur dhe që shkaktuan këtë katastrofë të madhe që ishte Lufta e Dytë Botërore.

Për një gjë të tillë s'guxon kush të na bëjë kritikën më të vogël, pse mbulohet me turp dhe diskreditohet”.

Ja edhe fragmenti i dytë: “E zjarhtë ka qenë mbrojtja në Këshillin e Sigurimit nga ana e delegacionit sovjetik, po ashtu ka qenë dhe ajo e delegacionit jugosllav dhe polonez. Këtë e di populli ynë.

Me shumicë votash, ne u pranuan si anëtarë të OKB-së nga Këshilli i Sigurimit, por Amerika dhe Anglia vunë veton, pa asnjë arsye të shëndoshë.

Populli, shqiptar dhe gjithë bota e sheh që kjo është një padrejtësi që i bëhet një populli të vogël që sakrifikoi kaq shumë në luftën antifashiste; populli ynë hidhërohet dhe ca më tepër kur shikon se ai vihet në një radhë me Portugalinë që ka qenë dhe është një çerdhe e atyre që kanë ndihmuar dhe ndihmojnë fashizmin.

Por e drejta jonë do të dalë në shesh dhe populli ynë do të shkojë në OKB pse këtë të drejtë e ka fituar me gjak”.

## **Delegacioni jugosllav mbron Shqipërinë**

Sipas historiografisë zyrtare të shtetit të udhëhequr nga Partia Komuniste dhe më pas Partia e Punës, “Nga qëndrimi armiqësor i pabesë i SHBA dhe i Anglisë Shqipëria nuk u thirr në Konferencën e San-Franciskos për themelimin e Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

Ajo nuk u thirr as në Konferencën e Londrës për dëmshpërblimet nga Italia.

Përfaqësuesit anglezë dhe amerikanë u përpoqën të pengonin pjesëmarrjen e saj edhe në Konferencën e Parisit për dëmshpërblimet nga Gjermania.

Por këtë herë nuk ia arritën qëllimit.

Shqipërisë iu njoh e drejta për të marrë dëmshpërblime nga Gjermania.

Shqipëria prapë nuk u ftua të merrte pjesë në bisedimet për hartimin e Traktatit të Paqes me Italinë.

Në të gjitha këto raste ajo duhej të zinte vendin që i takonte, të fituar me gjak”.

Realisht në 16 janar 1946, me rastin e çështjes së Asamblesë së Përgjithshme, gjeneral kolonel Enver Hoxha, me anën e një telegrami, i kishte drejtuar një kërkesë presidentit të Komisionit përgatitor të Kombeve të Bashkuara për ta pranuar Shqipërinë në OKB.

Më 25 janar kryetari i Këshillit të Sigurimit dhe i pari president i Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Norman Makin, iu njoftua kërkesa e Shqipërisë, së bashku me një

rekomandim të delegacionit jugosllav, të kryesuar nga Eduard Kardeli, e cila përkrahte pranimin e Shqipërisë.

Me gjithë kundërshtimet e delegatëve amerikanë dhe anglezë, u vendos që kjo çështje të vihej në rendin e ditës. Kur po diskutohej ky problem, zëvendësministri i Jashtëm grek, A. Rendis, në 12 shkurt me anë të një letre i kërkoi Këshillit që kjo çështje të shtyhej pasi Greqia kishte disa çështje të pazgjidhura me Shqipërinë.

Më në fund, pasi u vu në votë, u aprovua që të shtyhej për t’u studiuar më vonë.

Më 10 gusht po të këtij viti, 1946, përfaqësuesi i Jugosllavisë në OKB, Pavlo Lukin, i dorëzoi zv. sekretarit të përgjithshëm, rusit Arkadi Aleksandroviç Sobolev, një memorandum mbi të drejtat e Shqipërisë për t’u pranuar në këtë organizatë.

Delegacioni jugosllav edhe në mbledhjen e dytë të Asamblesë së Përgjithshme, kur po shtrohej prapë çështja e pranimin të 5 shteteve të reja, në mes të cilave edhe Shqipëria, e quajti mospranimin e saj nën presionin grek si shkelje të Kartës së Kombeve të Bashkuara”.

**“Lavdërime të veçanta meritojnë punëtorët e kantiereve të Kuçovës”**

Në Mbledhjen e Dytë të Këshillit të Përgjithshëm të Frontit Demokratik”, në 7 tetor 1946, Enver Hoxha po ashtu deklaroi:

“Në minierat tona të serës, të bakrit si dhe në pusët e vajgurit po punohet me energjinë më të madhe; punësoria në këto miniera dhe sidomos në pusët e Kuçovës po organizohet dhe po bëhet e ndërgjegjshme për detyrat e mëdha që i ka besuar populli.

Lavdërime të veçanta meritojnë punëtorët e kantiereve të Kuçovës, të cilët po bëhen shembull për gjithë punëtorët e Shqipërisë, për ndjenjën e lartë të organizimit, për ndërgjegjen në punë, për disiplinën e çelniktë.

Ata e kanë kuptuar se në atë mënyrë i shërbehet atdheut, se në atë mënyrë do të përparojë populli ynë dhe do të lulëzojë vendi.

Të gjithë të marrin shembull andej”.

## **Delegati britanik Hud**

Nëntë ditë më vonë, në 16 tetor, në fjalimin e tij të mbajtur në Kongresin e Tretë të Rinisë Popullore të Shqipërisë, Enver Hoxha shqiptoi këto fjalë: “Por ka njerëz dhe shtete që s'e kuptojnë miqësinë kështu si e kuptojmë ne dhe që s'e bazojnë në respektin e të drejtave të tjetrit, konditë kjo nga kryesoret për vendosjen e marrëdhënjeve të mira dhe të vazhdueshme.

Unë këtu nuk do të përsëris ato që kam thënë edhe disa ditë më parë përsa u përket marrëdhënjeve tona me Anglinë dhe me Amerikën, por do të shtoj diçka tjetër, se vargu i padrejtësive kundër popullit tonë po shtohet.

Sikundërqë e dini, Konferenca e Paqes i mbaroi punimet në lidhje me Traktatin me Italinë, i cili u votua krejtësisht. Në lidhje me këtë traktat ne kishim paraqitur mendimin tonë dhe kërkesat tona, të cilat jo vetëm që ishin të drejta dhe të pamohueshme, por ishin dhe modeste.

Kishim kërkuar që në artikullin 21 të projekttraktatit të paqes me Italinë, atje ku thuhej se “Italia njeh dhe detyrohet të respektojë sovranitetin dhe independencën e shtetit shqiptar”, të shtohet dhe fjala “integritet”.

Kishim kërkuar që të na kthehej ari i grabitur prej Italisë fashiste dhe i transportuar në Gjermani, kishim kërkuar që ne të konsideroheshim si fuqi-shoqe (puissance associe), kishim kërkuar reparacione nga Italia.

Të gjitha këto kërkesa tona të drejta u mbrojtën me mish e me shpirt deri në fund nga përfaqësuesit sovjetikë, e të



tjerë, por, më në fund këto kërkesa u rrëzuan dhe delegacioni anglez dhe amerikan bënë presion në konferencë për këtë gjë.

Delegati britanik Hud deklaroi dhe insistoi që “Shqipëria të mos marrë fare dëmshpërblime”.

Këtë qëndrim mbajti edhe delegati amerikan gjatë gjithë konferencës përsa u përket të drejtave tona.

U duk haptas se në atë konferencë të lartë, ku duhej të bëhej procesi dhe të merreshin masat kundër agresorëve, siç ishte Italia fashiste, nga shumë shtete të Perëndimit u mbrojt Italia dhe u shqelmuan të drejtat e atyre popujve që vuajtën...”

### **Frymë shumë armiqësore kundër Italisë**

E nënvizojmë frymën shumë armiqësore të Enver Hoxhës kundër Italisë, duke e quajtur atë fashiste dhe agresore, ndërsa në të vërtetë nuk thotë të vërtetën.

Italia që prej shtatorit 1943 që bashkuar me aleatët e vendeve demokratike.

Pas lufte pati hyrë në jetën pluraliste dhe kishte zgjedhur jo stalinizmin, por Perëndimin.

Hoxha shprehet aq ashpër ndaj shtetit fqinj të Shqipërisë, me të cilin ka mjaft interesa të mbarëveje, thjesht sepse ky qëndrim i pëlqen Jugosllavisë së Titos.

Jo vetëm për arsye të pushtimit që musolinianët i bënë këtij vendi, si edhe krimeve që kryen ndaj popullit të tij, titistët këto kohë jo nuk i donin, por mbartnin mlllef dhe i urrenin italianët.

Kjo ndodhte pjesërisht për arsye ideologjike, masivisht edhe për shkaqe pretendimesh territoriale.

Nga fundi i vitit 1943 dhe deri në 10 shkurt 1947, kur u firmos traktati i paqes, Jugosllavia nuk gjente prehje pa e grabitur në toka Italinë.

Në 10 shkurt asaj iu dhanë jo vetëm gjysma e Triestes (zona B) (zonën A e kishin aleatët anglo-amerikanë), por edhe tërë qytetet bregdetarë të Istrias perëndimore, Fiume si edhe ishujt Quarnaro dhe Zara.

Ndërkohë një tension i madh mes dy vendeve që krijuar për një masakër të madhe që titistët u patën shkaktuar italianëve.

Ajo quhet ngjarja e Foibe.

Foibe në tokën jugosllave thirreshin disa puse të thella malore, karstike, në të cilat prej njerësve të pushtetit komunist të Beogradit, u hodhën, për t'i mbajtur fshehur nga opinioni publik ndërkombëtar, një pjesë edhe ende pa vdekur, deri 7500 trupa të pushkatuar.

Mes tyre nuk kishte vetëm ish-funksionarë fashistë të pushtimit, mëkatarë në krime ndaj popullit të thjeshtë jugosllav, por edhe shumë opozitarë të regjimit bolshevik titist.

Doemos që Josip Bros Tito kishte shumë nevojë që të sajonte prova se edhe italianët e mbetur pas lufte në Shqipëri, ishin keqdashës, destabilizues.

## **“Puljen dhe Istriani e kërkojnë jugosllavët, kurse ne nuk na japin Kosovën”**

Nga shkrimi im “Si i pashë masakrat kundër shqiptarëve të Kosovës”, me nëntitull “Ditari i pabotuar i një partizani nga Skrapari”, publikuar në gazetën “Dita” në 17 dhe 18 korrik 2016:

“Në janar shkurt 1948 u mbledh aktivi i partisë për Korçën.

Musa Hysi punonte si oficer në këtë qytet.

Gjatë aktivitetit i bëri një pyetje të deleguarit të Komitetit Qendror të Partisë.

Njiheshin, por në kujtimet e veta nuk e bën të ditur atë me emër dhe mbiemër. Ndoshta në 1984, kur Musai bëri dorëshkrimin, personi që në funksione shumë të larta.

Pyetja ishte për çështjen nacionale, çfarë donte të thoshte për fatin e Kosovës dhe të trojeve të tjera shqiptare në Jugosllavi, po ashtu edhe të Çamërisë në Greqi.

Përgjigjen i deleguari e dha pas pushimit.

U shpreh me këto fjalë: “Me Jugosllavinë çështjet nacionale i kemi zgjidhur drejt. Kosova bashkë me popujt e Jugosllavisë ndërton jetën e re, sipas dëshirës së vet. Ndërsa me Greqinë nuk bëhet fjalë fare. Ajo pretendon se është në gjendje lufte me ne. Ajo kërkon të mbajë jo vetëm Çamërinë, por gjithë Shqipërinë e jugut”.

Pastaj iu drejtua pyetësit: “Musa, ti e di mirë se bashkë kemi qëndruar një vit nëpër shtëpitë e Jugosllavisë”.

Pastaj menjëherë e pyeti: “I qartë?”

“I qartë”, iu përgjigj Musa Hysi, por ndërkohë shtoi “Puljen dhe Istrian e kërkojnë jugosllavët, kurse ne nuk na japin Kosovën”.

“Mirë, mirë!, foli i deleguari i Komitetit Qendror të Partisë, ulu dëgjo dhe vëru veshin mirë! Pulia dhe Istria nuk janë si Kosova, e cila qoftë me ne qoftë me jugosllavët ndërton socializmin, jetën e vet.

Jugosllavia po na ndihmon dhe ne.

Ato, Pulia dhe Istria, janë me regjimet kapitaliste.

Prandaj edhe ne e Bashkimi Sovjetik i mbështetim kërkesat e drejta të tyre”.

“E qartë”, u dëgjuan zëra nga salla”.

## **Edhe dy italianë të dënuar rëndë si agjentë anglo-amerikanë**

Sipas Arkivit të Ministrisë së Punëve të Brendshme (fondi i misioneve anglo-amerikane, dosja 1, në të thuhet: “Zbulimet e huaja me atë amerikane në krye në korrik të vitit 1945 krijuan organizatën tekniko-sabotatore me ish-agjentët e Fulcit, si Kujtim Beqiri, Abdyl Sharra, Beqir Çela, Namik Xhelili etj.

Kësaj organizate iu ngarkua si detyrë kryesore sabotimi i ekonomisë, duke përfituar nga postet që u ishin dhënë atyre për mungesë kuadrosh të përgatitura nga pushteti popullor.

Për këtë qëllim ata orientuan që të ngriheshin grupe sabotatore kudo që punohej e ndërtohej, veçanërisht në minierat e Rubikut, Selenicës, Pogradecit, në Kuçovë, në tharjen e kënetës së Maliqit etj.

Ndërkaq në gazetën “Bashkimi” të datës 20 korrik 1946 shkruhet: “Në Maliq filluan punimet për thellimin e sistemimin e kanalit...

Ardhja e njësiteve sulmuese i jep punës një vrull të ri.

Këto ditë filluan punimet për mbylljen e shtratit të lumit Devoll...

Kudo ka një hov të ri....”

Në po atë të përditshme, por të datës 7 nëntor 1946, pra dy muaj më pas nga disa incidente të avionëve ushtarakë amerikanë në hapësirën ajrore jugosllave, në ditëpërvjetorin e Revolucionit Bolshevik në Rusi, spikatet

teksti: “Një bandë sabotatorësh të punimeve në Maliq del nesër para gjyqit.

Punimet janë sabotuar nga anëtarët e bandës që të mos thahesh kënetat e Maliqit dhe duke u pjekur me çdo kusht që punimet të kushtonin më shumë, sesa kishte parashikuar pushteti.

Kjo, me synim që të dëmtohesh buxheti i shtetit dhe të thyhet vullneti i vullnetarëve për punë.

Banda e sabotatorëve, përbëhet nga inxhinier Abdyl Sharra, inxh. Kujtim Beqiri, Vasil Mano, italiani Scaturio Eugenio, Pandeli Zografi, të cilët kanë pasur lidhje me agjentë të huaj dhe me njerëz të misioneve të huaja në Shqipëri.

Kanë marrë udhëzimet konkrete prej tyre dhe janë ndihmuar nga ana financiare dhe morale...”

Shënojmë se përveç italianit Eugenio Scaturio, i cili u dënua me vdekje dhe nga regjimi pushkatimi i tij bashkë me çiftin Vasil dhe Zyrakë, u filmua dhe u shpërnda për propagandë, me burgim të përjetshëm u ndëshkua edhe një italian tjetër.

Quhej Mario Guarnieri.

### **“Organizata tekniko-sabotatore”**

Për një simbolikë patjetër jo të rastësishme gjyqi ndaj “organizatës tekniko-sabotatore” nisi në jubileun politik të 8 nëntorit, përvjetori i pestë i themelimit të Partisë Komuniste Shqiptare.

Pesë ditë më vonë, në 13 nëntor, “Bashkimi” titullonte me germa të mëdha: “Planet e punimeve të Maliqit ishin studiuar mirë nga mr. Fultzi dhe nga agjentët e UNRRA-s deklaroi kreu i banditëve sabotator inxh. Sharra.

Ai pohon se: “Mr. Fultzi ishte një agjent spiunazhi që kishte ardhur për të shkatërruar dhe për të terrorizuar popullin tonë...”



## **Nga procesverbali i deklaratës në hetuesi të Zyrraka Manos**

“Raportet kurdoherë flisnin mbi sabotimet e Maliqit, hollësisht e këtyre raporteve unë nuk i kam parë.

Gjithnjë, unë këto raporte i kam shpurrë te Fulsi me anën e Bjanka Baliçit, e cila mbasi i shpinte, merrte edhe përgjigjet e këtyre raporteve, të cilat m’i dorëzonte mua. Përgjigjet e këtyre raporteve unë ia dorëzoja Beqir Kujtimit në Maliq.

Beqiri, mbasi i këndonte, provokonte mbledhje me qëllim që të njoftonte shokët e tij çka përmbajtnin letrat që Fulsi ia dërgonte në lidhje me sabotimet.

Dijeni për këto raporte dhe për përgjigjet e këtyre raporteve kishin Hans Vale, Pandeli Zografi, dr. Gofredo Bizzua, burri im Vasili, Aleks Vasili dhe Ing Adami.

...Porsa fola më sipër, mbasi m’u kënduan dhe m’u shpjeguan mirë, i nënshkruaj me firmën time”.

### **Shtojcë**

Kujtim Beqiri shpeshherë na ka folur mbi situatën duke na thënë për së shpejti do të ndryshojë meqë Englezët nuk do të lejojnë qeverira të tilla, e meqë më vonë kërcënojnë qenien e tyre....

### **Shtojcë tjetër, më 24 tetor 1946, në Zyrrat e Seksionit të Sigurimit të Shtetit në Tiranë**

“U rimuar në pyetje e burgosura Zyrraka Mano dhe mbasi u pyet, deklaroi si më poshtë: “...Kujtim Beqiri përpiloi një raport të punës për Fulsin, të cilin ma dha mua për t’ia

çar Fulsit në Tiranë. Kur unë mora raportin nga Kujtimi për te Fulsi, ka qenë prezent dhe burri im, Vasua.

Kujtim Beqiri më tha se kishte përgatitur një raport dhe se ishte e nevojshme t'i shkonte Fulsit sa më parë. Unë këtë nuk e desha, por burri im tha se kjo duhet të vente patjetër dhe unë shumë lehtë mund ta çoja te Fulci me anë të Bianka Baliçit.

Kështu më tha Vasua, që të mos kisha as më të voglën frikë.

Unë raportin nuk e këndova, por e dija me siguri se që përpiluar në lidhje me sabotimet e punimeve në Maliq dhe se ishte vazhdimi i raportit të Sharrës...

Kur Kujtim Beqiri më dha këtë raport, ky ishte mbyllur me një zarf të bardhë dhe ishte shkruar kështu: Fulsit në Misionin amerikan në Tiranë.

Mbasi mora raportin, u nisa me një makinë të Kantierit për Tiranë.

Në Tiranë shkova drejt e në shtëpi të Bianka Baliçit, ... unë i thashë që raportin ta çosh vetëm ti, për arsye se unë kam frikë të vete vetë te Fulsi; njëkohësisht e porosita që të merrte edhe përgjigjen e raportit.

Bianka Baliçi më tha se ti nuk duhet të përzihesh shumë me këto punëra, meqë janë veprime të rrezikshme, dhe unë që shkoj atje, druhem shumë, sado që vete me pretekstin e qirasë së shtëpisë dhe të porosis që, tjetër herë të mos biesh më të tilla raporte se nuk i çoj.

Këtë po e çoj.

Kështu që e mori raportin dhe ia çoi Fulsit.

Unë për të marrë përgjigjen, do të shkoja në mbrëmje në shtëpinë e Biankës. Në mbrëmje të kësaj ditë, kam shkuar për të marrë përgjigjen, të cilën e gjeta gati në një zarf të mbyllur, pa drejtim e veç kësaj, më tha Bianka: Fulsi i

kishte thënë t'i thoja inxhinierit të vinte në Tiranë, për t'u takuar verbalisht me Fulsin.

...Me mbërritjen time në Maliq, Kujtim Beqiri ardhi në shtëpinë time për të më pyetur si kishte shkuar. Në atë kohë i dhashë letrën dhe njëkohësisht i thashë se Fulsi kishte porositur që ti të shkosh në Tiranë për të biseduar gojarisht me të.

Kujtimi, mbasi mori letrën, të nesërmen, thirri shokët dhe u mblodhën në shtëpinë time... Në këtë mbledhje ishin, Kujtimi, Pandeli, Hanzi, burri im, Aleks Vasili dhe unë. Kujtimi, në këtë mbledhje, tha: “Zyraka pruri përgjigjen nga Fulsi dhe se Fulsi na shkruan këto pika: në këtë kohë, ai nxori letrën nga xhepi duke mbajtur përpara dhe duke shpjeguar pikat që përmbante letra.

.... Mbasi vuri në dukje këto pika, udhëzimet e Fulsit u diktuan nga të tërë dhe u vendos të punohej sa më shumë që të bëheshin sa më shumë greva dhe të dezertonin...”

## **Bianka Balliçi**

Sipas Ilir Llanaj, nipit të të shoqit të Bianka Balliçit, Ademit, kjo e fundit “njjihthe shumë gjuhë të huaja, në mos gaboj 12. Njërën prej të cilave, rusionen, thanë se e pati mësuar në vitet e gjata të burgut që kaloi në Shqipëri.

Ajo ishte vajza e konsullit austriak në Stamboll, prandaj edhe vendlindja e saj ishte Turqia.

Mandej, i ati shkoi konsull në Itali, ku jetuan për disa vite. Siç kam mësuar më vonë, të vëllain e kishte zëvendësministër atje, të motrën pedagoge të Filozofisë në New York, Bianka pat qenë një herë e martuar në Vjenë me një kont, i cili vdiq e pas tij u martua me Ademin, i cili është mbajtur gjithnjë si burrë mjaft i pashëm.

Ajo ishte gati 7 vite më e madhe se ai”.

Në një moment tjetër të intervistës: “Di që në Shqipëri kanë ardhur në kohën e Zogut. Ademi punoi në Ministrinë e Financave si zëvendësministër, ndërsa Bianka nuk ka punuar ndonjëherë, por si profesion kishte gazetarinë investigative.

Nga ato që ju thashë më lart, mund ta merrni me mend edhe nivelin e saj ekonomik. Kishin para mjaft.

Morën një truall në Rrugën e Elbasanit, midis Ambasadës Amerikane dhe asaj të dikurshme franceze. Aty ndërjuan vilën e tyre.

Thuhet që gjithçka, që nga rëra e tullat erdhën nga jashtë. Madje u nis edhe një vapor me pajën e saj nga Vjena, i cili

u mbyt në Trieste e pas tij i ati i dërgoi një të dytë, e cila mbërriti në Tiranë.

Ato u sekuestruan të gjitha ç’ishin, por kam pasur në shtëpi listën e gjërave mes të cilave mund t’ju përmend shandanët e pasqyrat e kristalit, por sidomos pikturat. Bianka ishte e apasionuar pas tyre, pikturonte edhe vetë. Ishin plot 16 tablo të 1900-s, të cilat kanë qenë shumë të vlefshme. Unë nuk i kam parë të gjitha, sepse ne mundëm të kemi vetëm 2 që patën ngelur dhe njëra prej tyre është e një piktori polak, që është i përfshirë në radhët e piktorëve më të mirë të kohës. Ma kanë kërkuar mjaft shtrenjtë dhe nuk e kam shitur.

Ashtu siç na i ka kërkuar tjetrën shteti që në ’65-n për 250 mijë lekë, por nuk e shitëm. Nuk dua të gabo, por kanë qenë piktura të vlerës së Picasos e Van Gogh-ut, të cilat nuk u morën vesh kurrë se ku përfunduan.

Shtëpia e tyre niste në krah të Ambasadës Amerikane dhe oborri përfundonte poshtë, pranë stadiumit “Qemal Stafa”.

Intervista me Ilir Llanaj vijon: “Luante në piano mjaft mirë, e kishte në shtëpi. Kishte telajo të tëra, në të cilat pikturonte kur dilte në zona periferike të Elbasanit apo Tiranës.

Merrej me përkthime e shumë lexim.

Përveç këtyre ishte gjithnjë e ftuar e darkave më mondane që bëheshin asokohe në Tiranë.

Gjithnjë e pranishme në darkat e ambasadave, në shoqërinë e të huajve, me të cilët kishte njohje, por edhe ajkën e shqiptarëve atëherë që ishin të shkolluar jashtë. Ishite mësuar ashtu, gjithnjë pjesë e ballove”.

Një fragment tjetër i intervistës thotë se “Nuk besoj të ketë qenë agjente. Ajo atë jetë kishte bërë dhe atë vazhdoi të bënte, ç’arsye kishte të merrej me gjëra të tjera”.

Po ashtu: “Me Zyrakën takohet vërtet, por siç e bënte me gjithë miqtë e tjerë të huaj.

Në fund të fundit, Zyraka ishte inxhinierë dhe mund të ishte vërtet e përfshirë në dëmin e kënetës së Maliqit, për të cilën u dënua me pushkatim.

Po Bianka për çfarë të ishte e përfshirë?! Ata u kapën fort pas arsyes se pse gjetën atë vend për të ndërtuar shtëpinë”. Ilir Llanaj pohon: “Ajo nuk kishte fëmijë, e meqenëse i pëlqente të shëtiste, vinte e më merrte mua me vëllain nga shkolla.

Pothuajse gjatë gjithë ditës kam imazhin e saj duke lexuar. Mbyllej në biblioteka e lexonte “Zarathustrën” e Niçes në gjermanisht, “Thundrën e hekurt” të London, e Shopenhauerin.

Shqipen nuk e fliste fort të pastër, ama përpiquej.

Koha e saj e burgosjes duhet të ketë qenë çnjerëzore, sepse ishte e tmerruar.

Lëkurën e trupit e kishte të gjithën të djegur, deri te organet gjentile.

E gjithë lëkura ishte e rrudhur prej shenjave të djegies. Kyçet e duarve të shtrembëruara.

Ka pirë edhe urinën e saj në burg vetëm për të shuar etjen”.

Më tej: “Është e vërtetë që pas daljes nga burgu kishte lajthitje të herëpashershme prej torturave. I kanë bërë injeksione në shtyllën kurrizore që të mos fliste, aq shumë, sa u shtrembërua.

Megjithatë ajo nuk foli kurrë për asnjë e nuk akuzoi askënd”.

Njëkohësisht: “Edhe i shoqi, Adem Balliçi, ka qenë i burgosur. Përveç se ndenji gjithë kohës pa punë edhe kur ishte jashtë.

Në kohën e Zogut, pati njohje me Enver Hoxhën.

Balliçët kanë qenë tregtarë të cigareve e furnizonin dyqanin “Flora” atëherë. Aty ishin takuar shpesh.

Kur u takuan më vonë në Elbasan e Ademi i tha “jam pa punë”, e futi 6 muaj drejtor të bibliotekës sa për të larë gojën dhe e hoqën, nuk punoi më”.

“Pas ikjes shtëpinë ua la njerëzve të Ademit...më pas me kujdesin që tregoi, duke dërguar veshje gjithmonë deri në një kohë që ne na u desh të ndërprisnim komunikimin.

I kujtoj ende xhinset e mia të viteve ’70, të dërguar nga Bianka”.

## U pushkatua shtatzënë

Në 16 nëntor 1946 e përditshmja “Bashkimi”, e cila qe gazeta proqeveritare me tirazhin më të madh në Shqipëri, botonte një shkrim në të cilin bëhej e ditur se “Prokurori në emër të popullit kërkoi të dënohen me litar Abdyl Sharra dhe Kujtim Beqiri; me vdekje, Vasil Mano, Zyraka Mano, Eugenio Scaturro dhe Pandeli Zografi; me burgim të përjetshëm: Mario Guarnieri; me 15 vjet burgim: Mihal Stratobërdha, Anastas Risto dhe Jani Vasili me 1 vit burgim kondicional.

Populli duartroket nxehtësisht pretencën e prokurorit”.

Në Arkivin e Ministrisë së Punëve të Brendshme vendimi i Gjykatës së Lartë Ushtarake për këtë proces ka numrin 17 dhe çastin e bërjes publike në Kinema Nacional orën 11.00 të paradites së 18 nëntorit të vitit 1946.

Në “Bashkimi” të së nesërme, 19 nëntor, thuhet qartë: “Këshilli gjyqësor i Gjykatës së Lartë Ushtarake, në emër të popullit dha vendimin: inxh. Abdyl Sharra dhe Kujtim Beqiri dënohen me ekzekutim në litar. Inxh. Vasil Mano, Zyraka Mano dhe Eugenio Scaturro me vdekje.

Për të 5 të dënuarit me vdekje ekzekutimi do të behet në Maliq...”.

Ekzekutimi vërtet u bë në Maliq brenda kësaj dite të 19 nëntorit 1946.

U përhapën fjalë se Zyraka kishte qenë shtatzënë.



## **Ikja e Misionit Politik Amerikan**

Vrasja me litar dhe pushkatim i të shtatëve, i kryer në 19 nëntor 1946, shënoi një fakt kuptimplotë për të shprehur objektivin politik që kishte: ndodhi dhjetë ditë pas largimit të misionit amerikan nga Shqipëria.

”The Times”, më datën 9 Nëntor 1946, ditë e shtunë, 1946, do të shkruante: “Departamenti i Shtetit njoftoi sot tërheqjen e Misionit Politik Amerikan nga Shqipëria, duke thënë se Qeveria e Amerikës arriti në mendimin, që Misioni nuk mundte më të sillte ndonjë dobi duke qëndruar atje.

Gjeneral Hoxha, Kryeministri i Shqipërisë, u njoftua të martën mbi këtë vendim.

Lajmërimi i Departamentit të Shtetit tha se, sigurimi nga ana e Qeverisë Shqiptare se do t’i njohë marrëveshjet me Shtetet e Bashkuara, do të qe “konditë e parë (e domosdoshme) për njohjen e saj nga ana e Shteteve të Bashkuara... në pajtim me zakonet e ndjekura nga kjo Qeveri”. Shqipëria deklaroi se ajo, nuk ia njohu vlerën (fuqinë) e marrëveshjeve bilaterale në mes të dy shteteve. Departamenti tha se marrëveshjet, të cilat refuzoi t’i pranonte Shqipëria, “nuk janë në asnjë mënyrë të një karakteri të rëndë” por përmbajnë vetëm subjekte të zakonshme, pajtim (conciliation), natyralizimin (e shteteve) dhe trajtimi i shtetit më të favorizuar”.

Me gjithë tërheqjen e Misionit, SHBA i vijojnë ndjenjat e miqësisë së mirë për popullin shqiptar.

Z. George D.Henderson, përfaqësues i Amerikës në Tiranë,  
dhe Shtabi i tij, largohen me një herë për në Amerikë”.

### **Nga fjala e Enver Hoxhës në 12 tetor 1947**

E mbajtur përpara punëtorëve dhe fshatarëve të Maliqit me rastin e përfundimit të punimeve të para për tharjen e kënetës.

Një fragment prej saj:

“Sot po inaugurohet mbarimi i punimeve të para të Maliqit, një nga ndërmarrjet më të mëdha të pushtetit tonë. Ne po e ndërtojmë Shqipërinë e re, ne po inaugurojmë sot mbarimin e punimeve të para të Maliqit, ndërsa armiqtë e popullit, sabotatorët, përfunduan në litar dhe këtu do ta kenë mbarimin e tyre të gjithë ata që do të tentojnë të bëjnë akte të tilla për të na penguar në rrugën tonë të lavdishme të ndërtimit”.

## **Riza Alizoti dekorohet**

Në 22 dhjetor 1945, edhe pse që i biri i kundërshtarit dhe i të pushkatuarit politik Fejzi Alizoti, Rizai u dekorua me “Urdhrin e Punës”.

I propozuar nga Kryeministria ai që firmosur prej Omer Nishanit, President i Republikës.

Ky urdhër kishte tre klasa, të parë, të dytë dhe të tretë.

Në pamjen e vet, me ngjyra të harmonizuara në mënyra të ndryshme, mes grisë dhe të florinjtës, ai kishte tre elementë të njëlojtë: drapër dhe çekanin, kazmën si edhe yllin (e kuq).

Një Urdhër i tillë u jepej “kryesisht punonjësve të prodhimit, rretheve, qyteteve, institucioneve, ndërmarrjeve, fabrikave, sektorëve, kantiereve, brigadave, grupeve të punonjësve etj., që dallohen në mënyrë të veçantë në punën për ndërtimin socialist të vendit, për forcimin e aftësisë mbrojtëse të vendit, për arritje e rendimente të larta në prodhim, për merita të veçanta drejtimi e organizimi, për zhvillimin e mëtejshëm të revolucionit tekniko-shkencor, për shpikje dhe racionalizime me rëndësi të madhe, për kujdes shumë të madh për shfrytëzimin e makinave dhe për ruajtjen e pasurisë socialiste”.

## **Kitara e Rizait dhe puthja e tij në ballë**

Shkëlqim Ago, mik imi i vjetër dhe njeri diturie, realizues në vitin 2005 i librit vëllimësh “Enciklopedia e Kuçovës”, me kërkesën time në 31 janar 2022 do të më dërgonte disa shënime për Riza Alizotin.

Sipas tekstit original njëri prej tyre:

“Pranvera e 1945-ës...

Sapo kishim filluar punë në sektorin e përpunimit të naftës, tregon babi im Servet Agaj.

Ne, disa djem të rinj, dilnim pasditeve.

Në atë rrugë kryesore pranë një ndërtese ku edhe sot e kësaj dite i thonë “Pallati i Kulturës”, ne vërdalloseshim pothuajse ashtu kot.

Por na hapeshin sytë kur shikonim ing. Riza Alizotin me bashkëshorten Vera.

Të dy yje.

Visheshin bukur.

Të zënë dore për dore ata bënë shëtitjen e tyre. Dukeshin të qeshur dhe të lumtur.

Pasi përcillte Verën në shtëpi, të cilën e kishin lart te Kombinati, ai rikthehej dhe na merrte e na çonte te bodrumi poshtë Pallatit të Kulturës ku ishin bilardot.

Na mësonte lojën.

Më pas na merrte e na çonte te kinemaja që i thoshnin “Dopo lavore” (Pas pune).

Me vete kishte një kitarë. Për herë të parë, më thoshte im at, pamë kitarë me sy.

Dëgjonim me vëmendje si luante aq bukur ato tela që lëshonin tinguj që edhe sot e kësaj dite (pra viti 1986, kohë kur im at m'i tregonte) më jehojnë këndshëm.

Episodi i dytë:

“Korrik 1946.

Para "Birra Korça", Kuçovë.

Paradite.

Në rrugën kryesore të vetme të qytetit kalon një grup dasmorësh. Zonja Stefani Ziu nuse.

Krushqit ngadalësuan hapat sepse përballë kishin ing. Riza Alizotin, të cilin e njihnin si zotëri të nderuar.

Ing. Riza Alizoti ishte prej afro 18 vitesh banor i Kuçovës dhe njihej prej banorëve si njeri i përveçëm për rolin dhe kontributin e tij në komunitet dhe në zonën vajgurore të puseve të naftës.

Ai njihej edhe si njeri bamirës, pra konsiderohej i shenjtë. Ndaj nusja Stefani do ta mbante mend deri në janar të 2005-tës, kur ndërroi jetë, atë që ndodhi në atë vapë korriku 1946.

Ing. Alizoti puthi në ball nusen dhe djalin dhëndër, Jorgji Ziun, duke u bërë në një farë mënyre kumbari i tyre për jetën e mëvonshme, ku për hir të realitetit jeta e tyre shkoi shumë mbarë deri sa ata u larguan prej saj.

Puthja e tyre nga inxhinieri edhe në ditët e sotme për pasardhësit e çiftit Ziu do të mbahet mend si prelud bekimi lumturie”.

## **Bie në dashuri me anglezen Kathleen Mary Yeates**

Nga dy djemtë e tri vajzat që Fejzi Alizoti kishte, Rizai ishte fëmija i pestë. Pati lindur në kryeqytetin e perandorisë osmane në 10 tetor 1910.

Tri motrat e tij (dhe të Hasanit) qenë Fitreti, Ballkizja dhe Safetja.

Që të treja kishin mbaruar në “Robert Kollege” në Stamboll. Këtë kolegji e kreu edhe Riza Alizoti.

Në fund të viteve 1920 u kthye në Shqipëri dhe vazhdoi Shkollën Teknike Amerikane në Tiranë (e njohur si shkolla e Fultz-it).

Me mbarimin shkëlqyeshëm të saj ai përfitoi, i vetmi nga e gjithë matura e tij, një të drejtë studimi universitar për në Angli.

Kjo ngjau në vitin 1929. Shkolla ndodhej në jug-perëndim të Anglisë, në Camborne.

Quhej School of Mining e Universitetit të Exeterit.

Ky universitet qe themeluar në 1888.

School of Mining (Shkolla e Minierave) merret me ekspertizë të gjeologjisë inxhinierike për mineralet, minierat dhe për përpunimin e energjisë së ripërtëritshme.

Këto çaste studenti shqiptar Riza Alizoti ra në dashuri me anglezen Kathleen Mary Yeates, e cila i vazhdonte studimet e saj të larta në Oksford”.

Referuar studiueses Meri Lalaj, “Sipas certifikatës së martesës, ata u kurorëzuan në distriktin Truro më 28 qershor 1930.

Në mars 1931 u lind djali, Muhtar Peter, ndërsa në qershor 1932 u lind vajza Diane Jacqueline Belkiz, (sipas emrit të motrës së Rizait, por vajza do të thirrej shkurt: Xheki).

Meri Lalaj sqaron: “Studimet e mbaroi në vitin 1935, duke qenë ndër të vetmit shqiptarë i diplomuar në atë Universitet në atë periudhë kohe.

Pas mbarimit të studimeve në Londër, Rizai i'u bë ofertë që të punonte në Angli nga dy kompani të mëdha të industrisë së naftës, por ai nuk pranoi, duke u thënë: “Atdheu im i varfër më ka paguar bursën për shtatë vjet që kam studiuar këtu dhe unë jam i detyruar të kthehem në vendin tim”.

Në vitin 1936, Rizai u kthye në Shqipëri dhe u caktua të punojë në profesionin e tij si inxhinier në pusët e kërkimit të naftës në Kuçovë, e cila asokohe ishte nën administrimin e një ndërmarrjen të përbashkët Anglo – Persiane.

Pasi punoi dy vite në këtë kompani të madhe, ai u dërgua për studimet pasuniversitare në Strasburg, të cilat Rizai i përfundoi për dy vite dhe përsëri u kthye në Kuçovë, ku punoi për llogari të ndërmarrjes italiane “AIPA”.

Ndërkohë Kathleen po përfundonte studimet, ndërsa nga ana tjetër nëna e saj nuk donte që e bija të largohej nga Anglia e të shkonte në një vend të panjohur të Ballkanit.

Dihet se anglezët asokohe i kishin të përcaktuara mirë shkallët shoqërore dhe familja e tyre duke qenë shtresë e mesme e shihte paksa të pamundur këtë martesë me birin e një deputeti të parlamentit shqiptar dhe njëherazi ministër i qeverisë.

Ndodhi dhe një fatkeqësi, djali Muhtar u mbyt në lumë. Paskëtaj martesë u prish”.

Sipas Meri Lalajt, në vitin 1941 Riza Alizoti krijoi një familje të re.



Nga martesat e dytë i lindën tre fëmijë: Nezi, Sevimi dhe Fejziu.

### **Arrestohet nga italianët**

Duke qenë se kishte një prirje të theksuar për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve të thjeshtë, Rizai ra në konflikt me drejtuesit e AIPA-s.

Këta e duruan një kohë, por më në fund, kur ai mori pjesë aktive edhe në demonstratën e naftëtarëve, e denoncuan tek komanda lokale e pushtimit.

Karabinierët e arrestuan menjëherë dhe u dërgua në burgun e Porto – Romanos në Durrës.

Ishte viti 1943.

Në burg qëndroi disa muaj dhe vetëm me ndërhyrjen e atit të tij mundi të lirohej.

Pas daljes nga kampi i internimit të Porto Romanos ai nuk u kthye të punonte në pusët e naftës në Kuçovë, por, sërish me ndërhyrjen e Fejziut, filloi punë në Ministrinë e Ekonomisë në Tiranë.

Gjatë gjithë periudhës së Luftës Riza Alizoti qëndroi dhe punoi në kryeqytet, në administratën teknike dhe nuk u pleks fare në çështjet e politikës.

Sepse qëndroi neutral pas luftës qeverisësit e rinj, Partia Komuniste Shqiptare, në janarin e vitit 1945 inxhinier Riza Alizotin e caktoi të punonte në Kuçovë, në Ndërmarrjen Shtetërore të Naftës, në sektorin e shpim kërkitimit.

Aksioni i parë që kreu ishte vendosja në punë e shumë puseve të mbyllura nga firmat italiane apo të shkatërruara prej nazigjermanëve të porsalarguar.

## **Refuzon punën në Jugosllavi**

Duke dalluar shkëlqimin e tij profesional dhe mbajtjen e distancës nga ish-pushtuesit e mëparshëm të Shqipërisë dhe Jugosllavisë, specialistët e këtij vendi të fundit, drejtues në Kuçovë, i propozuan Rizait të shkonte dhe të punonte në vendin e tyre.

Në Jugosllavi do të kishte një pagë shumë herë më të lartë. Por Riza Alizoti e refuzoi.

Dhe nuk ndërroi mendje asnjë ditë më pas

**Beratasi Kostaq Stefa thotë: “Po arrestojnë njerëz që kanë të bëjnë me amerikanët”**

Kishte përfunduar me rezultate të shkëlqyera Tekniken e Harri Fulcit dhe pas kësaj kishte qëndruar aty si mësues. Derisa shkolla amerikane që mbyllur prej Ahmet Zogut. Në verën e vitit 1943 ai pati marrëdhëniet e dyta me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, që luftonte fashizmin dhe shoqëroi për t'i nxjerrë deri në kufirin detar tridhjetë infermiere, mjekë dhe personel shërbimi të një avioni amerikan, i cili për shkak të një defekti që ulur në periferi të Beratit.

Në një ditë të fundpranverës 1947, pasi u kthye nga Tirana, ku i kish bërë një vizitë motrës së tij të sëmurë, ai që i shqetësuar.

I tha të shoqes se po bëhej kërdua dhe patën filluar burgosjet e teknikasve.

Bashkëshorti i të motrës i bëri të ditur se “po arrestojnë njerëz që kanë të bëjnë me amerikanët, sepse tani që i kemi “armi” drejt e di se çpo bëhet”.

Kunati i pati thënë po ashtu se “në mënyrën si po zhvillohen gjyqet, arsyeja dhe drejtësia nuk ekzistojnë”.

## **Enver Hoxha: Nuk i varim ne, varen vetë**

Riza Alizoti u arrestua në 11 qershor 1947

Gjashtë ditë më pas, në 17 qershor, Enver Hoxha do të jepte këto udhëzime të Komitetit Qendror të PKSH “Për forcimin e vigjilencës dhe të luftës kundër punës armiqësore të misioneve anglo-amerikane dhe të armikut të klasës në vendin tonë”.

Sigurisht kjo lëndë e gjatë sa për 14 faqe libër të serisë “PPSH, Dokumente kryesore” që shkruar para 17 qershorit dhe ka shumë të ngjarë të ishte në këtë proces kur u arrestua Riza Alizoti.

Disa fragmente nga këto udhëzime:

“Kohët e fundit janë marrë masa kundër disa deputetëve për arsye të veprimtarisë së tyre kundër Republikës sonë Popullore. Qëllimi i tyre ishte që të rrëzonin me forcë pushtetin tonë popullor, të likuidonin të gjitha fitoret e Luftës nacional-çlirimtare dhe të merrnin në duart e tyre fuqinë shtetërore.

Në platformën e politikës së tyre, këta vunë bashkëpunimin e tyre me gjithë reaksionin brenda dhe jashtë Shqipërisë. Në këtë punë armiqësore kundër vendit dhe popullit tonë, këta mbështeteshin në klasat e privileguara të kohës së vjetër, në intelektualët reaksionarë, në njerëzit e “Ballit” dhe të “Legalitetit”, në klerin e njerëzit e tij, sidomos në klerin katolik, dhe në të arratisurit politikë, kriminelë luftime. Njëkohësisht këta mbështeteshin edhe në përkrahjen e shëndoshë të imperialistëve anglo-amerikanë, të cilët i

nxitën dhe i ndihmuan, jo vetëm me qëndrimin dhe politikën e tyre kundër vendit tonë, por edhe duke bashkëpunuar direkt dhe duke i subvencionuar me të holla, me anë të agjentëve të tyre si dhe të misioneve zyrtare të tyre, që ishin akredituar pranë qeverisë sonë”.

“Nga ana tjetër misionet anglo-amerikane dhe agjentët e tyre u premtuan këtyre intervenimin me forca të armatosura për të përmbysur pushtetin tonë popullor.

Ky zbarkim, sipas planeve të tyre të përbashkëta, do të kombinohej edhe me veprimin e bandave të kriminelëve të luftës në Shqipëri dhe në Greqi.

Ky aktivitet i kombinuar në mes të këtyre armiqve të popullit tonë dhe të misioneve anglo-amerikane shpjegohet nga fakti se këta nuk mund të pajtohen me situatën e krijuar në vendin tonë mbas fitores mbi fashizmin dhe marrjes së pushtetit në duart e popullit”.

“Mbas çlirimit, të inkurajuar nga qëndrimi i qeverive anglo-amerikane dhe nga puna e agjentëve të tyre në vendin tonë, aktiviteti i tyre fillon të rritet dhe të grumbullojë rreth vetes reaksionarë të çdo ngjyre.

Që këtu fillon dhe një herë qëndrimi i hapët kundër politikës sonë të jashtme dhe të brendshme si dhe kundër politikës sonë ekonomike”.

Po kështu fliste dhe Tajar Zavalani nga radioja e Londrës më 1945 në lidhje me politikën e kuadrove të rinj duke e quajtur të kotë dhe të dëmshme”.

“Dhe pikërisht në maj-qershor 1945 anglo-amerikanët duan të bëjnë tentativën për të zbarkuar forca të armatosura të tyre në Shqipëri me anë të ML-it, UNRRA-s dhe të kombinojnë këto veprime me bandat e kriminelëve të luftës që ndodheshin në vendin tonë.

Megjithëse kjo tentativë dështoi, në saje të qëndrimit dhe të politikës së drejtë të qeverisë sonë, ata ripërsëritën tentativat e tyre në shtator të 1946-s me lëvizjen e armatosur që bënë në Shkodër.

Njëkohësisht po me këto qëllime anglo-amerikanët kishin krijuar një rrjetë të tërë sipunazhi në vendin tonë me njerëzit më të korruptuar dhe të predispozuar për këtë punë prej shumë kohësh: njerëz të shtresave bejlero-agallarë-tregëtarë që kanë studjuar sidomos në Itali dhe Gjermani.

Armiku këtu përfitoi nga kompozicioni social dhe nga edukata e tyre e dobët: intelektualë të kalbur, njerëz prej shtresave të goditura.

Në këto kondita këta ishin në lidhje me misionet anglo-amerikane, nga të cilat merrnin të holla dhe filluan të organizohen.

Në fillim të 1945-s del organizimi i parë i mbasandaj grupet e klerit katolik etj. dhe më vonë më 1946 grupi i tekniko- -intelektualëve' të Maliqit që organizohet dhe drejtohet nga misioni zyrtar amerikan dhe grupi i deputetëve”.

“Ne i goditëm ata si klasë shfrytëzuese dhe e privilegjuar, konsekuentë në vijën tonë revolucionare, për ndërtimin e shoqërisë së re socialiste në vendin tonë.

Por ata si njerëz ne nuk i zhdukëm.

Në kohën kur ne i jemi përveshur punës së madhe për ndërtimin e ekonomisë së re popullore, kur ne dita-ditës bëhemi më të fortë ata e bëjnë gjithnjë më të ashpër rezistencën e tyre për vdekje duke u hyrë lloj-lloj aventurave me qëllim që të na pengojnë ne në rrugën tonë të lavdishme.

Me forcimin tonë ata bëhen më të egër, shikoni qëndrimin e tyre në burg, ata varin veten, si Kol Kuqali, bien nga

dritaret, si Babai i Krujës, sepse e dinë punën e tyre armiqësore, shikojnë se planet e tyre u zbuluan dhe dështuan në ndërmarrjen e tyre të poshtër për të rrëzuar pushtetin.

Një qëndrim i tillë tregon se ata janë të tërbuar nga goditja jonë e fortë, tregon armiqësinë e tyre të madhe, kjo tregon edhe vendosmërinë që të mos tregojnë rreth aktivitetit të tyre armiqësor”.

“Ndërtimi i ekonomisë sonë nacionale, që për karakterin e saj të ri social, nuk njeh shfrytëzimin e privilegjet e këtyre njerëzve, por përkundrazi i godet definitivisht për vdekje, ndërtimi i kësaj ekonomie, që në saje të forcave krijuese të masave punonjëse të vendit tonë, në saje të forcave tona materiale... nuk njeh nënshtrimin ekonomik dhe politik të imperializmit anglo-amerikan, shpjegon interesimin e madh që tregon imperializmi në veprimtarinë e armiqve tanë të brendshëm, qëndrimin armiqësor të tij kundrejt vendit tonë, shpjegon inkurajimin pa masë, udhëzimet, ndihmat e premtimet, që ai u ka dhënë ngahera armiqve tanë”.

“Organizatata tona duhet të shohin gjithashtu se nga Italia dhe Greqia, ku sundojnë qeveri të ngritura dhe të mbajtura nga imperializmi si është qeveria fashiste e Greqisë dhe ajo e përngjashme [me të], demokristiane e Italisë, reaksioni ynë i brendshëm ka inkurajim dhe ngushëllim në punët e tija, pikërisht këtej ne duhet të shikojmë rrezikun më të madh për ekzistencën tone”.

“Të theksohet se asnjëherë nuk janë goditur njerëz të ndershëm, se çdo gjyq, çdo proces ka nxjerrë në shesh tradhëtarë të popullit dhe këta janë goditur dhe do të goditen sa më rëndë.

Pushteti ynë, pushteti i popullit nuk mbjell terror, e lufton bile me tërë forcat .e tija, por drejtësia e tij godet fajtorët.



Për më tepër organet tona u kanë sinjalizuar shumë njerëzve që të ndreqin rrugën e tyre dhe shumë kanë qenë ata që kanë përfituar, por shumë të tjerë kanë vazhduar me besimin gjer në fund dhe kanë merituar dënimin që u është dhënë.

Kohët e fundit qeveria mori masën për lirimin e 900 të burgosurve dhe 400 të internuarve; kjo tregon drejtësinë e madhe të pushtetit dhe njëkohësisht forcën tonë të madhe si dhe stabilitetin e situatës sonë të brendshme”.

“Të punohet për të rritur besimin në forcat tona, në aleancën me Jugosllavinë dhe në miqësinë e shëndoshë dhe të sigurtë me Bashkimin Sovjetik, mbrojtës i paqes, i demokracisë dhe i independencës së popujve nga agresorët imperialistë dhe veçanërisht i vendit tonë. Ai na është ndodhur mbrojtës kudo që na është paraqitur një nevojë e tillë”.

“Organizatrat tona duhet të dinë ku ta kërkojnë armikun: armiku duhet kërkuar atje ku nuk shkojnë punët, ku pengohet dhe nuk zbatohet plani. Këtu ka armik, por ka dhe njerëz që bëjnë punë armiku, por inkoshientë”.

“Është e qartë se masat policore do të përdoren kundër atyre që vazhdojnë me besim deri në fund në rrugën e armikut”.

...

Vdekje fashizmit-Liri popullit

## Stalini tha

Nga 14 deri 26 korrik 1947 Enver Hoxha do të bënte një vizitë pune në Moskë, të parën e tij.

Kur ndodhte kjo Riza Alizoti që prej një muaji gjendej në burgun e Tiranës, nën një hetim shumë të dhunshëm.

Në datën 14 korrik Hoxha mjaft i gëzuar dhe entuziast do t'i përshëndeste popujt e Bashkimit Sovjetik që nga aeroporti i Moskës, në 23 do të bënte të njëjtën gjë duke u drejtuar popullit të Leningradit dhe në 26 sërish nga aeroporti i Moskës përshendetje popujve sovjetikë.

Po shkonte drejt Shqipërisë.

Kur brenda asaj dite mbërriti në Tiranë mes të tjerash vendit të vet i kumtoi disa mbresa të tij nga vizita:

“Delegacioni i qeverisë sonë shkoi, pra, për vizitë miqësore në Moskë për t'u shprehur popujve të Bashkimit Sovjetik dhe Stalinit të madh ndjenjat e miqësisë së madhe, që ushqen populli ynë për ta dhe për ta forcuar sa më shumë këtë miqësi dhe marrëdhëniet në mes të popullit tonë të vogël dhe Bashkimit të madh Sovjetik, të behen sa më të shëndosha dhe konkrete”.

“Ne pamë në Bashkimin Sovjetik gjëra të habitshme.

Ne vizituam fabrika nga më të mëdhatë dhe më modernet në botë. Nuk mund të imagjinohet pa e parë me sy, se me ç'vullnet, se me ç'rregull dhe disiplinë punohet atje”.

“Jeta atje ishte rilindur, ishte e gëzuar, e lumtur si më parë. E pavdekshme do të jetë vepra e popujve dhe e

regjimit sovjetik. E pavdekshme në shekuj do të ndriso vepra madhështore Stalinit të madh”.

“Ne u pritëm prej Gjeneralisimit Stalin me përzemërsinë më të madhe dhe jo vetëm një herë. Kryetari i lavdishëm i popujve sovjetikë u interesua pa masë për popullin tonë, përpjekjet dhe luftën e tij ai e kishte ndjekur me kujdesin më të madh, sikundër që ai e ka studjuar më së miri origjinën e popullit tonë”.

“Ne patëm bisedime për problemet e rëndësishme të vendit tonë, me Gjeneralisimin Stalin, me shokun Mollotov dhe me anëtarë të tjerë të qeverisë dhe të gjitha këto probleme u zgjidhën më së miri dhe nga ana e tyre u tregua gatishmëria më e madhe për ta ndihmuar popullin tonë.

“Ne do ta ndihmojmë popullin tuaj — na tha shoku Stalin — pse shqiptarët janë njerëz të rrallë”.

Kërkesat që bëmë ne na u pranuan menjëherë dhe qeveria sovjetike pranoi të na japë ndihmë për ngritjen e ekonomisë sonë dhe të jetës së popullit tonë.

Qeveria sovjetike do të na ndihmojë me kredi duke na dhënë fabrika e traktorë, ajo do të na ndihmojë në lëmin kultural, arsimor e gjetkë”.

“Mirënjohja e popullit tonë është e pakufishme ndaj popujve të dashur miq të Bashkimit Sovjetik, ndaj Stalinit të madh”.

## **Ishte goditje kundër qëllimeve të udhëheqësve jugosllavë**

Në vitin 1982, në faqen 209 të historisë së Shqipërisë thuhet:

“Në rrethana jashtëzakonisht të vështira dhe pa përfillur kërkesat jugosllave, shoku Enver Hoxha në krye të një delegacioni qeveritar shkoi në Moskë dhe përfundoi në korrik 1947 një marrëveshje ekonomike me BS.

Sipas kësaj marrëveshjeje, qeveria sovjetike, e kryesuar nga J. V. Stalini, i jepte Shqipërisë një kredi për zhvillimin e bujqësisë dhe të industrisë”.

Në këtë tekst është edhe citimi “Kjo ndihmë ishte një goditje kundër qëllimeve të udhëheqësve jugosllavë që dëshironin ta kthenin vendin tonë në një koloni të tyre”.

### **Studiuesit Bernard Zotaj dhe Marenglen Kasmi thonë**

Ndërkaq në faqen 126 të librit shkollor për historinë shqiptare për klasën e 12-të gjimnaz, me autorë Bernard Zotaj dhe Marenglen Kasmi, viti 2012, shkruhet:

“Duke ndier rrezikun jugosllav, Enver Hoxha u mundua të lidhej drejtpërdrejt me Bashkimin Sovjetik dhe të siguronte mbështetje dhe ndihmë ekonomike, por edhe të forconte pozitat e tij.

Në fakt, Bashkimi Sovjetik e kishte njohur qeverinë shqiptare qysh në vitin 1945 dhe midis dy vendeve ishin vendosur marrëdhënie diplomatike.

Në vitin 1947, marrëdhëniet shqiptaro-sovjetike, sidomos pas takimit të E.Hoxhës me Stalinin, u rritën ndjeshëm në të gjitha fushat.

Kjo gjë nuk u prit mirë nga qeveria jugosllave.

Ajo nxitoi të realizonte projektin e Federatës Ballkanike, ku Shqipëria do të ishte e para që do t'i bashkohej kësaj Federate”.

Shënojmë se Jugosllavia ishte i pari shtet që e njohu zyrtarisht qeverinë e Enver Hoxhës në 1 maj 1945.

## **Stalini: Shqiptarët mund të jenë besnik si qentë**

Ish ambasadori shqiptar në Moskë, Shaqir Vukaj, në librin “Rusia dhe Kosova”, marrë sipas gazetës “Borba” të vitit 1989, riboton këtë dialog të Josif Visarionoviçit me disa udhëheqës të lartë jugosllavë, të ndodhur në Moskë, në 19 prill 1947, dy muaj më herët se ai të takohej me Enver Hoxhën:

Stalini – Po si i keni punët me shqiptarët? Hoxha sikur është ankuar për këshilltarët tuaj politikë në ushtrinë e tyre, sikur ata e dobësojnë disiplinën, apo jo.

Eduard Kardeli – Kjo është gjë e re për ne. Ata nuk na kanë thënë asgjë për këtë.

Stalini – Cila është origjina e shqiptarëve?

Kardeli – Ata janë pasardhës të ilirëve.

Stalini – Më kujtohet se Tito më ka thënë se ata janë si puna e baskëve.

Kardeli – Kjo është e vërtetë;

Stanoje Simiçi (ministër i Jashtëm i Jugosllavisë-shënimi ynë) – Ka të dhëna që thonë se shqiptarët janë populli më i vjetër në Gadishullin Ballkanik. Disa fjalë prej tyre vërtetojnë se gjuha shqipe është më e vjetër se greqishtja. Fjala e tyre “Afrodita” është huazuar nga gjuha shqipe.

Në gjuhën greke kjo nuk ka kuptim.

Stalini – Ky popull ka mbetur shumë mbrapa në zhvillim. Vladimir Popoviç (Gjeneral-Major, nënministër i Punëve të Jashtme të Jugosllavisë-shënimi ynë) – Shqiptarët janë shumë trima dhe njerëz besnikë.

Stalini: Po, ata mund të jenë besnik si qentë. Ajo është karakteristikë e popujve primitivë. Tek ne, ashtu besnik kanë qenë çuvashët. Carët e Ruisë i mbanin për roje personale.

Kardeli – Tek ne, në territorin e Kosovës dhe Metohisë edhe sot jetojnë më shumë shqiptarë se sa serbë. Ne mendojmë, që më vonë, kur të vendosim lidhje më të ngushta me shqiptarët, këto territore tua japim atyre.

Stalini – Po si janë ndodhur shqiptarët në këto territore?

Kardeli – Janë vendosur në këtë krahinë në kohën e turqve. Ndërsa një pjesë e popullsisë është asimiluar.

Stalini – Po si ka mundësi që një popull me nivel më të ulët zhvillimi, ka mundur të arrijë një gjë të tillë? Si shpjegohet kjo?...”

## **Shqipërinë si “Republikë të Shtatë” e dëshironte më shumë Bashkimi Sovjetik**

Në librin e tij “Biseda me Stalinin” politikani dhe studiuesi jugosllav komunist liberal Millovan Gjilas, ka shkruar:

“Andej kah fundi i dhjetorit 1947, ne morëm një telegram të Stalinit përmes të cilit kërkohet që një anëtar i Komitetit Qendror jugosllav – mundësisht unë – të vinte në Moskë për të stabilizuar një vijë politike të përbashkët të dy qeverive në lidhje me Shqipërinë...”

“Nuk ishte ndërkohë krejt e qartë arsyeja përse Stalini ishte shprehur përjashtimisht që të shkoja unë. Në librin tim “Biseda me Stalinin” kam shtjelluar dy hipoteza.

E para ishte se Stalini më njohte si një njeri të hapur dhe të sinqertë.

E dyta ishte...unë i përkisja rrethit të bashkëpunëtorëve më të ngushtë të Titos qysh nga viti 1937, kur Tito kishte marrë drejtimin e partisë.

Ndërkaq, në Beograd nuk mora urdhra apo instruksione të veçanta, sepse përveç të tjerave, nuk ishin të nevojshëm, ngaqë isha krejtësisht i informuar mbi marrëdhëniet jugosllavo-shqiptare, si dhe për ndërhyrjen “e ashpër” dhe “të papërgjegjshme”, siç ne i përcaktonim, të misionit sovjetik në Tiranë...”

Në Moskë disa orë mbas arritjes sonë, ndërkohë që merreshim vesh me ambasadorin tonë Vladimir Popoviç, duke u treguar lajmet e fundit nga Jugosllavia dhe duke na



pyetur për perspektivat që hapnin për ne marrëdhëniet me BRSS, bie telefoni.

Ishte ministri i Jashtëm sovjetik, i cili njoftonte se Stalini dëshironte të më priste nëse nuk isha shumë i lodhur... Nga ora nëntë e mbrëmjes (në 16 janar 1948, gjashtë muaj më pas nga takimi i kryekomunistit sovjetik me Enver Hoxhën-shënimi ynë), më drejtuan për në Kremlin në zyrën e Stalinit.

Së bashku me të ishin Molotovi e Zhdanovi, ky i fundit me cilësinë e përgjegjësit për marrëdhëniet me partitë komuniste të huaja.

Mbas përshëndetjeve dhe riteve të takimit, Stalini u ul para tryezës dhe menjëherë shtroi problemin për Shqipërinë: “Kështu pra, në Komitetin Qendror shqiptar vriten për fajin tuaj! Keq, shumë keq!...”.

Unë pohova faktin se situata ishte e papëlqyeshme dhe nisa të shpjegoj se Nako Spiru me kundërshtimin e tij në riafrimin me Jugosllavinë, ishte vetizoluar brenda Komitetit Qendror të tij.

Por, pa mbaruar unë, për befasinë time, Stalini ndërhyr duke thënë: “Shqipëria nuk na shqetëson aspak për këtë Nuk kemi asgjë kundër që Jugosllavia ta gëlltisë”.

Dhe çon gishtin në gojë, me gjestin e gëlltitjes.

Duhej të stepesha keqas, por gjithsesi u sforcova për t’u bindur për kuptimësinë e këtyre fjalëve dhe këtë gjest apo shpirtin e humorit të tij sarkastik dhe piktoresk.

Dhe përmblodha veten duke thënë: “Nuk është fjala për “të gëlltitur” diçka, por për të mbërritur te bashkimi...”

“Ah, po kjo do të thotë pikërisht “ta gëlltitësh”, – ndërhyri Molotovi.

Dhe Stalini që rithekson, duke e përsëritur gjestin: “Po, po, ta gëlltisësh. Jemi dakord që këtë ju ta bëni – madje sa më parë që të jetë e mundur, aq më mirë është”. Sigurisht përsiatja e “gëlltitjes” njihet ndër ne”.

## **Abdyl Këllezi kritikon Jugosllavinë**

Në arkivin e Jugosllavisë, në dosjen Informacione mbi marrëdhëniet jugosllavo-shqiptare, e datës 1 gusht 1947 thuhet se Abdyl Këllezi, zëvendës ministër i Financave, në Kuvendin Popullor hapur kritikoi Jugosllavinë dhe falënderoi Bashkimin Sovjetik “duke vënë në dukje se ekspertët sovjetikë janë me vlera, të besueshëm, që i mbarojnë në kohë përgjegjësitë dhe që nuk shohin orën kur do përfundojë puna, ndërsa jugosllavët nuk i shtrohen punës, nuk punojnë, presin fundin e orarit të punës dhe se midis tyre ka edhe sabotatorë”.

## **Bullgaria “Republika e Tetë”?**

Gazeta “Borba” e 3 gushtit 1947 boton përmbajtjen e plotë të një marrëveshjeje të pazakontë bullgaro-jugosllave.

Në të thuhet se “Jugosllavia dhe Bullgaria do të përpiqen të zhvillojnë gjersa të jetë e mundur shkëmbimin e mallrave dhe bashkëpunimin ekonomik mes dy vendeve, do të unifikojmë monedhat, do të përgatiten për krijimin e një sistemi të përbashkët doganor dhe sa më shumë të koordinojnë planet e tyre ekonomike”.

Në ditët pas kësaj marrëveshjeje, Tito dhe Dimitrovi deklaruan se Jugosllavia dhe Bullgaria ishin të gatshme të bashkoheshin në një shtet të vetëm: Bashkimi i Republikave Popullore të Sllavëve të Jugut.

Por kjo ishte bërë pa këshillimin e Stalinit.

Dy javë pas nënshkrimit të këtij pakti, ky nëpërmjet të dërguarit sovjetik në Jugosllavi, A. I. Lavrentjevit, i dërgoi Titos një telegram në të cilin i shkruante se të dyja qeveritë kanë gabuar duke përmyllur paktin mes tyre pa një këshillim të mëparshëm me Bashkimin Sovjetik dhe nxitimin e të dyja qeverive mund të shfrytëzonin elementët anglo-amerikanë duke ndërhyrë në Greqi dhe Turqi për të dëmtuar Jugosllavinë dhe Bullgarinë.

## **Me veprimtari sabotuese të drejtpërdrejtë**

Iljaz Fishta dhe Veniamin Toçi në librin e tyre “Ekonomia e Shqipërisë në vitet e para të ndërtimit socialist”, mes të tjerash shkruajnë se “Në një përkujtesë të muajit gusht 1947 të përfaqësisë shqiptare në shoqërinë e përbashkët të naftës dërguar Ministrisë së Industrisë të RPSH flitej për dëmet që po i shkaktoheshin industrisë së naftës nga mosardhja e makinerive dhe e pajisjeve nga Jugosllavia, për veprimet e parregullta të specialistëve jugosllavë dhe për orvajtjet e tyre që të shkëpusnin drejtimin e naftës nga organet shtetërore shqiptare”.

Po ashtu në këtë botim të kryer para rënies së diktaturës, dy autorët këmbëngulin se “Titistët e dëmtuan industrinë tonë të naftës edhe me veprimtari sabotuese të drejtpërdrejtë, me qëllim që t’i krijonin vështirësi ekonomisë shqiptare për sigurimin e lëndëve djegëse dhe Shqipëria të gjunjëzohej para tyre”.

## **Nafta nuk del vetë, kërkon pajisje**

Në librin e tij “Titistët” Enver Hoxha ka shkruar:

“Por do të vinte një ditë kur Savo Zllatiçi do të hynte në zyrën time me një fije letër të gjatë e do të ma lëshonte përpara: S'po zbatoni detyrimet kontraktuale! — do të protestonte. — S'na keni dërguar kaq mijë tonë naftë!

E di, — i thashë, — dhe më vjen keq për këtë. Por a keni pyetur pse? Naftën e nxjerr shoqëria e përbashkët, jona dhe juaja. Sipas kontratës, ju paraprakisht duhet të kishit sjellë që para një viti pajisjet përkatëse për shpim e për nxjerrjen e naftës.

Këto nuk i sollët dhe, dihet, nafta nuk del vetë”.

Në po këtë libër Hoxha thekson: “I kishim kaluar si gabime personash, “specialistësh” edhe djegiet e mëdha të gazit në Kuçovë, edhe shpimet e puseve pa asnjë kriter e studim, edhe pengesat e zvarritjet e gjithfarëllojshme në hekurudhë, edhe humbjet “udhës” të miliona dinarëve të kredive (na thuhej se “u nisën nga Beogradi, por s'dihet ku mbetën”), edhe ngecjen në vend të punimeve në Hidrocentralin e Selitës, edhe vjetërsirat e skurjasura që zbuluam nën bojën me të cilën ishin lyer “të famshmet fabrika”...

Por tani po sqarohej gjithçka.

Po sqarohej se ndodheshimn përballë një veprimtarie sabotuese, antimarksiste e antishqiptare, të planifikuar dhe të udhëhequr nga krerët e Beogradit për të realizuar

synimet e tyre të vjetra: të pengonin zhvillimin e ekonomisë sonë dhe ta vinin atë nën varësinë e plotë të tyre...”.

## **Vrasja e Stanisllav Zuberit**

Në 14 prill 1991 në gazetën e atëhershme “Republika” shkrimtari Petro Marko botoi artikullin “Krim kundër kulturës universale”, me në qendër Stanisllav Zuberin, gjeolog polak që kishte dhënë një kontribut të rëndësishëm në studimet e zonave naftëmajtëse shqiptare, kryesisht në territorin e Kuçovës së sotme

I thirrur në punë prej italianëve të AIPA, për dy dekada ai kishte qëndruar në Shqipëri.

Gjatë luftës nga bombardimet e aviacionit anglo-amerikan, kur u godit Kuçova, mes të vrarëve që edhe e shoqja e Zuberit.

Pas çlirimit ai u emërua si këshilltar i gjeologjisë pranë Këshillit të Ministrave.

Petro Marko shkruan: “Dhe më 1947 e njoha edhe unë. Ai më mbante mend, se e dinte që isha përgjegjës i gazetës “Bashkimi”, dhe kishte tentuar të më shkruante që ta shpëtoja e ta liroja, se e akuzonin për një sabotim në Kuçovë.

Dhe tani ja ku ishim të dy: – ai i katandisur një grusht njeri, unë një skelet i gjallë i ngarkuar me hekura.

Me Zuberin shkëmbenim ndonjë fjalë: ai, i shtrirë përdhe, unë, i varur.

Ai murmuriste gjithë ditën dhe, pasi e pyesja se ç`murmuriste, thoshte: – Tani jam duke bërë një leksion për shkaqet pse disa zona janë të pasura me naftë, si ato të



Lindjes së Mesme . . . Tani jam duke u lutur, – ai ishte katolik dhe lutej....

Hynë në birucë dy hetues, – njeri e ngriti Zuberin dhe e nxorri jashtë birucës, tjetri ndenji me mua dhe më tha: – Pa pyete këtë armik a ka flori toka shqiptare. Ai ka bërë hartën gjeologjike, por nuk ka shënuar gjëkund se ku ka flori . . .

Unë qesha me vete dhe i thashë hetuesit kallp: – Po të kishte flori, për kë e ka fshehur? Po të ishte për italianët, do ta kishte shënuar. Për kë e ka fshehur?

– Këta agjentë . . . janë djallëzorë . . . Po ti pyete, po ta japim si “detyrë patriotike” se nuk ka mundësi që të mos ketë flori gjithë kjo tokë.

Kur u kthye përsëri në birucë Zuberi, u shtri dhe qeshte.

– Pse qesh, i thashë ?

– Më shtrëngojnë të them pse nuk kam shënuar zonat ku ka flori toka shqiptare. Dhe unë u thashë se nuk ka. Ata më shkelmuan dhe më shanë “agjent i shitur”.

– Me të vërtetë, a ka flori Shqipëria ?

– Po të kishte, unë patjetër që do ta kisha shënuar, si të gjithë mineralet e rralla. Në të vërtetë, ka në disa zona, por duhet njëzet herë më shumë flori për ta nxjerrë atë sasi. Këta janë injorantë. Unë, kur kam bërë hartën gjeologjike, e kam bërë si gjeolog dhe jo si agjent ose spiun. Ç`janë këto që po dëgjojmë?!

. . .

– “A e di? – më tha një ditë Zuberi – Këtu, ja Enveri, ja Koçi janë agjentë të huaj, besoj të Jugosllavisë. Se nuk lanë intelektual të gjallë, me qëllim që ata të sjellin të tyret”.

U hap dera.

Hyri një polic trupmadh dhe i bërtiti Zuberit.

– Ç`punë bën ti ?

– Gjeolog që zbulon pasuritë e nëntokës, – iu përgjigj i frikësuar Zuberi.

Roja i këputi një shkelm me sa fuqi pati, prapa veshit duke i thënë “Tani shko e zbulo pasuritë e nëntokës”

Kisha mbyllur sytë dhe çudi se si nuk më pushoi zemra. Me frikë, hapa sytë dhe pashë Zuberin të shtrirë, me duar e me këmbë të hapura dhe me një curril gjaku që i buronte nga goja.

Bëra të lëvizja, t’i vija në ndihmë, por isha i varur në dritare.

M`u errën sytë. M`u err mendja. Desha të bërtisja, që të më dëgjonte gjithë bota: – Krim ! Krim universal ! Stanisllav Zuberin e vranë ! Vranë kulturën, vranë shkencën, vranë jetën.

U hap përsëri dera. Hyri ai polici që e goditi, bashkë me dy të tjerë.

E panë.

– Ngordhi qeni ! – tha ai që e goditi.

E kapën nga këmbët, e hoqën zvarrë, e nxorrën jashtë dhe mbyllën derën...

## **Deklaratë e Koçi Xoxes**

Në përurimin e mbarimit të punimeve të hekurudhës Durrës-Peqin, 7 nëntor 1947, Koçi Xoxe deklaroi:

“Ekzistenca e Jugosllavisë Federative Popullore në kufi është një fat për Shqipërinë, është një siguri e madhe për jetën tonë, për zhvillimin tonë të përgjithshëm.

Ndryshe, pa një Jugosllavi të popujve të Jugosllavisë dhe të fortë nga çdo pikëpamje, do të ishte në rrezik qenia e jonë si popull i lirë”.

## Sipas librit “Vaji i Gurit” të Miranda Haxhisë

Një ditë përpara se të fillonte gjyqi, më 3 shtator 1947, Komiteti Ekzekutiv i K.P. të Nënprefekturës së Qendrës së Beratit vendosi sekuestrimin e gjithë pasurisë së Riza Alizotit.

Sipas librit shumë të vetëndjerë dhe të shkruar bukur “Vaji i Gurit”, i Miranda Haxhisë, UETPRESS 2021, një pjesë e sendeve të sekuestruara të familjes së Rizait dhe të bashkëshortes së tij Vera Ypi, qenë: një pasqyrë e vogël kristali, një shami e vogël mermer, një këllëf termometri, një fustan i bardhë, një vello krevati për mishkonja, një kanistër e prishur, një palë çisme lëkure, dy shporta, një tavëll cingari qelqi, një mbulesë tavoline e vogël, një kanistër, një kolltuk, katër korniza, një dyshek me pendë, një kolltuk, një mbajtëse librash, një sahat floriri për femra, një lule floriri me gurë të ndryshëm, pesha 80 gram, një copë me gur 60 gram, një karficë e rrumbullakët me 6 gurë 17 gram, një pafkë me katër gurë të kuq 6 gram e një çerek, serma në forma të ndryshme, lugë, ibrik, thika, pironj, çantë, tavëll, një kuti me peshë katër kilogram e nëntëqind e gjashtëdhjetë gram...”

Vetëm dy javë e disa ditë më pas, në 27 shtator 1947, Gjykata e Lartë Ushtarake pasi e deklaroi Riza Alizotin fajtor si “armik i popullit dhe sabotator i pushtetit”, bashkë me varjen në litar e dënoi me konfiskim të pasurisë së luajtshme e të paluajtshme.

Konfiskimi i kryer më parë pati qenë me urdhër politik.

## **Agjent i spiunazhit amerikan që më 1925!!**

Në gazetën “Bashkimi” të 11 shtatorit një faqe e tërë e ka titullin germëmadh “Në ditën e gjashtë të gjyqit kundër grupit tradhtar të mbeturinave të ballit dhe legalitetit dhe agentave të huaj Riza Alizoti pohon sabotimet e bëra në Kuçovë nga agjentët e Fultzit”.

Si nëntitull janë këto fjalë “Fultzi na tha se veprimet e misionit anglez u demaskuan dhe populli e mori vesh se ata ishin armiqtë e tij. Natyrisht duhej të hiknin se iu duallnë lakrat sheshit”, deklaroi spiuni Riza Alizoti.

Shkrimi fillon me këtë nën titull tjetër në krye të tij: “Riza Alizoti, i biri i Fejzi Alizotit agjent i spiunazhit amerikan që më 1925 është një nga organizatorët e grupit të teknikëve tradhtarë”.

Në vitin 1925 Riza Alizoti qe vetëm 15 vjeç.

## **Gjyqi kundër “Grupit të Deputetëve”**

Opozitës politike ndaj qeverisë komuniste, u krye në Kinema Nacional të Tiranës.

Pjesa e parë e këtij procesi, i cili do të bëhej total në 17 shtator 1947, pati filluar më parë, që në datën 4.

Fillimisht objektiv goditjeje qe një pjesë e të arrestuarve, ai i cili u quajt “Grupi i Shefqet Bejës”.

Beja që prej 2 dhjetorit 1945 ishte deputet i zgjedhur si përfaqësues i Frontit Demokratik. Ai, ekonomist, financier dhe tregtar i njohur, qe pjesëmarrës aktiv në Lëvizjen Nacionalçlirimtare.

Shefqet Beja kishte kontribuar shumë për daljen e gazetës “Bashkimi” dhe ishte gjithashtu Nën President i Frontit Demokratik.

Akuza për të dhe tërë grupin e tij, si edhe në vijim, në gjyqin kryesor të zhvilluar në 27 shtator kundër gjithsej 24 opozitarëve, qe: “Duke formuar një organizatë tradhëtaro-sabotatore, të lidhur me kriminelët e luftës jashtë dhe brenda Shqipërisë dhe të shtyrë e të ndihmuar nga agjentat e imperializmit Anglo-amerikan, kanë kryer akte sabotazhi, spiunazhi, terrorizmi për rrëzimin me forcë të Pushtetit Popullor dhe për sjelljen në fuqi të regjimit shtypës të Ballit e Legalitetit”.

## **Nuri Huta**

Një foto e 4 shtatorit 1947, propaganduese zyrtare e këtij procesi, kishte si deçiturë fjalët: “Gjyqi kundër Grupit të Deputetëve Tradhëtarë dhe armiqve të tjerë të popullit. Trupi gjykues me kryetar (në mes) major Niko Çeta”.

Në 9 shtator Trupit të Gjykatës së Lartë Ushtarake Tiranë iu nis kjo letër:

“Ne, nëpunësit e Komisionit të Planit, të mbledhur sot, më datë 8-9-1947, në një konferencë Sindikale për punimin e akt-akuzës së Prokurorit të Popullit, kundër grupit udhëheqës t’Organizatës Trathtare sabotatore që sot janë në bankot e t’akuzuarve; t’indinjuar nga trathëtija e tyre e lartë, dhe duke dashur të mbrojmë fitoret dhe interesat e Popullit t’onë, çfaqim urretjen më të madhe kundër armiqve të Popullit dhe kërkojmë nga Trupi Gjykues vendimin e drejtë për dënimin e tyre kapital”.

Në 10 shtator faqja e parë e “Bashkimit” publikonte shumë dukshëm kryeartikullin me titull “Në gjyqin e spiunëve dhe sabotatorëve dalin në shesh”, “Mbrapaskenat e “diplomacisë” anglo-amerikane në Shqipëri”.

Autor qe Nuri Huta.

Sipas [www.shqipopedia.org](http://www.shqipopedia.org), ky “Më 14 gusht 1944, vrau një partizan.

Ka qenë i ngarkuar nga Koçi Xoxe të vriste Mid’hat Frashërin.

Më 1945, u caktua zv/shef i misionit ushtarak shqiptar në Beograd.

Ai hodhi i pari parullën, e preferuar asokohe, se “Rruga e Shqipërisë për në Moskë kalon nga Beogradi”.

Pas prishjes së Shqipërisë me Jugosllavinë, u arrestua.

Më 10 qershor 1949, me vendim nr. 1, Gjykata e Lartë e dënoi për “faje kundra popullit dhe ka marrë pjesë në organizata fashiste», me 10 vjet burg dhe humbjen e të drejtës elektorale për 5 vjet”.



## **Kërkojmë dënimin e tyre me vdekje**

Në 12 shtator drejt Trupit të Gjykatës së Lartë Ushtarake u nis kjo letër tjetër:

“Shoku Prokuror!

Populli i Rajonit Nr.2, Tiranë, i mbledhur në një miting të math prej më se 600 vetësh, me rastin e nxjerjeve të vullnetarve për Hekurudhë që ze vendin kryesor në Planin e Shtetit, i mbushur plot me urrejtje karshi veprës të deputetëve tradhtar, spiuna të vjetër t’imperializmit Anglo-Amerikan, të sabotatorëve kriminel armiq të popullit, kërkon dënimin e tyre me vdekje mbasi rruga që këta ndiqnin kish për qëllim rezimin me forcë Pushtetit Popullor ngritja e të cilit na kushtoj kaq gjak e sakrifica”.

## **Enver Hoxha me uniformë ushtarake**

Ditën e martë, 14 shtator 1947, e përditshmja “Bashkimi” në faqen e parë kishte një foto portret të madh të Enver Hoxhës me uniformë ushtarake si edhe shumë dekorata në gjoks.

Po ashtu edhe dy shkrime të vendosur tepër dukshëm.

I pari qe kryeartikulli “Pesë vjet më parë u mblodh Konferenca e I-rë N. Çl. e Pezës”.

Qe shkruar nga Fadil Paçrami.

Artikulli i dytë ishte titulluar “Rrofshin Pola, Istria dhe breg-deti Slloven të lirë”.

## **Ne, marangozat dhe muratorët**

Këtë 14 shtator Trupit të Gjykatës së Lartë Ushtarake Tiranë iu nis kjo letër:

“Ne, marangozat dhe muratorët e N/sek IV në një Konferencë që bën të gjithë së bashku mbasi dëgjuam dhe mësuam mbi gjyqin e Kriminelave që zhvillohet në Tiranë.

Neve çfaqim urrejtjen karshi tyre dhe kërkojmë nga Trupi Gjykyes që tu jepet dënimi i merituar.

Ne kërkojmë dënimin me Vdekje të Kriminelave sabotatorve armiqve të popullit shqiptar”.

Njëkohësisht në 16 shtator u formulua edhe kjo letër:

“Vdekje Fashizmit-Liri Popullit

Prokurorit të Gjykatës së Naltë ushtarake

Tiranë

Duke ndjekur me interesim gjyqin që zhvillohet kundër sabotatorëve, deputetëve tradhëtorë, spiunave dhe mbeturinave të ballit e legalitetit, po konstatojmë çdo ditë më kuartë dëmet që i kanë shkaktuar këta pushtetit, me qëllim që të shkojë kotë djersa dhe gjaku i Popullit Shqiptar.

Mbasi personat që ndodhen në duart e Drejtësisë së Popullit, janë të zhytur këmbë e krye në tradhti dhe janë shitur te imperialistat e huaj, anglo-amerikanët, me qëllim që të zhysin Atdhën dhe t'i shkaktë mjerime të reja popullit t'onë, lypim, shoku prokuror që të kërkon nga trupi gjykyes dënimin më të rreptë, mbasi e meritojnë. Me

një dënim të këtillë ata do të mund të paguajnë një herë e mirë krimet dhe dëmet e shkaktuara”.

## **Shkëlqesisë së Tij, Mareshallit Josif Broz Tito**

Në 16 shtator 1947, e enjte, gazeta “Bashkimi” në krye të faqes së parë dhe saktësisht në mes të saj, më dukshëm se çdo shkrim tjetër, botonte atë me titullin “Gjen.Kol. Enver Hoxha përshendet Mareshallin Tito për bashkimin e Pola-s, Istrias dhe breg-detit Slloven të R. F. P. të Jugosllavisë”.

Shkëlqesisë Tij

MARESHALLIT JOSIF BROZ TITO

Kryetar i Këshillit Ministror dhe Ministër i Mbrojtjes  
Kombëtare të Jugosllavisë

Beograd

Ne përshendesim me gjithë shpirt bashkimin e Pola-s, t'Istrias dhe të bregdetit Slloven me mëmëdhen, me Republikën Federative Popullore të Jugosllavisë.

Më lejoni Zoti Mareshall të ju shpreh n'emër të Popullit Shqiptar, n'emër të Republikës Popullore si edhe në emërin t'im personal, gëzimin që ne provojmë me këtë rast, mbasi ky eveniment historik i jep fund definitivisht periudhës së gjatë të shtypjes fashiste, të persekutimeve e të terrorit dhe inauguron për Kroatët e Sllovenët të krahinave të çliruara një jetë të re, të lirë e të lumtur”.

GJENERAL KOLONEL ENVER HOXHA

Kryetar i Këshillit Ministror dhe Ministër i Punëve të Jashtme të Shqipërisë”

## **Dy telegrame solidariteti për dënime me vdekje**

Një foto e 17 shtatorit 1947 shoqëron me pamje të qartë tekstin: “Gjyqi kundër Deputetëve Tradhëtarë dhe armiqëve të tjerë të popullit. Armiqtë e popullit Sheh Karbunara dhe Shefqet Beja japin llogari para prokurorit Josif Pashko”.

Në 19 shtator: “Telegram

Durrës

Gjykatës Naltë Ushtarake Tiranë

Ne 13500 vullnetarët e Hekurudhës së parë të Rinis, duke ndjekur me vëmendje zhvillimin e procesit të Gjyqit kundra tradhëtarëve, spiunëve dhe armiqve të popullit shprehim urrejtjen më të madhe për veprat e tyre kriminale të poshtra.

Ne që sulmojmë natë e ditë me kazma dhe lopata në shkëmbinj dhe objekte e që nuk kursejmë as pikën e fundit të djersës për të ndërtuar jetën e re nën udhëheqjen e Enverit dhe të Partisë nuk durojmë që të cenohet Pushteti i jonë Demokratik dhe veprat tona të lavdishme që po ngrehim sot.

Të revoltuar pra në kulm për krimet e tyre në kurris të popullit kërkojmë nga trupi Gjykues që shpata e Drejtësisë të bjeri e pamëshirshme mbi këta spiunë sabotatorë mbeturina të Ballit dhe Legalitetit të shitun me sterlinat e Anglo-Amerikanve”.

Më 21 shtator: “Ushtria Kombtare Shqiptare

Komanda e Bat. Automob. Instrukтив

Vdekje Fashizmit-Liri Popullit

Gjykatës Lartë Ushtarake Tiranë

Na, ushtarët N/Oficerat e Oficerat e Batalionit Aut. Instrukтив’duke ndjekun me kujdes dhe me vëmendjen ma të madhe leximin e gazetave “Bashkimi dhe Luftëtari”, një vëmendje të veçantë ju kemi kushtuar faqeve të tyre ku bëhet fjalë mbi zhvillimin e seancave të Gjyqit të kriminelave dhe sabotatorëve të Popullit dhe të Republikës t’onë Popullore qi mundëm ta fitojmë nëpër mjet shumë betejave të përgjakëshme me armiqt e jashtëm dhe me ato të Mbrendshëm me shokët e atyne qi sot janë kapun nga Populli dhe janë paraqitur para bankës t’akuzuarve për të dhanun llogari për krimet dhe qëllimet e tyre qi kanë pasun për të përmbysun Pushtetin Popullor me anë t’intervecjonit të huaj imperialist.

Prandaj shoku Prokuror urrejtja e jonë shtohet dhe bëhet akoma ma tepër përpara atyne kriminelëve dhe spiunëve të Anglo-Amerikanëve qi kanë dashtë me ndamun dhe copëtuar Shqipninë për interesat e tyre imperialiste, të cilët e pohojnë dhe vetë sot me radhë përpara Gjyqit të Popullit....

Agjentët dhe spiunazhet e imperializmit, sabotatorët dhe armiqt e Popullit Shqiptar nuk kanë pasë kurrë ndonji herë dhe nuk do të kenë vend ma në Shqipninë e Enverit t’onë të dashtun t’Udhëheqësit të Çqvar të Popullit Shqiptar...

Na për këtë shoku Prokuror kemi besimin e plotë qi juve do të jeni të pa mëshirshëm me vendimet e drejta qi do të ketë Gjyqi i Lartë Ushtarak”.

### **Ditën e enjte, 23 shtator 1947**

Gazeta “Bashkimi” e boton në faqen e parë kryeartikullin e vet me fjalët germëmëdha “Prokurori i popullit bëri pretencën e tij kundra tradhtarëve të Republikës Popullore dhe kërkoi dënimin me litar për Shefqet Bejën, Riza Alizotin dhe Sulo Klosin, dënimin me vdekje për 15 të pandehur të tjerë dhe gjashtë veta me burgime të ndryshme”.

Nëntitulli ka fjalët: “Populli shprehu indinjatën e tij të thellë kundra këtyre tradhtarëve, duke aprovuar kërkesën e drejtë të prokurorit”.



## **Raport i ambasadorit italian në Shtetet e Bashkuara të Amerikës**

Në 23 shtator 1947, ora 21.43, ambasadori italian në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Alberto Tarkiani (Alberto Tarchiani), do t'i dërgonte në Romë ministrit të Jashtëm Karlo Sforca (Carlo Sforza) një telegram tepër sekret, në të cilin e vinte në dijeni se “acarimi amerikan kundër Bullgarisë dhe Shqipërisë tani është në kulmin e tij”.

Arsyeja e këtij qëndrimi të Uashingtonit zyrtar ndaj Bullgarisë kishte lidhje “me ekzekutimin e Petkovit” dhe ajo ndaj Shqipërisë me “akuzat kundër U.S.A. në gjyqin e Tiranës”.

## **Sofje, pushkatohet Nikolla Petkov**

Ditën e 23 shtatorit 1947, kur ambasadori Alberto Tarkiani hartonte telegramin e tij për shefin e vet në kryeqytetin italian, në Sofje ishte pushkatuar Nikolla Petkov.

Qe 54 vjeç.

Ai ishte djali i politikanit Dhimitër Petkov, lindur në 2 nëntor 1858 dhe ndërruar jetë në 11 mars të vitit 1907. Ai për pesë mote pati qenë kryetar i bashkisë së Sofjes dhe qe po ashtu njëri nga drejtuesit e Partisë Popullore Liberale Bullgare.

Nga 5 nëntori 1906 deri në në fund të jetës ishte kryeministër i vendit.

Veteran i Luftës Ruso-Turke të periudhës 1877-1878 ai gjatë luftimeve humbi njërin krah.

Dhimitër Petkov u vra nga një anarkist në 11 mars 1907.

Njëri djalë i tij, Petko Petkov, u qëllua për vdekje nga një vrasës i panjohur në vitin 1924.

Djali tjetër i tij, Nikolla Petkov, qe gjithashtu politikan. Kishte studiuar për drejtësi dhe politikë në Sorbonë, Paris. Pas përfundimit shkëlqyer të diplomimit në vitin 1922 ai nisi punën në legatën bullgare të kryeqytetit francez.

Pas një grushti shteti në 9 qershor 1923, Nikolla Petkov dha dorëheqjen dhe qëndroi në Francë ku punoi si gazetar.

Në atdheun e vet u kthye në 1929 dhe u bë redaktor i dy gazetave të partisë së tij, Bashkimit Popullor Agrar Bullgar.

Pas grushtit tjetër të shtetit të 19 majit 1934, Petkov bashkëpunoi me partitë demokratike të vendit, duke

përfshirë edhe Partinë e Punës, e cila qe organizata ligjore e Partisë Komuniste Bullgare të ndaluar.

Ai u zgjodh në Asamblenë e 24-të Kombëtare (1938–1939). Për shkak të veprimtarisë antifashiste zgjedhja e tij si deputet u konsiderua e pavlefshme dhe në dhjetor 1938 u internua në Ivajlovgrad.

Pasi në 1941 Gjergj Dimitrovi emigroi, Nikolla Petkov mori drejtimin e Bashkimit Popullor Agrar dhe si dënim prej qeverisë u dërgua në kampin Gonda Voda.

Ai ndërkohë kreu bisedime me partitë e tjera demokratike për krijimin e Frontit të Atdheut dhe përfaqësoi formacionin e tij politik në këshillin kombëtar të këtij fronti.

Në vitin 1943 Petkov u internua në Svishtov. U kthye në Sofje në verën e vitit 1944 dhe nga 9 shtatori i këtij viti deri më 26 gusht 1945 qe ministër pa portofol në qeverinë e parë të Frontit të Atdheut.

Nga janari 1945 u bë lider i opozitës së bashkuar antikomuniste.

Duke filluar nga 26 nëntori 1946 ishte deputet në Asamblenë e 6-të të Madhe Kombëtare.

Lufta e tij për të ruajtur demokracinë parlamentare u pa nga komunistët në pushtet si një formë e veprimtarisë kundër-revolucionare. Imuniteti parlamentar iu hoq më 5 qershor 1947 dhe u arrestua në vetë ndërtesën e Kuvendit.

Kolegët që u përpoqën të pengonin arrestimin, u rrahën.

Pas një gjyqi spektakël, në të cilin mbrojtjes iu mohuan të drejtat për përfaqësim ligjor ose për të paraqitur prova, ai u shpall fajtor për spiunazh dhe u dënua me vdekje më 16 gusht të atij viti.

Megjithëse protestoi për pafajësinë e tij gjatë gjyqit të organizuar në grup me katër “bashkëkomplotistët” të tjerë,

dhe pavarësisht protestave të vendeve perëndimore, përfshi edhe denoncimin e këtij krimi prej Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Nikolla Petkov u ekzekutua më 23 shtator 1947.

Trupi i tij u hodh në një varr anonim, pa asnjë shenjë.

Pas kësaj për ta manipuluar ngjarjen policia sekrete bullgare organizoi që një rrëfim i rremë për gjoja rolin e tij si agjent i perëndimit euroamerikan të shtypej publikisht, por u falsifikua aq qartë sa që kjo manovër u bë shumë shpejt një siklet për vetë qeverinë komuniste filsovjete.

Kështu hoqën dorë.

Nikolla Petkov u rehabilitua vetëm në 15 janar 1990.

### **Telegramin i datës 24 shtator 1947, ora 7 pasdite**

Çështjen e frymës antiamerikane në gjyqin e Tiranës ambasadori Alberto Tarkiani ia përmend sërish ministrit të vet në Romë Karlo Sforca.

Kjo ndodh në telegramin e tij të datës 24 shtator 1947, ora 7 pasdite.

Këtë temë Tarkiani, siç raporton, e kishte trajtuar në një bisedë të gjatë me Ndhimës Sekretarin Amerikan të Shtetit Norman Armour.

Ky i pati deklaruar se sovjetikët po përpiqeshin për njohjen e Shqipërisë në Organizatën e Kombeve të Bashkuara me qëllim që të shtonin numrin e vendeve me vota përkrahëse për ta.

SHBA nuk mund ta lejonin këtë dhe se në përgjithësi për çështjen e Shqipërisë dhe të Bullgarisë “absolutisht nuk synojnë të dorëzohen”.

## **Kapiteni i Parë dhe Kapiteni i Dytë**

Në 27 shtator 1947 në sallën e kinemasë “17 Nëntori” Këshilli i Gjykatës së Lartë Ushtarake, i përbërë nga major Niko Çeta – kryetar, kapiteni I Nexhat Hyseni dhe kapiteni II Mustafa Iljazi, shpallën vendimin e dënimit të grupit të deputetëve të Legjislacionit të Parë të zgjedhur në vitin 1945.

Kjo burgosje dhe më pas vrasje e shumicës së tyre ndodhi kur Kuvendi Popullor duhej të ratifikonte Konventën Jugosllave, por sidomos cilin drejtim do të merrte politika e jashtme e shtetit shqiptar.

Pati zgjedhur lindjen staliniste, kampin socialist me në krye Bashkimin Sovjetik.

## **Shoqëritë ekonomike të përbashkëta shqiptare dhe jugosllave**

Traktati i parë i bashkëpunimit ekonomik të Shqipërisë së pas luftës u bë me Jugosllavinë dhe u nënshkrua në Beograd më 20 shkurt 1945.

Ai u firmos nga Myslim Peza, dr. Omer Nishani, Medar Shtylla dhe Bedri Spahiu. Nga ana jugosllave u nënshkrua prej Gorif Dhuadhak dhe Nikolla Petroviç.

Përmbante suplimimin e kufijve doganorë: shkëmbimi i mallrave midis dy vendeve të bëhej i gjallëruar dhe pa pengesa.

Më 1 korrik 1946 u lidh akordi mbi bashkëpunimin ekonomik, ku u vendosën parimet e përgjithshme.

Në artikullin e parë të bashkëpunimit përcaktoheshin format e organizimit të shoqërive shqiptare dhe jugosllave. Këto do të ishin: Shoqëria për Ndërtimin dhe Shfrytëzimin e Rrugëve të Hekurta, Shoqëria për Nxjerrjen dhe Fabrikimin e Naftës, Shoqëria për Kërkim-Shfrytëzim dhe për Përpunimin e Minierave, Shoqëria për Elektrifikim, Shoqëria për Lundrim Detar, Shoqëria Tregtare Import-Eksport, Banka Shqiptaro-Jugosllave...

Qeveria e Beogradit merrte përsipër ta ndihmonte industrinë dhe bujqësinë e Shqipërisë duke i dërguar specialistë të saj ose duke shkolluar në vendin e vet shqiptarë.

## **Për nxjerrjen dhe fabrikimin e naftës**

Ngritja e Shoqërisë për Nxjerrjen dhe Fabrikimin e Naftës u firmos në Beograd në 28 nëntor 1946.

Për palën shqiptare nënshkroi Nako Spiro dhe për atë jugosllave Nikolla Petroviç.

Qëllimi i saj ishte të bënte kërkime në tokën e Republikës Popullore të Shqipërisë për gjetjen e fushave vajgurore, shtresave minierare dhe fushave gazore, gjithashtu të shfrytëzonte edhe ato që ishin.

Kapitali i shoqërisë përbëhej prej 4 milionë frangash shqiptare dhe brenda 6 muajve secila palë do të derdhte 50 për qind të kësaj shume.

Njëkohësisht qeveria shqiptare i vinte në dispozicion të gjitha tokat e nevojshme, të cilat i njiheshin si investime suplementare.

Gjithashtu në dispozicion të kësaj shoqërie prej shtetit shqiptar viheshin edhe fushat e Kuçovës, të Patosit dhe serat e Selenicës.

Si shpërblim për kërkimin Republika Popullore e Shqipërisë do të merrte 50 për qind neto nga nxjerrja e naftës dhe 15 për qind nga ajo e serës.

Ndërkaq nëpërmjet një protokolli të veçantë qeveria e Republikës Federative të Jugosllavisë angazhohej që brenda dy vjetëve të ndërtonte një central hidraulik, i cili do të kishte kapacitet të përmbushte nevojat e nxjerrjes dhe të rafinerimit të naftës në Kuçovë.



Shpenzimet do t'i njiheshin Jugosllavisë si investime suplementare.

Po ashtu me anën e një protokollit tjetër, të nënshkruar po në këtë datë, qeveria e R.F.P.J. merrte përsipër që brenda 5 vjetëve të ngrinte një rafineri për naftën e Kuçovës dhe të Patosit.

Me anën e Shoqërisë për Nxjerrjen dhe Fabrikimin e Naftës premtohet se do të shfrytëzoheshin më shumë gazrat e nëntokës shqiptare.

## **“Republika e Shtatë” niste nga përvetësimi jugosllav i naftës**

Në 22 gusht 2017 Profesor Fatmir Shehu i dha një intervistë ekskluzive gazetës “Dita”.

Ai ka qenë punonjës shkencor, studiues dhe projektues në fushën e shpimeve të thella dhe shumë të thella.

Vazhdon të jetë konsulent i rëndësishëm në këtë sektor.

Fatmir Shehu ka qenë po ashtu ish-anëtar i Komisarariatit të Posaçëm të Industrisë së Naftës, Drejtor i Përgjithshëm i Industrisë së Naftës në Ministrinë e Industri-Minierave, Zv/ministër që mbulonte industrinë e naftës në Ministrinë e Energjetikës dhe Drejtori i parë i Institutit Teknologjik të Naftës dhe Gazit.

Sipas tij:

“Periudha 1944-1947 ishte periudha më e vështirë për industrinë e naftës shqiptare.

Me vendim të posaçëm të qeverisë dhe personalisht të Enver Hoxhës u dërgua në Kuçovë, në vjeshtën e vitit 1944 Komisari i Jashtëzakonshëm Koço Theodhosi dhe në maj të vitit 1946, ngrihet drejtorja e Kantierit në Kuçovë me detyrë dhe objektiva konkrete si: të riparohej naftësjellësi Kuçovë-Vlorë, të ndërtoheshin dy distileri për të furnizuar vendin me karburante, të ndërtohej centrali elektrik dhe bazat mekanike etj.

Krahas punimeve që bëheshin për të vënë në punë kantierin e Kuçovës u punua edhe për vënien në punë të kantierit të Patosit”.

Pyetjes së gazetës “Dita” “Në atë kohë u dënuan me vdekje disa specialistë të naftës si sabotatorë ndërkohë që kthetrat jugosllave u futën si asnjëherë në ekonominë tonë.

Pse ndodhi kështu?”

Shehu iu përgjigj:

“Puna që bënë specialistët italianë, dhe drejtuesit e tyre sidomos ish-drejtori Andrea Taraskoni si dhe specialistë të tjerë si Stanislav Zuberi, Riza Alizoti etj., u konsiderua armiqsore nga rregjimi komunist duke i larguar italianët nga kantieret e naftës si dhe duke dënuar me vdekje ata me kryesorët...

Këto dënime sigurisht ishin shumë të padrejta dhe shumë dëmprurëse edhe për ecurinë e industrisë së naftës, por mendoj se një gjë e tillë shpjegohet me faktin se në atë kohë komunistët kishin një urrejtje patologjike për të huajt sidomos për gjermanët dhe italianët si dhe siç e quanin ata, “klasën e përmbysur të bejlerëve dhe agallarëve”.

Jugosllavia me të cilën gjatë kësaj kohe kishim miqësi të ngushtë, me qëllimet e saj të mbrapshta që ta bënte Shqipërinë Republikë të shtatë, thurte plane se si të gllabëronte ekonominë shqiptare, sidomos industrinë e naftës.

Sipas marrëveshjes midis të dy vendeve më 24 shkurt 1947 u formua shoqëria Shqiptaro-Jugosllave e Naftës me qendër në Tiranë.

Kjo shoqëri kishte në vartësi vendburimin e naftës në Kuçovë dhe Patos, atë të bitumit në Selenicë të Vlorës, si dhe gjithë zonat perspektive për kërkim dhe zbulim nafte, gazi dhe bitumi.

Jugosllavët, me qëllim që ta merrnin naftën brut e ta çonin në rafinerinë e tyre në Rjeka, bënë që dy distileritë e ngritura në Kuçovë të punonin me 30% të kapacitetit,

ndaluan shpimet në zonat e reja, morën motorat e sondave shqiptare edhe i çuan në Jugosllavi me pretekst për “remont” dhe nuk i sollën më.

Jugosllavët që nuk kishin investuar as një qindarkë në industrinë e naftës të Shqipërisë, deshnin të hiqeshin si pronarë të saj deri sa në fillim të vitit 1948 Zëvendësministri i Minerave Jugosllave Ing. Dullar, kërkoi vartësinë e kantierëve shqiptare të naftës direkt nga ndërmarrja qendrore e Naftës në Jugosllavi...”

## **Në hetuesi Mihallaq Zixhishti i pati djegur dhe sytë me cigare**

Në kujtimet e tij Agim Musta ka vendosur edhe dëshminë e Foto Balës, profesor i filozofisë dhe i letërsisë në gjimnazin e Gjirokastrës, shok i ngushtë i Enver Hoxhës, me të cilin kishte kryer studimet universitare në Montpellier të Francës.

Më 1945 i patën pushkatuar të atin dhe një vit më pas e arrestuan edhe atë me akuzën se kishte krijuar grupin e Neoballistëve dhe se qe agjent anglo-amerikan-francez.

Në vitin 1947, në Gjyqin e Deputetëve u dënua me burgim të përjetshëm.

Sipas dëshmisë së Foto Balës, i cili për disa ditë pati qëndruar në të njëjtën qeli me Enver Sazanin, ky i kishte pohuar se hetuesi Mihallaq Zixhishti i pati djegur dhe sytë me cigare, gjersa i kishte marrë pohimin se ishte agjent anglo-amerikan-francez.

“Doktor Sazani më tregonte gjatë ditëve të fundit të jetës së tij, ka thënë Bala, se hiena Mihallaq i kishte pasë thënë se këto pohime i donin shokët jugosllavë për të demaskuar imperializmin...”

Enver Sazani qe diplomuar për mjekësi në Francë, në qytetet Montpellier dhe Lion.

Ai ishte anëtar i Degës së Çlirimit Nacional të shqiptarëve të Francës, gjatë luftës edhe partizan i çetës në Krujë-Ishëm dhe i çetës së Pezës. Pas çlirimit të vendit u emërua drejtor i Spitalit Ushtarak të Tiranës

Po ashtu u zgjodh deputet në vitin 1945.

U pushkatua me Grupin e Deputetëve.

Gruaja e tij franceze, bashkë me të shoqen e Irfan Majunit, deputet i Dibrës, edhe ai i pushkatuar me këtë grup opozitar, e gjetën vendin e vrasjes.

Ato gërmuan derisa ndeshën në rrobat e tyre, pastaj futën letrat me dy emrat në një shishe, duke e vendosur atë nën dhe, pranë kufomave.

Për t'i gjetur eshtrat e tyre një ditë lirie dhe varrosur bashkëshortët normalisht.

Mbas 6 muajve të pushkatimit, gruaja e Enver Sazanit dhe vajza e tij u kthyen në Francë.

Kur në 1991 Ramiz Alia ishte për udhëtim drejt një mbledhjeje të OKB-së në Nju Jork dhe qendroi për disa çaste tranziti në Paris, francezja i kërkoi të drejtën e marrjes së trupit.

Mori një përgjigje të përgjithshme.

Sepse ai varr i madh, për arsye “rregullimi të mjedisit”, qe zhdukur nga punimet e një buldozeri.

## **Jugosllavët shkelin kufirin italian**

Në 4 tetor 1947, ora 22.00, Ministria e Punëve të Jashtme e Italisë e njoftonte ambasadën e saj në Beograd se sipas një raporti të Komandës së Përgjithshme të Karabinierisë, prej jugosllavëve kishte pasur disa shkelje të kufirit verilindor, kryesisht në datat 22, 25 dhe 30 shtator.

Grupe ushtarake të Beogradit patën depërtuar deri në 200 metra në brendësi të territorit italian, madje në zona të banuara.

Këto shkelje, sipas telegramit të MPJI, përbënin mosrespektim edhe të një marrëveshjeje dypalëshe moscenimi kufijsh bërë në datën 22 shtator.

## **Imagjioni, shokë**

Në një fjalim në Gjirokastrë, në 5 tetor të vitit 1947, Enver Hoxha tha se “Shqipëria e vogël është shumë me fat që ka në kufijtë e saj një shtet të madh dhe demokratik si Jugosllavia, një shok të sinqertë dhe të dashur të popullit tonë.

Imagjioni, shokë, si do të ishte fati i popullit tonë të vogël pa Jugosllavinë miqësore dhe demokratike.

Populli i vogël shqiptar nuk do të kishte lirinë, që tani e kanë, por do të gjendej në ditë të errëta dhe në një fat të zi. Kjo është mënyrë në të cilën ne e gjykojmë miqësinë, vëllazërinë dhe aleancën që na lidh me Jugosllavinë e Titos”.



## **6 tetor 1947, Enver Hoxha flet para popullit në Përmet**

“...Misionet anglo-amerikane, që kishin ardhur në Shqipëri gjoja për të njohur qeverinë, grumbulluan gjithë tradhëtarët, reaksionin, mbeturinat e “Ballit” e të “Legalitetit”, për t'i hedhur në luftë kundër popullit shqiptar.

Ata u përpoqën të organizonin sabotazhe, të bënin atentate, të rrëzonin pushtetin tonë popullor me forcë dhe gjithë shpresat e tyre vareshin në një zbarkim të anglo-amerikanëve...”

### **Dhe në Berat**

“...Pushteti popullor i kapi këta njerëz nga zverku, i çoi në gjyq dhe u dha dënim të pamëshirshëm...

Për ata që janë për kauzën e tij të shenjtë, t'i verë në krye të punës, kurse për ata që punojnë kundër tij, të mos ketë asnjë mëshirë.

Të jeni të sigurtë se në këtë mënyrë pushteti do të jetë më i fortë dhe Shqipëria do të lulëzojë më shpejt...”

## **7 tetor, Enver Hoxha mban një fjalim përpara punëtorëve të Kuçovës**

Ndërsa fjalën e mbajtur në Berat gazeta “Bashkimi” e 8 tetorit, e mërkurë, e nxjerr në pah shkurt, nuk vepron aspak kështu me atë që Enver Hoxha shqiptoi në Kuçovë.

Ky është kryeartikulli i faqes së parë dhe i të gjithë atij numri 865, viti i katërt i botimit.

Shoqëruar një fotoje të madhe ku Hoxha është i veshur ushtarakisht, fjalët e titullit thonë: “Punëtorët e Kuçovës presin Komandantin Gjen. Kol. ENVER HOXHËN”.

Ndër ato që ai tha, ishin edhe fragmentet e mëposhtme:

“...nga imperialistët anglo-amerikanë. Ata përpiqen që popullin dhe vendin tonë ta kthejnë në kohën e vjetër, ata kërkojnë të rimëkëmbin përsëri mbeturinat e reaksionit fashist dhe këto t'i organizojnë dhe t'i hedhin në luftë kundër pushtetit popullor.

Njëkohësisht, me manovrimet që bëjnë këtu brenda me agjentët e tyre, ata zhvillojnë një fushatë shpifjesh kundër vendit tonë.

Ata na akuzojnë për gjëra të paqena. Na akuzojnë se populli ynë, liridashës e demokratik, kërcënon paqen.

...po përpiqen me njëmijë mënyra për të dëmtuar punën, për të dëmtuar djersën tonë.

Këtë ju e keni parë vetë këtu në Kuçovën tuaj, që e keni ngritur me thonj e me dhëmbë duke ndenjur pa gjumë. Këta agjentë të imperializmit anglo-amerikan janë munduar të bëjnë sabotazhe.

Këta kanë qenë djem bejlerësh e agallarësh që e kanë pasur në gjak shtypjen e punëtorëve. Ata nuk mund ta duronin këtë situatë që është krijuar në vendin tonë në sajë të revolucionit tonë popullor.

Këta agjentë, duke mos pasur mbështetje në masat e popullit, u lidhën me të huajt, me ata që kishin shkaktuar fatkeqësi për shekuj me radhë në vendin tonë dhe u përpoqën me mish e me shpirt që të na goditin më mirë. Por morën dënimin e merituar.

...Klasa punëtore duhet të jetë në ballë të çdo përpjekjeje të popullit shqiptar, se ajo është klasa me e ndërgjegjshme, ajo është klasa udhëheqëse, prandaj ju, punëtorët e Kuçovës, duhet të përfitoni nga teknika, ta përvetësoni teknikën që të mos mbetet më në duart e atyre që na sabotojnë, që lidhen me armiqtë dhe kërkojnë ta djegin dhe ta hedhin në erë Kuçovën.

...

Rroftë mbrojtësi i paqes, i lirisë, i demokracisë, Bashkimi Sovjetik!

Rroftë miku më i shtrenjtë dhe më i dashur i popullit tonë, Stalini i madh!”

Në këtë edicion të 8 tetorit 1947, “Bashkimi” publikon dukshëm edhe artikujt “Vyshinski analizon akuzat amerikane kundra Shqipërisë, Jugosllavisë dhe Bullgarisë si edhe interpretimet e këtyre akuzave në amendamentet britanike dhe franceze” si edhe “Në Komitetin e U.N.O-s për çështjet juridike përfaqësonjësi i Jugosllavisë Sava Kosanoviç flet mi problemin e dorëzimit të kriminelëve të luftës”.

**Sërish 7 tetor 1947, fjalë e mbajtur në një miting në Lushnje**

Sipas një përmbledhje lajmi të botuar në “Bashkimi”, “shoku Enver foli për përpjekjet e misioneve anglo-amerikane në Shqipëri si gjatë luftës, ashtu dhe pas çlirimit për t'i rrëmbyer popullit shqiptar frytet e gjakut dhe të sakrificave të tij.

Pastaj shoku Enver theksoi miqësinë e madhe dhe vëllazërore që kemi me Bashkimin e madh Sovjetik dhe Jugosllavinë Federative”.

## **Sovjetikët dhe jugosllavët ofendojnë qëllimshëm Presidentin amerikan**

Në 7 tetor 1947 ambasadori italian në Beograd e njoftonte kreun e ministrisë së vet se “u trondita kur lexova në gazetën “Borba” të mëngjesit të sotëm një artikull të mbushur me gjuhë fyese dhe një seri sulmesh ndaj personit të Presidentit të Shteteve të Bashkuara.

Unë besoj se ky tekst është ribotim i artikullit të çuditshëm, i cili së fundi u publikua në “Liternaturnaja Gazeta” të Moskës dhe ju e dini se kur u botua për herë të parë ai artikull ambasadori amerikan në Moskë i kërkoi me një letër personale Z. Molotov refuzimin e asaj që shkruhej. Në dritën e famës së këtij artikulli si rezultat i protestës së ambasadorit amerikan në Moskë, ripublikimin e tij në “Borba”, organin zyrtar të Partisë Komuniste Jugosllave e quaj si një ofendim të qëllimshëm ndaj Presidentit dhe popullit amerikan të Shteteve të Bashkuara.

Duke pasur parasysh pozicionin e veçantë të gazetës “Borba” në shtypin jugosllav, nuk mund të besoj se qeveria jugosllave mund të qëndrojë indiferente ndaj një artikulli të rëndësishëm në marrëdhëniet ndërkombëtare që shfaqet në këtë gazetë”.

## **Ambasadori italian në Paris, Pietro Kuaroni**

(Pietro Quaroni), në 7 tetor 1947 i dërgoi një raport shefit të tij në Romë, ministrit të Jashtëm Karlo Sforca.

Idetë që ai mëshonte qenë këto:

“Të gjitha këto sulme i shohim në shtypin sovjetik kundër shkrimtarëve, intelektualëve, shkencëtarëve apo çfarëdo tjetër...

A do të kemi sërish prova të ngjashme me '37-ën?

Nuk e di, por ato nënkuptojnë qartë se gjithçka nuk është mirë në Rusi: jo se kjo mund të ketë ndikimin më të vogël .....mbi stabilitetin e regjimit rus në kohë paqeje, por ato janë simptoma të një situatë në të cilën marrja e iniciativës në një luftë nuk është pa rrezik.

Dhe përsëri, ekonomisë ruse i duhen edhe disa vite të tjera për t'u rikuperuar nga goditjet shumë të rënda që pësoi gjatë luftës.

Ndërkaq bashkimi i ekonomive të zonave fshatare me ekonominë ruse sapo ka filluar.

As që po flas për gjendjen e transportit përtej perdes së hekurt dhe ne të gjithë e dimë rëndësinë e transportit për një luftë.

Mund të ngrihen ende shumë argumente.

Unë i përmbledh mendimet e mia në këtë formë: për shumë vite ende Rusia nuk është në gjendje të përballojë një të tillë luftë me Amerikën dhe Stalini e di këtë.

...Rusia nuk ekspozohet më në vetën e parë.

Dhe kjo maturi në agresion vazhdon.

...Unë guxoj të parashtroj edhe një tjetër: për kushtet e tyre rusët duhet të evakujnë Bullgarinë. Ata mund ta bëjnë këtë tani sepse situata e brendshme është në duart e sigurta të Dimitrovit.

Por për politikën e huaj, sidomos për politikën greke, prania e trupave ruse mund të jetë jo vetëm një parim i bashkëpërgjegjesisë së drejtpërdrejtë, por nesër mund ta përfshijë edhe Rusinë në një konflikt.

Kam frikë se Greqia mund të shkaktojë rrëmuja të mëdha.

Por nëse përkeqësohet, vendet e përfshira janë dy shtete sovrane, Bullgaria dhe Shqipëria.

Nëse u ndodh diçka, Rusia do të klithë si një shqiponjë, do t'i ndihmojë me të gjitha mjetet që ka në dispozicion, por nuk do të hyjë e para në luftë...

Prandaj, përfundimi në të cilin arrij është se nëse do të ndodhte Lufta e Tretë Botërore, me iniciativën e Ruisë ajo nuk do të shpërthejë.

Të paktën deri në Rusi ajo nuk do të ndihet.

Rusia është pamjaftueshëm e përgatitur nga pikëpamja e prodhimit. Për të arritur këtë asaj i duhen jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet...

Po ashtu do të ndodhë mosluftë prej sovjetikëve për sa kohë që Stalini është gjallë.

Sepse nëse është e vërtetë se vdekja e Stalinit mund të çojë ndaj betejave të brendshme dhe rrjedhimisht dobësimin të Ruisë, mundet gjithashtu që situata të sjellë në pushtet grupe më pak të matura se ai.

Nëse kjo pranohet, atëherë mund të jemi të sigurt pse një demokraci e madhe si ajo amerikane nuk mund të bëjë një luftë agresioni.

I lejoj vetes të kem disa dyshime.

Cila është politika amerikane?



Është shumë në modë sot të thuash që politika amerikane në lidhje me Rusinë është përmbledhur në artikullin e njohur të Kennan (George Frost Kennan, diplomat dhe historian-shënimi ynë).

E njoh mirë autorin dhe mund të them se ideja e tij ka qenë gjithmonë ajo që ta përmbajë Rusinë në të gjitha frontet për të mos i lejuar asaj as hapin më të vogël përpara.

Nëse kjo do të ishte vërtet politika amerikane, mund të jetë pikëpamje e sigurt pse Rusia do ta lejojë veten të frenohet; do të bërtasë, por në të vërtetë do të mbetet në pozicionin e vet.

Por a është politika e Kennanit me të vërtetë politika amerikane?

Ose më mirë a ka vërtet një politikë amerikane?

Se ka amerikanë që janë në favor të një lufte parandaluese kundër BRSS, këtë shpresoj të mos na e mohojë askush.  
....”

**8 tetor, Enver Hoxha thotë para popullit të Elbasanit**

“Këta armiq të gjitha shpresat i kanë te anglezët e amerikanët dhe nuk janë veçse spiunë e agjentë të këtyre të fundit, që kanë shitur atdheun, nderin dhe popullin. Të tillë ishin ata që u gjykuan në Tiranë dhe u dënuan pa mëshirë nga gjyqi i popullit. Këta njerëz do të vazhdojnë përsëri të përpiqen për të na dëmtuar”.

## **Përndjekja nga titizmi i politikanit Dragoljub Jovanović**

Në 8 tetor, ende të pashtypur me makinë daktilografike, por hartuar vetëm me shkrim dore, ambasadori italian në Uashington, Alberto Tarkiani, i dërgoi Ministrit të tij të Jashtëm një raport të bisedimeve që sapo pati kryer në Departamentin e Shtetit.

Sipas tij, shkëmbimi i mendimeve ishte zhvilluar “Duke vënë në dukje përpjekjet e Departamentit në emër të Petkovit, liderit të opozitës bullgare, i cili u dënua kohët e fundit për akuza të ngjashme dhe u ekzekutua nga qeveria bullgare.

Si edhe për inkurajimin që patën veprimet e Departamentit në emër të kësaj ngjarjeje për t’u dhënë mbështetje elementëve antikomunistë në Bullgari dhe në vendet fqinje. Gjithashtu Alberto Tarkianit iu mpreh shpresa se Departamenti mund të ndërmernte ndonjë veprim, i cili, duke pranuar se ndoshta nuk do të kishte asnjë efekt të dobishëm në rezultatin e gjyqit të (Dragoljub) Jovanoviçit, megjithatë do të jepte mbështetje morale ndaj elementëve antitito në Jugosllavi.

Gjatë takimeve ambasadorit italian në SHBA iu deklarua se Departamenti nuk ishte i pavëmendshëm ndaj veprimeve dhe guximit të Dr. Jovanoviçit për të shprehur publikisht kundërshtimin e tij ndaj disa ligjeve të fundit të regjimit të Titos

Në bisedime u tha se Jovanoviç, i cili ishte profesor në Universitetin e Beogradit dhe kishte ndjekës të

konsiderueshëm në mesin e popullatës fshatare serbe, kishte qenë gjithmonë i njohur për pikëpamjet e tij të theksuara majtiste.

Pak para luftës ai pati detyruar një ndarje në Partinë Agrare Serbe dhe formoi një parti të re të atyre që favorizonin bashkëpunimin me komunistët.

Ai u zgjodh deputet i shtetit serb dhe i parlamenteve federale dhe ishte nënkryetar i Presidiumit Kombëtar.

Veprimet e tij gjatë vitit 1946, megjithatë, duke treguar humbjen e besimit të komunistët, duke kritikuar në Parlament rishpërndarjen e tokës bujqësore në Serbi, ligjin e nacionalizimit, planin pesëvjeçar dhe buxhetin me shumat e tij të jashtëzakonshme të akorduara për shpenzime ushtarake, çoi në arrestimin e tij majin e kaluar.

(Arrestimi i Jovanoviçit iu raportua nga ambasada e vet në Beograd Departamentit Amerikan të Shtetit menjëherë, që në 26 maj, ende me shkrim dore-shënimi ynë).

Atje u saktësua që jo më shumë se një muaj më parë nga arrestimi, Jovanoviç, kur ishte në një vizitë në një fshat në Serbinë veriore, qe rrahur rëndë nga një bandë e ashpër si ndëshkim për kundërshtimin e tij ndaj regjimit.

I lindur në Beograd Dr. Dragoljub Jovanoviç kishte marrë doktoraturën për drejtësi në Paris.

Ai u dënua disa herë në Mbretërinë e Jugosllavisë për veprimtarinë e tij politike dhe për këtë arsye u përjashtua edhe nga Fakulteti Juridik i Beogradit. Jovanoviç ishte një nga themeluesit e Grupit për Veprim Social dhe Kulturor.

Ai qe po ashtu edhe anëtar i Bashkimit të Fermerëve, nga i cili u largua në vitin 1940 dhe formoi Partinë Popullore Fshatare.

Në vitet 1946–1947 ishte gjithashtu anëtar i Presidiumit të Kuvendit Popullor të Republikës Popullore Federative të Jugosllavisë.

Jovanoviç qe një nga intelektualët e parë në Jugosllavinë e kohës së tij, i cili që në fillim pa rrezik të madh nga fashizmi dhe nazizmi. Si kundërshtar i rreptë i këtyre ideologjive, ai vazhdimisht në veprimet dhe fjalimet e tij paralajmëronte për këtë kanosje.

Ai inicoi krijimin e Frontit Popullor Jugosllav për Luftën kundër Fashizmit. Fronti Popullor u krijua në vitin 1936 në shtëpinë e tij në Beograd.

Për shkak të kundërshtimit ndaj diktaturës së mbretit Aleksandër dhe situatës së atëhershme politike e shoqërore në Jugosllavi, ai humbi punën në Universitet dhe u arrestua, më 6 janar.

U gjykua e më pas qëndroi në burg deri më 4 maj 1934.

Pastaj u internua për një vit në Tutin dhe Sjenica.

Me ftesë të kryeministrit të Republikës së Spanjës, Hugo Negrin, më 1 shkurt 1938 u nis në këtë vend për të mbështetur luftën e forcave internacionaliste kundër pushtimit fashist. Ai foli në Cortes (Kuvend) ku niveli i tij i lartë shkaktoi entuziazëm të madh.

Jovanoviç u zgjodh vazhdimisht deputet në Kuvendin Popullor të Mbretërisë së Jugosllavisë.

U arrestua si deputet më 1 tetor 1938, me shumë gjasa për të mos marrë pjesë në zgjedhjet e dhjetorit të po atij viti.

Në prill të 1939-tës u dënua me një vit e dy muaj burgim të rreptë dhe 1200 dinarë gjobë, të cilat iu falën në një amnisti.

Gjatë Luftës së Prillit (1941), Dragoljub Jovanović u regjistrua si vullnetar në ushtri, por nuk mori asnjë detyrë ushtarake. Pas pushtimit gjerman të vendit, ai refuzoi të nënshkruajë Apelin e intelektualëve të Nediçit drejtuar popullit serb dhe vendosi të bashkëpunojë me lëvizjen partizane, duke ftuar anëtarët e Partisë së tij Fshatare Popullore për t'iu bashkuar Lëvizjes Popullore Çlirimtare.

Me ftesë të Aleksandër Rankoviçit dhe Milentije Popoviçit, pas çlirimit të vendit, ai bashkëpunoi për një kohë me komunistët.

Por qysh në fillim të vitit 1946 ra në konflikt me komunistët për shkak të kritikave të hapura ndaj diktaturës së tyre dhe evokimit të demokracisë parlamentare me një sistem shumëpartiak.

Gjatë veprimtarisë së tij politike dhe parlamentare afatshkurtër në RFPJ, nga fillimi i vitit 1945 deri në mesin e vitit 1947, ai veproi në Kuvend si një opozitë e ashpër ndaj qeverisë titiste.

Për shkak të kësaj ra nën goditjen e regjimit.

Partia e tij u shpërbë nga UDBA dhe ai vetë u përjashtua nga fakulteti më 31 korrik 1946.

Imuniteti i deputetit iu hoq dhe u arrestua më 13 maj 1947.

Në 8 tetor 1947 u dënua me nëntë vjet burg për “tradhti të lartë”.

Ai e duroi burgimin pa asnjë ditë falje.

U rehabilitua pas vdekjes, në vitin 2010, me vendim gjykate. U provua se procedura e gjykimit që ekskluzivisht rezultoi i përndjekjes politike.

## 9 tetor 1947

Nga fjala e Enver Hoxhës e mbajtur në përrurimin e kanalit vaditës “Naum Panxhi”:

“Elementët tradhëtarë, agjentët e spiunët e imperializmit dhe sabotatorët e çdo kategorie, janë përpjekur e përpiqen t'i grabitin popullit tonë fitoret që ai arriti në Luftën Nacional-Çlirimtare.

Forcat e reaksionit ndërkombëtar, me në krye ato angleze e amerikane, duke përdorur si vegël edhe monarko-fashistët grekë, janë përpjekur dhe përpiqen t'i nxjerrin pengesa popullit tonë, duke bërë një seri provokacionesh e akuzash të pavend kundër Republikës sonë.

Në rrugën që ka hyrë populli ynë ka gjetur ndihmën vëllazërore të Bashkimit Sovjetik dhe të Jugosllavisë.

Bashkimi Sovjetik, që është sot mbrojtës i paqes dhe i lirisë së popujve, e ka përkrahur dhe e ka ndihmuar vendin tonë. Ne i jemi mirënjohës Bashkimit Sovjetik dhe Stalinit të madh për ndihmën e madhe dhe të gjithanshme që i jep vendit tonë të vogël, i cili ka vendosur të shkojë përpara në rrugën e demokracisë e të përparimit përkrah të gjitha forcave demokratike”.

Nga përmbledhja e fjalës së E.H. përpara popullit të Pogradecit:

“Katër fabrika të mëdha, që do të na vijnë për së shpejti, na i jep Bashkimi Sovjetik, 200 traktorë do të na japë...

Çfarë bënin anglo-amerikanët në Shqipëri?

Në kohën e luftës ata kishin dërguar këtu misionet e tyre gjoja për të ndihmuar partizanët, por ata jo vetëm armë s'na jepnin, por dhe ato që na jepnin, ishin shumë të pakta.

Ata kishin ardhur te ne për tjetër punë, për të organizuar reaksionin e brendshëm që ta përdornin, kur të thyhej Gjermania dhe ta binin në fuqi për të shtypur popullin, sikundër po ngjet në Greqi.

Misionet anglo-amerikane, që kishin ardhur në vendin tonë pas çlirimit, u përpoqën të grumbullonin e të organizonin elementin kundërshtar të pushtetit si bejlerët, agallarët e tregëtarët e mëdhenj, të sabotonin, të bënin atentate dhe me anën e këtyre, të rrëzonin pushtetin me forcë.

Këta njerëz s'kishin dhe as që mund të kishin mbështetje në popull.

Ata shpresonin në një zbarkim të anglo-amerikanëve.

Anglo-amerikanët nuk mundën të bënin as gjënë më të vogël këtu, në vendin tonë, sepse populli i ruante e i vëzhgonte.

Prandaj, në punën e tij ndërtimtare, për të mbrojtur pushtetin e vet, populli shqiptar duhet t'i ketë sytë hapët.

Mos të kujtojmë se armiqtë janë zhdukur.

Ekzistojnë akoma mbeturina, që na kritikojnë, na shajnë, por ne i dimë dhe do t'i ndjekim këmba-këmbës, do t'i ndjekim, pse ne nuk luftuam e nuk e derdhëm gjakun që të lëmë përsëri hajdutët të vijnë në fuqi, të na vrasin e të na rjepin.

Kjo nuk do të ngjajë kurrë dhe gjithë planet e tyre do të dështojnë”.



## **Përsëri 9 tetor 1947**

Në qelitë e burgut të sigurisë së lartë Nr. 313 në Tiranë deputetët dhe të tjerët e dënuar me vdekje për një muaj rresht qëndruan të lidhur në një mënyrë që nuk mund të lëviznin fare.

Që të gjithë bënë letra për t’iu falur jeta.

Një shkresë e firmosur në 9 tetor nga sekretari i Presidiumit të Kuvendit Popullor, Sami Baholli, u bëri të ditur refuzimin e lutjeve të tyre për të jetuar qoftë edhe si të dënuar me burgim të përjetshëm.

## Më 10 tetor

Sot më datën 10.X.1947, ora 5 paradite, unë Josif Pashko, i ngarkuar me cilësi Prokurori, i shoqëruar nga ndihmësi Harito Nashi dhe dr. Major Ibrahim Dervishi, shkuam në burg dhe morëm në dorëzim të pandehurit, të dënuar me vdekje: Shefqet Beja, Riza Alizoti, Sulo Klosi, Selaudin Toto, Agathokli Xhitoni, Abdul Kokoshi, Selim Kokalari, Beqir Çela, Mehmet Prishtina, Paolo Saggioti, Tefik Deliallisi dhe Pertef Karagjozi, mbasi u siguruam për identitetin e tyre, të shoqëruar nga rojet, shkuam në vendin e caktuar për ekzekutimin e të pandehurve.

Mbasi u kënduam vendimin e Gjykatës naltë, nr. 187, datë 27.IX.1947 që dënon gjithë të pandehurit e naltpërmendur me vdekje, që refuzonte lutjet e tyre për falje dhe mbasi u pyetën dhe thanë fjalën e fundit, në bazë të vendimit të naltpërmerdur që ka marrë formë të prerë, ora 2.30, urdhërova ekzekutimin e tyre me vdekje në litar Shefqet Beja, Riza Alizoti e Sulo Klosi.

Me vdekje: Selaudin Toto, Irfan Majuni, Enver Sazani, Sheh Ibrahim Karbunara, Hysen Shehu, Agathokli Xhitoni, Abdyl Kokoshi, Salim Kokalari, Beqir Çela, Mehmet Prishtina, Paolo Saggioti, Tefik Deliallisi e Pertef Karagjozi.

Si u krye ekzekutimi, mjeku konstatoi vdekjen e të gjithë të pandehurve”.

## **Italiani Paolo Saxhoti do të akuzonte edhe të tjerët, por megjithatë do të pushkatohej**

Sipas “Memorie.al” dhe dokumenteve që ajo ka nxjerrë nga Arkivi i Ministrisë së Punëve të Brendëshme, ndër deponimet e italianit Paolo Saxhoti (Paolo Saggioti) janë:

“Neve kemi organizuar personelin italian në mënyrë që të ishin gati, gjithashtu kemi formuar dhe grupe nga personeli nëpunës dhe teknik.

Komiteti përbëhej nga Tarascon, Kati, unë dhe Don Pietro dhe gjithsecili nga kryetarët e grupeve kryesore ishte ngarkuar të drejtonte grupin përkatës në punët e sabotimit.

Neve do të propagandonim në personel për ngadalësimin dhe sabotimin e punimeve dhe të propagandonim kundër Qeverisë.

Unë kisha sektorin e prodhimit.

Arshiva sekrete më duket se ka kaluar në duart e Dom Pjetrit. Kjo arshivë kishte korrespondencën që mbante vetë inxhinier Taraskoni, dhe që ishin çështje me rëndësi që nuk kishin të bënin me korrespondencën ordinere.

Se çfarë përmbante nuk e di.

Inxhinier Taraskoni ka ardhur në Tiranë në muajin nëntor 1944 për t’u takuar me Misionin anglez dhe të merrej vesh me kryetarin e axiendave italiane në mënyrë që të kordinoheshin punët dhe të përpiqeshin të shpëtonin axiendat e tyre.

Kurse u kthye nga Tirana Taraskoni më tha se kishte lajmëruar anglezët mbi gjitha çka ngjiste në Kuçovë dhe se kishte biseduar me të gjitha drejtorët e axiendave në Shqipëri në mënyrë që të kordinonin punët.

Ai është takuar dhe kishte biseduar me Simonçinin e të tjerë, dhe qëllimi i tyre ishte që të bashkëpunonin të gjithë axiendat dhe në mbrojtjen e anglo-amerikanëve të mundoheshin të shpëtonin pasuritë italiane në Shqipëri.

Tarasconi nga Tirana pruri 150 napolona ar, të cilat u shpërndanë ndërmjet personelit dhe një pjesë e mbajti Taraskoni për nevojat eventuale.

Unë mora 25 napolona flori.

Më 24 Dhjetor neve kemi marrë vendim që në distilerinë nr.2 të bëhej një sabotim sipas sugjerimeve të anglezëve. Sabotimi do të bëhej në mënyrë që me një anë të vihej zjarri me një anë tjetër të derdhej benzinë kështu që zjarri do të zbriste deri në distilieri.

Për djegjen neve njoftuam anglezët, të cilët na lajmëruan që të pritnin derisa ata të na njoftonin ditën, të cilën e caktuan nga mesi i janarit dhe na njoftuan me anën e Simonçinit. Në fillim menduam të djegim mbeturinat e karburantit që kishin dalë përjashta dhe kështu zjarri do të arrinte deri në distilieri ku do të hapeshin tubat e gazit dhe zjarri do të përhapej.

Ky zjarr u vu porse u shua me ndihmën e punëtorëve; të ushtarëve dhe të komisarit, i cili shkoi në vend më të shpejtë.

Veprimet në përgjithësi kryesisht sipas udhëzimeve të anglezëve porse ky ishte një rast që u paraqit në çast dhe neve vepruam. Në këtë kohë në Kuçovë u arrestua Tarasconi dhe Kati dhe me rastin e arrestimit të tyre neve patëm një trembje të madhe.

Më vonë u arrestuan dhe disa të tjerë porse neve e vazhduam aktivitetin tonë.

Në kryesi kishim dhe inxhinier Riza Alizotin i cili ka ardhur në Kuçovë në muajin nëntor dhe mori pjesë në grup mbas mbërritjes atje. Në grupin tonë bënë pjesë dhe profesori Zuber, Doktor Dakua e Inxhinier Sulo Klosi.

...

Inxhinier Riza Alizotin e futëm në kryesi mbasi ishte rekomanduar nga misioni anglez. Mbas Taraskonit gjithë punën në dorë e mori ai.

Inxhinier Alizoti që kryetar i përgjithshëm në drejtimin e punimeve. Kurse Taraskoni erdhi në Tiranë në muajin nëntor pruri një radio transmetuese, të cilën e kishte marrë nga misioni anglez; me anën e së cilës u vumë në kontakt me Barin.

Këtë në fillim e përdorte vetë Taraskoni dhe mandej unë. Radion e kishim vendosur në podrumin e shtëpisë dhe kjo kaloi në dy tre duar si në spital e gjetkë. Me anën e kësaj lidheshim me Barin.

Lidhjet me Tiranën i mbante Taraskoni dhe Alizoti.

Informatat që neve jepnim me anën e Radios që në mbi punimet që bëheshin në Kuçovë dhe mbi gjendjen tonë. Ata na lajmëronin se situata në Shqipëri do të ndryshojë në bazë të ndihmave të anglo-amerikanëve dhe që neve të vazhdonim të mbanim lidhje me misionet në Tiranë. Inxhinier Tarasconi si mori radion nga misioni anglez, bëri një letër dhe e dërgoi, ajo radio ishte e vogël porse punën na e mbaronte.

Para se të më binte mua në dorë radioja, Radio-Bari njoftonte orët kur neve do të transmetonim. Radion neve e mbajtëm deri në muajin shtator dhe mandej e shkatërruam

mbasi nga Bari na lajmëruan që situata po sqarohet me qënë se është duke u bërë traktati i paqes.

Inxhinier Klosi ka ardhur në Kuçovë në muajin Fruer 1945 dhe qysh atëhere ka vazhduar të vijë shpesh herë. Ky ka marrë pjesë në një mbledhje që është bërë në muajin Mars. Puset e ujit ishin caktuar të bëheshin nëpër zona ku nuk kishte fare ujë ose ku kishte pak, me qënë se ky lloj punimi, që përpos të tjerëve kishte dhe qëllim propagandistik, të mos realizohej.

Mbas Taraskonit dhe Katit u arrestua kujdestari i shtëpisë dhe një tjetër.

Me arrestimin e Taraskonit kanë ardhur në Tiranë dy veta të ngarkuar nga Komiteti që të lajmëronin Simonçinin dhe Gjeneral Piçinin që ndodhej këtu.

Me këtë rast anglezët na kanë njoftuar që puna e sabotimeve duhej të vazhdonte si më parë. Lidhjet me misionin anglez i kemi mbajtur deri në muajin shtator të vitit 1945 dhe mandej u lidhëm me misionin amerikan.

Tentativat e para me amerikanët i kemi bërë me ndërmjetësinë e Inxhinier Riza Alizotit në muajin korrik dhe Gusht të vitit 1945.

Ne lidheshim me Fultzin, me të cilin kishim kontakte verbale inxhinier Alizoti dhe profesor Zuber. Në gusht të vitit 1945 kemi sabotuar në puset e ujit, në distileritë, në rindërtim dhe në sektorët e tjerë...”

## Rikujtesë

E kujtojmë lexuesin se pikërisht në vitin 1945, ku përflitet për veprimtari intensive sabotuese në pusët e Kuçovës, në fund të tij, në 22 dhjetor, edhe pse që i biri i kundërshtarit dhe i të pushkatuarit politik Fejzi Alizoti, Rizai u dekorua me “Urdhrin e Punës”.

Pothuaj një vit më pas, në 7 tetor 1946, e rikujtojmë sërish lexuesin se në Mbledhjen e Dytë të Këshillit të Përgjithshëm të Frontit Demokratik Enver Hoxha pati deklaruar: “Në minierat tona të serës, të bakrit si dhe në pusët e vajgurit po punohet me energjinë më të madhe; punëtoria në këto miniera dhe sidomos në pusët e Kuçovës po organizohet dhe po bëhet e ndërgjegjshme për detyrat e mëdha që i ka besuar populli.

Lavdërime të veçanta meritojnë punëtorët e kantierëve të Kuçovës, të cilët po bëhen shembull për gjithë punëtorët e Shqipërisë, për ndjenjën e lartë të organizimit, për ndërgjegjen në punë, për disiplinën e çelniktë...”

## **Me varje dhe me vdekje**

Nuk konsideroheshin njëlloj.

Dënimi me varje ishte një vdekje që shkaktohej nga një mbytje me litar të vendosur një lartësi më të madhe sa gjatësia e një trupi njerëzor.

Kjo lartësi herë ndërtohej vetë prej ndëshkuesve dhe herë për të kryer varjen përdorej ndonjë degë e fortë peme.

Dënimi me vdekje kryhej nëpërmjet vrasjes me pushkatim.

Varja ishte dënimi më maksimal, pastaj vinte pushkatimi.

Në gjyqin e Grupit të deputetëve nga 16 që u dënuan me marrjen e jetës, 7 u varën dhe 9 u pushkatuan.

Pjesa më e madhe e të dënuarve u varën apo pushkatuan në një territor pranë Malit me Gropa, në Tiranë.



## **Varje edhe në Rubik, tre ditë mbajtur në litar**

Riza Alizoti u dërgua për t’u varur në qendër të Kuçovës.

Në vendimin gjyqësor thuhet se ai qe “i biri i Fejziut dhe i Ismihanit, vjeç 37, lindur në Stamboll të Turqisë dhe banues në Kuçovë, me profesion inxhinier, i martuar me fëmijë, me arsim të lartë, i padënuar”.

Por edhe Sulo Klosi u vendos të varej në mes të Rubikut, ku kishte punuar si kryeinxhinier.

Sipas të bijës së tij, Edit Klosi, në një intervistë të saj të 3 shkurtit 2020, ajo pohon se “Gjatë periudhës së studimeve në Francë, midis shumë shqiptarëve që ndiqnin studimet atje, babai pati njohje edhe me Enver Hoxhën, gjatë kohës që ai ishte në Montpelje.

Në Francë, babai nuk u mor me asnjë aktivitet apo veprimtari politike, por iu kushtua vetëm studimeve, pasi e kishte me shumë pasion degën që kishte zgjedhur.

Gjatë periudhës së Luftës, xhaxhai ynë, Qemali, u angazhua tërësisht me Lëvizjen, duke arritur dhe disa funksione të larta, deri në komisar batalioni me gradën e majorit, ndërsa babai ynë, Sulua, nuk u përzie fare me punët e luftës, por vazhdoi të punonte me italianët.

Vetëm nga fundi i vitit 1944, babai u angazhua me një grup intelektualësh shkodranë të diplomuar në Perëndim, të cilët aspironin për demokraci, për një sistem me prirje socialdemokrate.

Ndërsa pas mbarimit të luftës, xhaxhai ynë, Qemali, kreu funksionet e komandantit të Qarkut të Vlorës, kryetarit të

Gjykatës për Krimet e Luftës dhe drejtorit të Transportit në Ministrinë e Komunikacioneve, babai ynë filloi punë në Drejtorinë e Gjeologjisë, pranë Ministrisë së Industri-Minierave në Tiranë.

Në atë punë im atë shërbeu deri në fillimin e vitit 1946, kur e emëruan si kryeinxhinier të Uzinës së Bakrit në Rubik.

Por, ndërsa ai bashkë me specialistët italianë i ishte përveshur punës për të rivënë në punë atë uzinë, në marsin e vitit 1947 u arrestua së bashku me një grup të madh intelektualësh, që u quajt “Grupi i Deputetëve”.

Gjatë periudhës disamujore që im atë u mbajt në hetuesi, atë e torturuan në mënyrë çnjerëzore, aq sa kur doli në gjyq në fillim të shtatorit 1947, nuk njihej fare.

Gjatë seancave të gjyqit...ai u akuzua se kishte pasur lidhje me profesorin polak Zuber (që kishte vdekur në qelitë e Hetuesisë së Tiranës), me të cilin e kishte lidhur një nga profesorët e tij në Universitetin e Strasbourgut.

Po kështu, ai akuzohej se që në vitin 1941 kishte pasur lidhje me eksponentë të Ballit Kombëtar, si Mit’hat Frashëri, Hasan Dosti, Abaz Ermenji, Nuredin bej Vlora etj., me të cilët e pati lidhur shoku i tij i ngushtë, inxhinier Andrea Xega, si dhe pas mbarimit të Luftës, kishte bashkëpunuar me misionet anglo-amerikane për rrëzimin e qeverisë së Enver Hoxhës.

Vendimi gjykatës u zbatua menjëherë dhe tim atë e lanë të varur për tre ditë në mes të qytezës së Rubikut, duke terrorizuar gjithë banorët e asaj zone.

Lidhur me dënimin, ne mësuam se Enver Hoxha ishte shprehur se nuk kishte gisht në atë punë, po ku ta dish se si qëndron e vërteta.

Pas vdekjes së tim eti, edhe xhaxhanë, Qemalin, e shkarkuan nga të gjitha funksionet, por pas dënimit të

Koçi Xoxes, atë e rehabilituan përsëri, duke e caktuar në funksione të larta shtetërore, si: zv/ministër të Komunikacioneve e drejtor të Flotës Detare dhe të Portit në Durrës.

Gjatë atyre viteve që ishte në ato detyra, xhaxhai u kujdes për mua dhe vëllanë tim, Ismailin, duke na nxjerrë të drejtën e studimeve për shkollat e larta dhe duke u interesuar të punësoheshim sipas degëve përkatëse ku ishim diplomuar”.

## **Lyerja me sapun e lakut të litarit, si asnjë mundësi për të shpëtuar**

Njëri prej banorëve të vjetër të Kuçovës një dyzinë vitesh më parë do të rrëfente në televizionin Klan, në emisionin “Histori me zhurmues”, se natën e varjes së Riza Alizotit, duke qenë fëmijë, u ndodh në afërsi të vidhit.

Sipas tij, nga njerëz të ngarkuar për ekzekutimin, po bëhej gati litari dhe rregullohej laku i tij.

Një çast ata e thirrën djalin e vogël dhe i thanë nëse mund të shkonte në shtëpinë e vet dhe të merrte një gjysmë kallëpi sapun.

Ai pranoi dhe shumë shpejt ua solli çfarë kërkuan.

Sigurisht mbeti i pagojë si me sapun ekzekutuesit po lyenin litarin në pjesën e rrumbullakët të lakut.

Njeriu që tregoi këtë histori, atëherë nuk nguli këmbë se kishte qenë i pranishëm më vonë, kur u bë varja.

Ndërkohë ka shumë banorë të Kuçovës që nuk e konfirmojnë si të vërtetë këtë episod.

Madje e kundërshtojnë.

Arsyetimi i mosbesimit është fare i thjeshtë.

Duket e pabesueshme që shteti bolshevik i 10 tetorit 1947 nuk kishte pak sapun për të kryer atë gjest teknik mjaft drithërues që e bënte litarin të rrëshqiste lehtësisht rreth qafës së viktimës dhe ai të mos kishte asnjë shpresë se do të shpëtonte nga vdekja.

Ky veprim është kryer patjetër edhe sepse shteti që vetëshpallej si liridashës dhe me drejtësi sociale, me

vetëmburrje si komunist, nuk mund të lejonte përsëritjen e asaj që i ndodhi të atit të Rizait, Fejziut, kur breshëri të tëra pushkësh nuk e vranë dot dhe rivrasjen me “colpo di grazia” ia bëri prokurori i gjyqit.

Për t'i dhënë një mesazh se familja e Alizotëve, sipas dogmës zyrtare këta “armiq të klasës”, duhej të zhdukeshin e të mos ringjallehin më, Rizai u vra ditën e lindjes.

10 tetori 1947 qe 37 vjetori i tij.

Kishte lindur në 10 tetor 1910.

## **11 tetor 1947, pema e vidhit përballë “Birra Korça”**

Sipas Servet Agajt

“Në datën 10 tetor duke u gdhirë 11, isha në punë turni i tretë në Rafinerinë numër 1 që ndodhet te Laboratori Shkencor, ku është edhe sot e kësaj dite.

Në mëngjes vumë re nga rruga që shikonim se si banorët jo si zakonisht po lëviznin nxitimthi në drejtimin e kundërt, poshtë.

Më në fund i mbanin këmbët te vidhi i madh dhe qëndronin përballë "Birra Korça".

Bashkë me dy kolegët e mi mbërritëm atje.

Ç'të shihje!

S'u besonim syve.

Njeriu më i mirë që kisha parë e njohur në jetën time, simboli i diturisë dhe i pamjes perfekte, qëndronte i varur. Neve, disa djemve të rinj, na kishte hyrë në zemër sa më s'bëhesh ing. Riza Alizoti.

Për ne qe idhull.

Një vit më parë ishte dekoruar nga qeveria e vendit me motivin si inxhinier që rivuri në efikasitet zonën e vajgurit.

E kishim dëgjuar se e kishin arrestuar për punë sabotuese në naftë!!!

Po besonim se ishte gabim dhe do të lirohej patjetër.

Por e kishin varur.

Kishte të veshur një pardesy si me ngjyrë qumështi.

Në këmbë mbante një palë çizme.

Ishin të punës.

Rizain e lanë të varur tri ditë.

Ditën e tretë dy çizmet ja kishin hequr.

U përhapën fjalë se ato ia kish marrë një rom. I përmendnin edhe emrin.

Unë në shenjë proteste si edhe shumë kolegë të mi punëtorë të naftës nuk kaluam më nga ajo rrugë.

Jo vetëm kur ishte trupi i tij atje, por edhe më pas.

11 tetori ishte dita e fundit kur do ta shihja inxhinierin, njeriun e mirë që do të na mungonte përjetësisht”.

## **Diku te një përrua**

Sipas Shkëlqim Agos, autoritetet e kohës urdhëruan karrocjerin e vetëm që kishte qyteti, Thimi Kurrizo, ta largonte trupin e pajetë të ing. Alizotit pas tri ditë qëndrimi te vidhi dhe ta hidhte gjëkund.

Kështu bëri edhe xha Thimi.

Ishte 13 tetor 1947.

Në zbatim të urdhrit që i dhanë dhe doemos që ishte i padiskutueshëm, “ai e hodhi trupin e Riza Alizotit diku te një përrua afër Oksigjenit, siç i thuhet edhe sot pavarësisht se kjo mini fabrikë nuk punon”.



## 14 tetor 1947

Lajm i gazetës “Bashkimi”.

Sipas tij, në fjalimin e mbajtur para popullit të Vithkuqit “Shoku Enver, pasi foli mbi përpjekjet e reaksionit anglo-amerikan për rimëkëmbjen e fashizmit, vazhdoi: “Ne kemi miq të fortë Bashkimit Sovjetik dhe Jugosllavinë e re”.

Duke përfunduar shoku Enver tha: “Përpjekjet e armiqve të jashtëm dhe të brendshëm kanë dështuar dhe do të dështojnë”.

**16 tetor 1947, “Komandanti udhëheqës e organizator i luftës dhe i të gjitha fitoreve të popullit t’onë”**

Në 16 tetor të një viti më parë, 1946, “Bashkimi” pati heshtur rreth ditës së lindjes së Enver Hoxhës.

Deri ato çaste qe botuar libri “Enver Hoxha, biografi e shkurtuar”.

Publikimi ishte kryer në pranverë 1946 dhe me përkujdesjen e KQ të Partisë.

Libri qe shtypur në stabilimentin “Rinia”.

Ishte me kapakë të trashë të kuq dhe përmbante 58 faqe.

Në të përshkruheshin në mënyrë kronologjike jeta e Enver Hoxhës nga lindja deri ditën e zgjedhjeve të 2 dhjetorit 1945.

Pas tre-katër muajsh nga çasti i botimit ky libër u hoq nga qarkullimi.

Ishte mjaft banalisht i hartuar dhe kulti i Hoxhës kapërcente çfarëdo limiti. U tërhoq që manipulimi i të dhënave të bëhej më i sofistikuar.

Në atë biografi 58 faqëshe nuk flitet për ndonjë ditëlindje të tij në 16 tetor.

Për herë të parë për këtë datë pohohet në gazetën “Bashkimi” të motit 1947.

E tërë faqja e parë e kësaj të përditshmeje të së enjtes, 16 tetor, kishte dukshëm dy artikuj dhe një portret të madh të Enver Hoxhës me uniformë ushtarake.

Kjo foto zinte një të tretën e faqes.

Kryeartikulli me titullin germëmadh thoshte: “Komandanti udhëheqës e organizator i luftës dhe i të gjitha fitoreve të popullit t’onë”.

Artikulli tjetër i faqes së parë titullohej “Komandanti, Gjen. Kol. Enver Hoxha u kthye në Tiranë”.

Në brendësi përveç gjysmës së një faqeje si vijim i kryeartikullit, një faqe e tërë ka lëndën e titulluar “Nga biografia e Komandantit”.

Por edhe kjo është aq e shumtë sa vijon në një faqe tjetër.

Të nesërmen, e premtë, “Bashkimi” kryeartikullin e ka me titullin “Planet Anglo-Amerikane për akuzimin dhe diskretizimin e Shqipërisë, Jugosllavisë dhe Bullgarisë dështuan në mënyrë të pamohuarshme”.

Gjysmën tjetër të faqes së parë e zotëron artikulli “Delegacionet Frontit të qytetit Tiranës, ushtrisë, rinisë, gruas dhe ekipet që bënë udhëtimin “në rrugën e Komandantit” e urojnë Komandantin me rastin e përvjetorit të 39-të dit-lindjes së tij”.

Jehona për ditëlindjen e Enver Hoxhës zë vendet më të dukshme të edicionit të së shtunës të gazetës “Bashkimi”, po ashtu edhe të dielën, në 19 tetor 1947.

Në brinjë të kryeartikulli sa një e treta e faqes së parë, të titulluar “Një provë tjetër armiqësore e qeverisë britanike”, artikujt e tjerë i kushtohen 39 vjetorit të Hoxhës.

### **Shifra 39**

Përsëritet vazhdimisht, gazetë pas gazete, artikull pas artikulli, pa u druajtur se nuk përbënte jubile dhe vetëm për këtë arsye të thjeshtë nuk meritonte festime kaq të mëdha.

Të gjitha vizitat që nëpër qytete kreu në gjysmën e parë të atij tetori Enver Hoxha i kishte tërheqje vëmendjeje mbi vetveten.

Duket qartë që ai është i gjithëfuqishëm.

Asnjë tjetër, përfshi edhe Koçi Xoxen, nuk ia sfidon apo ngushton pushtetin.

Për rrjedhojë, siç edhe vetë e pohon në fjalimet që mbajti, posaçërisht edhe në atë në Kuçovë, varjet në litar dhe pushkatimet e 10 tetorit qenë kryer me vetëdijen dhe urdhrin e tij.

Në ditën kur Riza Alizoti, dy vite më i ri se ai, mbushte 37 vjeç.

**“Dje, më 20 nëntor 1947 reth orës 19.45 Ministri i Industrisë dhe Kryetari i Komisionit të Planit Nako Spiru aksidentalisht vrau veten”**

Të shtunën, në 22 nëntor 1947, “Bashkimi” në faqen e parë shkruante, duke zënë të gjithë kreun e saj:

“Vdiq Nako Spiru

Ministër i Industrisë dhe kryetar i Komisionit të Planit Antar i Komitetit Central të Partisë Komuniste

Flamuri Kombëtar në gjysmë shtizë”.

Shkrimi më pas thoshte:

Komunikatë e Qeverisë e Republikës Popul’ore të Shqipërisë

Dje, më 20 nëntor 1947 reth orës 19.45 Ministri i Industrisë dhe Kryetari i Komisionit të Planit Nako Spiru aksidentalisht vrau vehten.

Fatkeqësia ndodhi në këto rrethana: ndërsa bisedonte me disa shokë, funksionarë të Komisionit të Planit, ay lonte me revolverin e tij, i cili pa pritmas i plasi në duar dyke e goditur në trup.

Plumbi e qëlloi nënë sisën e mëngjer.

Me urgjencën më të madhe ay u transportua nga shokët me të cilët ishte dyke biseduar, në Spitalin Ushtarak, ku mjekët për një herë muarrën masat e nevojshme.

Atij iu bë për shumë herë resht transfuzioni i gjakut, por pa asnjë rezultat.

Ay vdiq në orën 22.5’ të datës 20 nëntor 1947...”

Në faqen e parë të “Bashkimit” të 21 nëntorit me germa të mëdha qe botuar edhe urdhri i Kryeministrit, pra i Enver Hoxhës, për ngritjen e flamurit në gjysmë shtize “në të gjitha zyrat qeveritare në qendër dhe në qarqe”.

## **Mareshalli Tito**

Në 27 nëntor “Bashkimi” si kryeartikull të faqes së parë titullon “Delegacioni qeveritar jugosllav i kryesuar nga Mareshalli Tito, pritet me antusiashtë nga më se 300.000 vetë në Sofje”.

Në brendësi të saj kjo e përditshme botonte edhe shkrimin “Nga rezultatet e vitit të parë të planit pesë-vjeçar në Jugosllavi”.

“Bashkimi” i 3 dhjetorit bën shumë të dukshëm si kryeartikull “Populli shqiptar përshëndet me gjithë zemër Traktatin e miqësisë, të bashkëpunimit dhe të ndihmës reciproke midis R.F.P. të Jugosllavisë dhe R.P. të Bullgarisë”.

Gjithashtu botohen edhe lajmet: “Me rastin e festës kombëtare të 29 Nëntorit” Gjen. Kol. Enver Hoxhën e përshëndet Mareshalli Tito” dhe, vendosur më poshtë, shënohet se këtë gjest e kanë bërë po ashtu Gjergj Dimitrovi, Klement Gotvaldi, Vladimir Bakariçi...

Në 7 dhjetor në faqen e parë të “Bashkimit” publikohet me germa të mëdha fjalët “Mareshalli Tito, në krye të një delegacioni qeveritar niset për në Hungari”.

## **“Dje arriti në Beograd Gjen. Kol. Enver Hoxha”**

Ditën e shtunë, më 13 dhjetor 1947, “Bashkimi” ka si kryeartikull të të gjithë edicionit shkrimin “Gjeneral Kolonel Enver Hoxha pritet në Beograd nga autoritete të larta jugosllave”.

Teksti i tij me dukshmëri të theksuar është ky:

“Korespondenti i Agjensisë Telegrafike Shqiptare në Beograd, njofton:

Dje arriti në Beograd, në kalim për në Sofje, Gjen. Kol. Enver Hoxha Kryeministër dhe Ministër i P. të Jashtme të Republikës Popullore të Shqipërisë, i shoqëruar nga Gjen, Leitnant Koçi Xoxe Nënkyeministër dhe Ministër i P. të Brendshme,

Gjen. Major Kristo Themelko, Shef i Drejtorisë Politike të Ministrisë Mbrojtjes Kombëtare,

Ndihmës-Ministri i P. të Jashtme Hysni Kapo,

Kolonel Beqir Balluku, dhe Drejtori i Informatave Misto Treska.

Në stacion të hekurudhës kishin dalë për të pritur Gjen. Kol. Enver Hoxhën nën-Kryetari i Qeverisë R.F.P. të Jugosllavisë Edvard Kardelj,

Ministri i Punëve të Brëndshme Aleksandër Rankoviç, Ministri i P. të Jashtme Stanoje Simiç,

Kryetari i Komisionit të Planit të R.F.P. të Jugosllavisë Andreja Hebrang,

Kryetari i Qeverisë së R.P. të Serbisë Blagoje Neshkoviç, Gjen. Major Svetozar Vukmanoviç Tempo,



Shef i Shtat Madhorisë Gjen. Leitnant Koça Popoviç,  
Ndihmës Ministri i P. të Jashtme Vladimir Velebit,  
Sekretari i Përgjithshëm i Qeverisë së R.F.P. të Jugosllavisë  
Ljubodrag Djuriç,  
Ministri Fuqplotë i R.F.P. në Tiranë Josif Djerdja,  
funksjonarë të legatës të R.P. të Shqipërisë në Beograd si  
edhe autoritete të tjera civile dhe ushtarake”.

## **“Rezultate të shkëlqyera të popujve të Jugosllavisë”**

Tek libri i tij “Titistët” Enver Hoxha do të shkruante se “Periudha nga fillimi i nëntorit 1947 e gjer në mars-prill të vitit 1948 do të mbetet në histori si një ndër periudhat më të rënda e më të rrezikshme që kanë kaluar ndonjëherë Partia dhe populli ynë.

Këta ishin muajt kur ne u ndodhëm ballë për ballë sulmit final të titistëve për eliminimin e PKSH dhe për gllabërimin e Shqipërisë.

Por në të njëjtën kohë kjo s'ishte vetëm për titistët betejë e një rëndësie të posaçme.

Kjo ishte edhe për ne një ndër betejat më të ashpra e më të lavdishme kundër revizionizmit modern”.

Kështu shkroi Enver Hoxha dhe në këtë linjë u sendërtua e gjithë historia zyrtare, ajo që mësohej në shkolla apo në universitete, në librat e përkthyer nga shteti e të shpërndarë nga po ai, nëpërmjet ambasadave shqiptare jashtë vendit.

Mirëpo realiteti që ndryshe dhe këtë e dekonspiron pa dashje vetë gazeta kryesore e shtetit njëpartiak.

Derisa sa u mbyll viti 1947 “Bashkimi” do të botonte, si edhe më parë, me ritëm po të njëjlojtë dhe me përparësi, edhe shkrime e lajme të tjera nga Jugosllavia si “Në Beograd u hap solemnisht Kongresi i Dytë i Frontit Popullor të Jugosllavisë, Mareshalli Tito flet në Kongres, “Fronti ynë Popullor është një demokraci e tipit të ri, është demokraci e vërtetë popullore”.

Ose: “Në Jugosllavinë e Re papunësia është çdukur për gjithmonë”.

Apo: “Gjashtëvjetori i Ushtrisë Jugosllave”.

Kryeartikulli i 3 janarit 1948 i gazetës “Bashkimi” është: “Mareshalli Tito flet mbi rezultatet e shkëlqyera të popujve të Jugosllavisë gjatë vitit të parë të planit pesë vjeçar”.

Në 5 janar, e shtunë, kryeartikulli ka fjalët: “Mareshalli Tito falënderon Gjeneral Kolonel Enver Hoxhën për urimet e bëra me rastin e përvjetorit të parë të nënshkrimit të Konventës Ekonomike dhe të Ditës së Ushtrisë Jugosllave”.

## **Falen 465 të burgosur armiq të popullit**

Të premtën, në 9 janar “Bashkimi” publikon artikullin me titull:

“Presidiumi i Kuvendit Popullor dekreton faljen e 465 të burgosurve armiq të popullit, 438 të burgosurve ordinerë dhe 190 të burgosurve në burgje të ndryshëm”.

## **Ditë e mërkurë, 30 qershor 1948**

Shkrimi “Komunikatë mbi mbledhjen e Byrosë Informative të Partive Komuniste dhe Punëtore”, i cili do të nxiste në Tiranë shkëputjen nga Jugosllavia dhe prishjen e planit të saj për ta shndërruar Shqipërinë në një Republikë të Shtatë, u botua ditën e mërkurë 30 qershor 1948.

Deri atë çast gazeta i pasqyronte marrëdhëniet me Beogradin dhe Titon si edhe në fillim të vitit.

“Bashkimi” i 2 majit shumë dukshëm në faqen e parë vendoste kryeartikullin “Punëtorët e Jugosllavisë e festojnë 1 Majin e këtij viti në një luftë plotë përpjekje edhe plotë suksese për realizimin e socializmit”.

Të martën, në 13 qershor, diçka më tepër se dy javë larg ditëbotimit të komunikatës mbi mbledhjen e Byrosë Informative të Partive Komuniste dhe Punëtore, në faqen e parë spikaste lajmin: “Arriti një brigadë e Rinisë Jugosllave në hekurudhën Durrës-Tiranë”.

## **Në Beograd dhe në Tiranë**

Mendohej se “Plani i vitit 1947 dhe 1948 për nxjerrjen e naftës nga vendburimi i Kuçovës dhe i Patosit, nuk u realizua”.

Po ashtu: “Për të dy vendburimet e mësipërme, deficitin e krijuar gjatë viteve 1947 dhe 1948 është i barabartë me 75089 metra kub naftë ose rreth 20 për qind e realizimit të planit të prodhimit për të dy vitet së bashku”.

Dokumentet jugosllave mes të tjerash vinin në dukje:

“Zejnel Hamiti vete në Kuçovë dhe thotë se të gjitha seksionet do të lidhen me Ministrinë e Industrisë në Tiranë. Po ky njeri ka thënë se s’pranon letra në gjuhën serbe etj.”

Nga shqiptarët deklarohet se “Specialistët jugosllavë thonë se po zvogëlohet vlefata e specialistëve jugosllavë dhe nënçmohen mendimet e propozimet e tyre...”

Inxhinieri i portit të Durrësit u zëvendësua me një italian...

Në Patos u punua me qëllim që të komprometohej inxhinieri jugosllav...

Në industri shumë jugosllavëve u janë vonuar pagesat...

Shokët shqiptarë kanë dashur të zhveshin një shoqe jugosllave për ta kontrolluar.

Njerëzit tanë shikohen shumë keq këtu”.

Nga historiografia shqiptare e periudhës së realkomunizmit:

“Titistët penguan përpunimin e naftës në vend...”

Me urdhër arbitrar të Komisionit të Koordinimit, nga 1 janari deri në qershor 1948 u ndalua puna në Distilerinë

nr. 2 me qëllim që nafta të përpunohej në Jugosllavi dhe pastaj t’i shitej Shqipërisë me çmime të larta, duke zbatuar kështu metoda imperialiste shfrytëzimi dhe grabitjeje”.

## **Një raportim i Tuk Jakovës**

Në arkivin personal të Kreshnik Kuçaj, studiues dhe drejtor i një departamenti të televizionit Scan, të specializuar për historinë dhe zhvillimet e ekonomisë shqiptare, ndodhet edhe një material kyç për të depërtuar në prapaskenën e përpjekjes titiste për të na shndërruar në republikë të shtatë të Federatës Jugosllave.

Kjo lëndë dokumentare, vetëm në shkrim dore, është marrë prej Arkivit të Shtetit, “F. 14/APSTR (Komiteti Qendror i Partisë së Punës së Shqipërisë – Strukturat e Komitetit Qendror), V. 1948, D. 1-202/1”.

Materiali shumëfaqësh ka për autor Tuk Jakovën, në vitet 1946-1947 ambasador i Republikës Popullore të Shqipërisë në Beograd dhe në shkurt të motit 1948 Ministër i Industrisë.

Pikërisht në fillim të vitit 1948 në Beograd është bërë një mbledhje e Komisionit të Koordinimit të shoqërive të përbashkëta mes dy vendeve.

Duke dëgjuar raportin Tuk Jakova ka mbajtur shënimet e tij shumë të kujdesshme dhe raporton për Enver Hoxhën:

“Shoqrija e Vaj-Gurit

Gjendja juridike sipas raportit. Për veç disa vrejtheve procedurale, thuhet se “Ndamja e fitimit neto nuk është preçizue”.

Si ka vajt Shoqrija, si pas raportit:



1) Bashkëpunimi me Min. e Industrisë nuk ka qenë i mirë. Ministrija e jonë nuk ka pranuar këshillat teknike të shoqërisë etj.

2) Orjentimi i Ministrisë i këshilluem nga Xega dhe Zuberi goditet. Ky orientim nuk shkonte nga kualiteti, por nga vija e sasisë për shtrirjen në fusha të reja, për investime të mëdha nga ana e shoqërisë, kështu që eventualisht t'i dorzoheshin ish shoqërisë A.I.P.A. ose pronarve Anglo-Amerikanë fushat e reja të zbulueme.

Kjo asht një objeksion i drejtë dhe duhet të hiqet dorë nga ky orientim i gabuem qi aktualisht asht absurd.

Ndërsa problemi i kualitetit të naftës në pusët dhe zonat ekzistuese Kuçovë-Patos, ku ka rezerva të mjaftueshme për 20-50 vjet, asht shumë preokupant për ne, për sigurimin e konsumit të karburanteve të nevojave tona qi shtohen si dhe nxjerrjen nga toka të sasirave ma të mëdha për eksport. Asht e kotë të shpërndajmë forcat dhe të bajmë investime të pa drejta.

Gjithashtu shoqërisë nuk i janë dhanë dokumentacionet e A.I.P.A. si edhe arshiva gjeologjike.

3) Për sa i përket udhëheqjes së shoqërive në terren kanë shkue dy vija.

Kjo ka shkaktuar edhe një farë ndarjeje në mes të personelit Shqiptar dhe Jugosllav.

Kta kanë ndejë në shum raste ndarë nga njëri tjetri.

Ka pasë raste qi urdhrat teknike të inxhinjerëve jugosllavë nuk zbatoheshin pa marrë edhe pëlqimin e drejtorisë d.m.th. të shqiptarëve jo teknikë.

Përgjegjsa teknikë shqiptarë si në central dhe reparte të tjerë nuk u binden dhe nuk i japin hesapë teknikve të lartë jugosllavë.

Zv.drejtori i shoqërisë së naftës atakohet shumë nga raporti për frymë jo të drejtë bashkëpunimi.

4) Nuk janë dërgue kuadrot e parashikueme por vetëm një përqindje e vogël e tyre.

Ky problem bahet ma i vështirë me rastin e hikjes së teknikve italian. Në këtë drejtim duhet marrë masa.

Kjo shfaqet edhe në raport.

5) Për bitumin kujdesi ka qenë shumë ma i vogël.

6) Në faqet 8-9-10 bëhen vrejte teknike në lidhje me nxjerrjen dhe burimin e naftës, të cilat janë të vlefshme për punën e ardhshme.

7) Për sa i përket fuqisë elektrike ata vinë në konkluzionin se përgjegjsat e centraleve elektrike Kuçovë, Patos e Selenicë nuk janë në gjendje të drejtojnë shërbimin elektrik.

Pjesa tjetër e raportit deri në faqen 22 merret me konstatimin e të metave

...

9) Rojet jo në rregull, rreziku i djegieve kërcënon seriozisht kantjeret.

...

11) komisioni është i mendimit që vëmendja më e madhe t'i kushtohet Patosit.

...

Referuar materialit shumëfaqesh të Komisionit të Koordinimit Tuk Jakova shënon edhe raportime të tjera mbi gjendjen e Bankës Shqiptaro-Jugosllave, po ashtu edhe për temën “çështja e ushtrisë asht një problem më vete”.

Jakova ngul këmbë se udhëheqjet paralele në strukturat e shoqërive, përfshi edhe atë të Vajgurit, “kan shërbyer për ftohjen e marrëdhënieve me jugosllavët”.

## **Arsyet e vërteta**

Të vrasjes së Stanislav Zuberit dhe të Riza Alizotit, të burgosjes së Andrea Xegës, si edhe të tjerëve të dënuar në Gjyqin e Deputetëve, ndodhen në raportin kryesor të Komisionit të Koordinimit, qeverisë ekonomike të ngritur nga Beogradi për të realizuar pushtimin e Shqipërisë.

Duke ua rikujtuar, ja akuzat, sipas raportit:

“Orjentimi i Ministrisë i këshilluem nga Xega dhe Zuberi goditet. Ky orientim nuk shkonte nga kualiteti, por nga vija e sasisë për shtrirjen në fusha të reja, për investime të mëdha nga ana e shoqërisë, kështu që eventualisht t'i dorzoheshin ish shoqërisë A.I.P.A. ose pronarve Anglo-Amerikanë fushat e reja të zbulueme.

...

Gjithashtu shoqërisë nuk i janë dhanë dokumentacionet e A.I.P.A. si edhe arshiva gjeologjike”.

## **Andrea Xega**

Me studime të përfunduara në Francë, kur i kreu ato, në 1932, u emërua drejtor i Drejtorisë së Gjeologjisë në Ministrinë e Ekonomisë, detyrë të cilën e vijoi gjatë pushtimit fashist italian dhe atij nazigjerman, po ashtu edhe me fillimin e pushtetit të ri, atij komunist.

Ai bëri miqësi të ngushtë me Stanisllav Zuberin dhe bashkë, të shoqëruar edhe nga një ekip gjeologësh, realizuan një ekspeditë në Alpet e Veriut.

Sipas dëshmisë së nipit Gjergji Xega, "Krisja e madhe në mes Andreas e pushtetit komunist ndodhi pas dënimit të Sulo Klosit, inxhinierit dhe shokut të ngushtë të tij i cili u arrestua dhe u dënua me varje në minierën e Rubikut ku ai punonte.

Në gjyqin e Sulos, u përmend dhe emri i Andreas i cili kishte dijeni për gjoja sabotimet që ishin bërë në minera...

Aty nga fillimi i vitit 1947 kur Andrea ishte ende në funksionin e Drejtorit të Gjeologjisë, ftoi për darkë në shtëpinë e tij misionarët e UNRRA-s, të cilët ato ditë do të largoheshin nga Shqipëria”.

Pas kësaj e arrestuan.

Hetimi zgjati dy vjet e gjysëm.

Megjithëse nuk pranoi asnjë nga akuza se qe agjent anglo-amerikan, gjyqi e dënoi me vdekje dhe pas dy vjetësh Kuvendi Popullor ia la dënimin me 101 vjet burg.

Sipas Memorie.al, “Më pas dënimi iu ul në 25 vjet dhe atë e dërguan në burgun e Bulqizës ku Drejtori i saj Todo Manço

e trajtonte shumë mirë dhe e caktoi si Drejtues të Degës Teknike.

Aty nga viti 1961 kur Andrea vuante dënimin në burgun e Bulqizës, atje shkoi dy herë për inspektim Kryeministri Mehmet Shehu i cili pasi e falenderoi që e kishte nxjerrë nga mbrapambetja atë minierë, e pyeti se çfarë kërkonte nga ai.

Andrea i tha që ta lironin nga burgu dhe ta linin të punonte në zanatin e tij.

Kryeministri Mehmet Shehu ia plotësoi kërkesën Andreas dhe e liroi nga burgu para kohe, kur ai kishte vuajtur plot 17 vjet burg.

Pasi doli nga burgu...punoi disa kohë si pedagog në Politeknikumin "7 Nëntori" e më pas në Institutin e Projektimit të Minierave ku ai u bë autor i 27 Projekteve të zbatuara në vendin tonë".

## **Në emër të popullit je i arrestuar**

Në librin e saj “Kostaq Stefa, martir i demokracisë”, bashkëshortja e tij e ve Eleni, mes të tjerash shkruan se “sapo kisha rregulluar fëmijët, iu dhashë darkë dhe po bëhesha gati t’i vija në gjumë, kur ra zilja e portës.

Pastaj porta u godit fort si me diçka të rëndë.

Kostaqi, që ishte poshtë duke punuar, në dhomën e pritjes, doli dhe e hapi portën.

Ndërkaq unë dhe prapa meje katër fëmijët, dolëm poshtë.

Aty ishin tre burra të veshur ushtarakë dhe të armatosur.

Dëgjova njërin që tha:

-Ti je Kostaq Stefa?

Kostaqi i tha: -Po, unë jam.

-Në emër të popullit je i arrestuar!-foli përsëri ai burri.

Kostaqi u vesh dhe pasi e prangosën dy prej tyre e vunë në mes dhe qëndruan tek porta, kurse i treti u ngjit lart dhe filloi të kontrollojë një baule, ku nuk kishte veçse lapsa dhe fletore.

Pastaj ai zbriti poshtë dhe u bashkua me Kostaqin dhe ata dy ushtarakët e tjerë dolën në rrugë.

Unë u bëra si e marrë. Hodha krahëve një xhaketë si automat dhe i thashë birit tim Alfredo: “Të keqen mamaja, merru ti me fëmijët, se unë po shkoj të shoh se ku po e çojnë Taçin (Kostaqin).

Dola si e marrë nëpër natë, në errësirë dhe rrugët ishin pothuajse të shkreta.

Nuk dija nga t’ja mbaja dhe mora drejtimin nga burgu. Nxitova hapat dhe dallova nga larg që po ecnin me Kostaqin në mes tyre.

I ndoqa në largësi derisa i pashë që hynë tek Dega e Punëve të Brendshme, ku dihej, se ndodheshin birucat e torturave. Prej asaj nate filloi kalvari i jetës sime dhe i pesë fëmijëve të mi”.

Kostaq Stefa u pushkatua në mëngjesin e 3 marsit 1948.  
Akuza: agjent anglo-amerikan.

## **Diane Jacqueline Belkiz**

Në vitin 1947 ndërsa një ditë pesëmbëdhjetë vjeçarja angleze Diane Jacqueline Belkiz ndodhej në një park, iu afrua një burrë i gjatë me uniformë ushtarake.

Ky mbante në duar një kuti.

Sipas rrëfyeses në shtypin shqiptar të një dekade më parë, Meri Lalaj, ky e thirri vajzën: “Belkiz!”

Ajo e vështroi me mosbesim, por kur ai thirri për së dyti, e ëma e tërhoqi nga dora dhe u larguan.

Xheki filloi të pyesë se ku e dinte ai njeri emrin e saj të regjistruar që në lindje dhe e ëma i tregoi historinë e vërtetë se ajo ishte bija e një shqiptari me emrin Riza Alizoti.

Cili qe personi që e thirri apo gjithçka është një legjendë.

Viti 1947 ishte moti i fatkeqësisë së madhe të Rizait dhe duke mos qenë vetë ato çaste në Angli dhe as ndonjë i dërguar, kushëri, ka qenë patjetër shpirti i tij.

Kishte dalë një çast nga qelia ku torturohej të pranonte se pati dashur të digjte rafinerinë dhe në mos lagje të tëra të Kuçovës.



## **Fati pa fund i dhimbshëm i Verës**

Vera Alizoti, nga prindërit me mbiemrin Ypi, qe mbesë e Xhafer Ypit, ish-kryeministër kolaboracionist i Shqipërisë. Nëna e saj ishte Adileja, motra e dijetarit dhe atdhetarit të shumënjohur Tajar Zavalani.

Vera qe bijë e vetme.

Kur shteti i vrau të shoqin, me këtë shkak i sekuestroi edhe gjithçka kishte familja e nënës Zavalani.

E mbetur e ve dhe me tri fëmijë të vegjël, dy vajza dhe një djalë, për t'i rritur pa vuajtje ushqimi, të tre i morrën motrat e Rizait.

Fitreti që e kishte bashkëshortin turk dhe ishte në një gjendje më të mirë ekonomike, u kujdes më shumë për jetimët.

Vera me njërin vëlla të pamartuar, të cilët disa kohë punuan në Ndërmarrjen Industriale Shtetërore “Tulla” në Tiranë, më pas, në 1952, bashkë me nënën e tyre, Adilenë, i internuan në kampin e Tepelenës.

Më vonë do të dërgoheshin në Xhafzotaj, në Shijak, Sallmone, Katër Rrugët, Pat Milot, në Kryevindh të Kavajës dhe këtu Vera mbeti përgjithnjë.

Adileja kishte një makinë qepëse “Singer”, e cila punonte duke i rrotulluar dorezën me dorë.

Qepte rrobe për të tjerë.

Vera do të vdiste nga kanceri në shkurt të vitit 1971, kurse e ëma tre vjet jetë më pas, në 8 maj 1974.

## Fejziu junior

Në rast se vrasja e deputetëve të opozitës dhe e inxhinierëve apo teknikëve të naftës, mes tyre edhe të Rizait, do të qe vetëm vepër e jugosllavëve të Titos bashkë me njeriun e tyre në Tiranë, Koçi Xoxen, pas vitit 1948 Enver Hoxha do të qe distancuar pak nga pak.

Ai jo vetëm nuk e bëri këtë gjest, por edhe vazhdimisht e mori përsipër.

Ishte vrasësi kryesor apo bashkëvrasës ka fare pak rëndësi. Siç nuk ka dallim të madh mes tij dhe Titos në punën e mbrapsht për ta shndërruar Shqipërinë, secili për pushtetin e vet, në një republikë të shtatë.

Kjo pseudorepublikë dhe vrasjet e 10 tetorit 1947 janë dy enë komunikuese.

Zbrazet njëra që të mbushet tjetra.

Fejziu, i biri i vetëm i Rizait, jetoi e që nga viti 1967 punoi në Manëz, në nëndheun e minierës së saj të qymyrit.

Deri sa në 1980-ën e arrestuan me akuzën “Agjitacion dhe propagandë kundër pushtetit popullor”.

Me këtë rast ndaj tërë familjes Alizoti u provua edhe një herë roli demoniak i Enver Hoxhës.

Ai nuk u mjaftua me vetëm dy breza persekutimi të rëndë, por goditi edhe gjeneratën e tretë.

Po të vijonte regjimi dhe logjika e tij e luftës së klasave, burgu apo pushkatimi do të kapte edhe brezin e katërt Alizoti.

Në gjyqin e Fejziut, me gjysh të pushkatuar në moshë të thellë, të rivrarë sepse nuk vdiq menjëherë dhe me baba të varur, pretenca e prokurorit përbëhej nga fjalët që më mirë se kushdo platformë politike, rrëfenin kursin e pamoderuar apo të parevizionuar të Hoxhës: “I pandehuri Fejzi Alizoti, djali i armikut të Partisë dhe popullit, Riza Alizoti, i dënuar me varje si agjent i anglo-amerikanëve, dhe nipi i Fejzi Alizotit, i dënuar me pushkatim, ish ministër, deputet, dhe prefekt, në qeverinë e satrapit Zog...”.

U dënua me 10 vite burg, të cilin e kreu një pjesë në kampin e Spaçit dhe tjetrën në atë të Qafë Barit.

Doli nga qelitë në 1988, dy vite para kohe.

I pati përfituar me punë.

Gjersa të binte diktatura Fejzi Alizoti (junior) do të punonte në minierën e Manzës.

## **Motrat Nezihe dhe Sevim**

Nuk do të zhgënjehesha nga përshtypja e fillimit, e një dekade më parë, për bijat e edukuara me mirësi të Rizait, për dy motrat e mirësjellshme të Fejziut junior dhe mbesat plot urtësi të Fejziut senior: Nezit dhe Sevimit.

Në mes të shkurtit 2022 i shkrova Nezit një mesazh, nëpërmjet të cilit i kërkoja të më shkruante disa radhë për periudhën e tyre të persekutimit politik.

Në dhjetëra e dhjetëra e dhjetëra shkrime për fatin tronditës të familjes Alizoti, nuk kishte pothuaj asnjë të dhënë për to.

Përgjigja që erdhi ishte kjo, e zhveshur nga çdo retorikë propagandistike dhe vetëdukje:

“Emri im është Nezihe.

Kam lindur në 03.11.1942 në Tiranë.

Kam mbaruar teknikumin e ndërtimit dhe kam punuar vetëm tre vjet teknike dhe pastaj, deri sa dola në pension, në prodhim, gjithnjë në Ndërmarrjen e Ndërtimit “21 Dhjetori”.

Edhe Sevimi ka lindur në Tiranë në 11.8.1944.

Ka mbaruar dhe ajo teknikumin se ne nuk na lejohej gjimnazi, që ne e kishim shumë dëshirë.

Ajo ka punuar punëtore në Uzinën “Partizani”.

## Vite të gjata heshtjeje

Që prej momentit rrëqethës kur pesëmbëdhjetë vjeçarja Diane Jacqueline Belkiz në vitin 1947, ndërsa ndodhej në një park dhe iu afrua një burrë i gjatë me uniformë ushtarake, i cili e thirri me emër, kudo ku më pas ndodhej, në Nju Jork apo Paris, çdo shqiptar që mund të takonte, qoftë edhe fare rastësisht, e pyeste nëse patën dëgjuar për babanë e saj, Riza Alizotin.

Takoi posaçërisht edhe njerëz të Oborrit Mbretëror në emigrim.

Por, siç shkruan Meri Lalaj, kurkund nuk gjeti gjurmë të tij.

Në 1976 Diane Jacqueline Belkiz dërgoi një letër në qeverinë shqiptare dhe i erdhi një përgjigje e formuluar me fjalët sikur i ati pati qenë një kriminel apo terrorist i rrezikshëm i Europës.

Kaluan vite të gjata heshtjeje, nënvizon Meri Lalaj.

Por tashmë kërkimi i rrënjëve të familjes kishte nisur prej palës tjetër, asaj shqiptare.

Në vitin 1986 në muajt mars, prill dhe qershor një nga bijat e Rizait, e sistemuar në Turqi, i dërgoi letra njëra pas tjetrës Kryqit të Kuq Anglez.

Megjithatë përgjigjet qenë të pashpresa: “E pamundur të gjendet personi!”

Nëna e saj Kathleen u nda nga jeta në vitin 1988.

Nuk mundi kurrë ta marrë vesh të vërtetën për burrin e saj të parë, Rizain.

Në 24 janar 1990 në një letër përgjigje për Diane Jacqueline Belkiz nga “Shoqata Shqiptare” pyetej nëse kishte bërë përçapje në shtypin britanik për ta gjetur të atin.

Në javët e mëpasshme Xheki nisi të priste faqet e gazetave britanike ku shkruhej sesi zvarriteshin në Shqipëri të vrrarët në kufi, në përpjekje për të dalë jashtë vendit e gëzuar një jetë më të mirë.

### **Një ditë përroi pati nxjerrë**

Pas vitit 1992, me ndryshimin e sistemit politik në Shqipëri, familjarët kërkuan eshtrat e Riza Alizotit.

Në ndihmë të tyre u rreshtua edhe karrocieri Thimi Kurrizo.

Pas shumë kërkimesh megjithatë nuk u bë e mundur gjetja e eshtrave.

Midis atyre me të cilët biseduan ishte edhe një grua.

Ajo kish dëgjuar nga më të hershmit se një ditë përroi pati nxjerrë një këmbë njeriu.

Pastaj ajo qe zhdukur.

E kishte marrë uji me vete.

Pikërisht në këtë vend të Kuçovës është ngritur memoriali kushtuar ing. Riza Fejzi Alizotit.

## **Në telefonin e shtëpisë në Camborne të Truros ra telefoni**

Në vitet e internetit, në mes të dekadës së dytë të rënies së diktaturës Alizotët në Shqipëri u lidhën me emisionin televiziv “Njerëz të humbur” dhe filluan të bien në gjurmët angleze të familjes.

Sipas Meri Lalajt, u desh sidomos këmbëngulja e Plarentit, të birit të Nezit, bijës së madhe të Riza Alizotit, i cili jetonte me bashkëshorten në Gjermani, që të mund gjithçka të kthjellohej.

Ai mësoi lajmin hidhërues se tezja e tij Diane Jacqueline Belkiz pati ndërruar jetë në vitin 2001.

Pastaj u vu në kërkim të fëmijëve të saj dhe një ditë në telefonin e shtëpisë në Camborne të Truros tingëlluan fjalët: “Zonjë, unë jam një shqiptar, por ne të dy kemi diçka të përbashkët: gjyshi juaj është edhe gjyshi im...”

Sipas Lalajt, “Në fillim ajo nuk po kuptonte dhe u përgjigj: “Ju lutem zotëri mos bëni shakara të tilla!”

Ai vijoi “Gjyshi im ka qenë Riza Alizoti...”

Asaj iu kujtua porosia e nënës në shtratin e vdekjes se “në Shqipëri kini kushërinj të afërt” dhe zonjës Jane i ra telefoni nga dora.

Duhej të kalonin disa çaste që ajo të mblidhte veten dhe të lajmëronte vëllain Nicholas në Birmingham. Kështu familjet u lidhën me njëra tjetrën, në fillim vetëm me telefonata.



Në Shqipëri nuk mendonin se brezi i tanishëm i Alizotëve në Angli do të dëshironte të takoheshin me njëri-tjetrin dhe të njiheshin nga afër, por ndodhi e anasjella. Më e gëzueshmja zgjidhje.

## **Të dua shumë!**

Sipas shtypit:

“Më 10 tetor 2008 në përvjetorin e ekzekutimit dhe ditëlindjes të Riza Alizotit, Bashkia e qytetit të Kuçovës e dekoroi “Qytetar Nderi” me motivacionin: “I jepet Zotit Riza Alizoti (pas vdekjes) për kontribut të veçantë në zhvillimin e industrisë së naftës në zonën naftëmbajtëse të Kuçovës.”

Kryetari: Artur Kurti dhe Kryetari i Këshillit Bashkiak: Arqile Mjeshtri.

Organizator i kësaj ceremonie kuptimplote ishte Zoti Shkëlqim Ago, i cili ka qenë i pari që ka përmendur në Enciklopedinë e Kuçovës emrin e ndaluar të Riza Alizotit. Nipi i Rizait, Semih Pashallari, zbuloi pllakën përkujtimore tek vendi ku u ekzekutua daja i tij, tani Martir i Demokracisë.

Aty u vendosën kurora dhe tufa lulesh edhe nga më e vogla Era, stërmbesa e Rizait.

Të ndarë nga jeta mizorisht prej regjimit komunist as Fejzi Alizoti, as biri i tij Rizai nuk kanë varre dhe nuk janë gjetur eshtrat e tyre, prandaj është një nder shumë i madh që i bën populli i Kuçovës Riza Alizotit, këtij inxhinieri të përkushtuar, duke e pranuar në truallin e qytetit të vet, duke i caktuar një vend ku mund të derdhësh dy pika lot e të vendosësh lule.

Në këtë ceremoni morën pjesë shumë qytetarë dinjitozë të Kuçovës pa dallime partiake si edhe Prefekti i Beratit, Zoti Thoma Rumnici.

Midis tyre ndodhej edhe mbesa e Rizait, bija e Xhekit, Zonja Jane, ardhur nga Anglia tok me vajzën Lucy dhe djalin Christopher posaçërisht për këtë rast dhe për të shpënë deri në fund amanetin e nënës të saj Xheki, e cila nuk mundi ta njohë babain.

Po të njëjtin fat pësuan të tre fëmijët e Rizait në Shqipëri.

Edhe ata u rritën pa e njohur atin, u mungoi tërë kohës dashuria e tij.

Lot dhe mallëngjim.

Tani Zonja Jane, e cila banon në Camborne tok me fëmijët e saj pikërisht aty ku zuri fill kjo histori dashurie, po përpiqet të mësojë gjuhën shqipe për të biseduar me të gjithë kushërinjtë e vet.

Dhe fjalja e parë që ka mësuar është: Të dua shumë!

## **Fitoi vetëm me një votë më shumë**

Më herët se të kryheshin këto ceremoni, madje një ditë para se këshilli bashkiak i qytetit të Kuçovës të mblidhej për të miratuar rivlerësimin e Riza Alizotit, Shkëlqim Ago piu një kafe me një mik të tij, i njohur si i majtë ekstrem.

Takimin ja kishte kërkuar ky i fundit.

Dhe shumë shpejt u kuptua përse.

Miku i tha se Shkëlqimi duhej të tërhiqej nga përpjekja e tij për ta rehabilituar Rizanë, madje këtë veprim duhej ta bënin edhe të 25 anëtarët e këshillit, të majtë e të djathtë së bashku.

Arsyen e shpjegoi prerë dhe me pak fjalë: Riza Alizoti nuk qe dënuar kot, por i pati kryer veprimet për të cilat akuzohej, përfshi edhe djegie pusesh.

Këto i kish pranuar vetë në gjyq.

Shkëlqimi u befasua nga kjo ndërhyrje dhe nuk e gjeti të udhës debatin se regjimet politike edhe gjyqet i manipulojnë.

U mjaftua t'i kujtonte bashkëbiseduesit se inxhinier Riza Alizoti në vitin 1937, kur tërë fshati i Kozares qe përmytur, për banorët e saj që punonin në naftë ai kish luftuar shumë me AIPA-n dhe më në fund u kishte siguruar nga një dëmshpërblim pension.

Por tjetri ishte i akullt.

Atëherë i ofroi mikut të vet të pinin nga një birrë.

Tjetri e mori si shenjë që ja kish dalë ta kthente mbrapsht ngjarjen e vlerësimit pozitiv të Alizotit, por Shkëlqimi i tha

se po e qeraste me një birrë sepse miku i tij enverist e kish zgjuar nga një gjumë i thellë.

Në të vërtetë deri ato çaste pati besuar se në mbledhjen e këshillit bashkiak nuk do të kish asnjë kundërshtim.

Por tani e pati zënë merakun.

Kur u nda me mikun e vet Shkëlqimi Ago telefoni kryetarin e Bashkisë, Artur Kurtin, dhe me pak fjalë i shpjegoi që në fillim parandjenjën e tij.

Arturi u trondit dhe po aq edhe u alarmua.

Tha se ato çaste ndodhej për punë në Tiranë, por do t'i linte të gjitha në mes e do të nisej drejt Kuçovës. Do t'i kapte anëtarët e Këshillit një për një, të mësonte çfarë mendonin.

Të nesërmen, kur u bë mbledhja, vlerësimi i inxhinier Riza Alizotit me titullin e qytetarit të nderit të Kuçovës, fitoi vetëm me një votë më shumë nga pjesa që nuk ishin dakord.

Këshilltarët refuzues, për arsye të ndryshme, qenë nga të gjithë krahët politikë.

## **Na solli dritë**

Memoriali në kujtim të vdekjes së Riza Alizotit u bë në të dalë të qytetit të Kuçovës, në vendin ku ishte hedhur trupi. Në një farë mënyre simbolikisht tek varri i tij.

Ku eshtra sidoqoftë nuk kishte.

Mendimi se ajo pllakë e lartë përkujtese, e mermertë, mund të vendosej edhe tek vidhi, ku u var, nuk fitoi konsensus.

Vidhi plak, për disa kohë edhe strehë e një klubi, qe rrënuar, kalbur dhe shkërmoqur.

Atje ku pati qenë ajo pemë shekullore u vendos vetëm një pllakë, ku me shkrim e fjalë të përmbajtura rrëfehej ngjarja e llahtarshme e varjes dhe e mbajtjes në litar për tre ditë.

Ndërkaq tek memoriali ndodhi të merrte fill dhe të përhapej një mesazh i gëzuar.

Midis qytetit të Kuçovës dhe fshatit në periferi, ku në mes të tyre rridhnin ujërat e përroit, para se të vendosej ai memorial, kishte një gjysmë rrugë të përbaltur dhe të errët.

Tani ajo, qoftë edhe thjesht e jo në të tërë gjatësinë saj, u shtrua dhe buzë saj u vendosën shtylla me llamba elektrike.

“Inxhinieri na solli dritë” thanë banorët e fshatit në periferi. Dhe e thonë edhe tani.

## Elegji

Nga Alma Zenellari  
Kushtuar Martirit të Demokracisë, Riza Fejzi Alizoti

Nën degët e një vidhi  
U drodhën ëndrrat dhe shpresa u var,  
U mbyllën sytë e një djaloshi,  
Sytë më të bukur ëndërrimtarë.

Rrënkuan thellë rrënjët nën tokë,  
Kur frymën e fundit mbi degë lëshoi,  
I mblodhi krahët vidhi i madh,  
Dhe nën qepalla, loti pikoi.

Dhe nën dritare pikoi loti,  
Kuçovës sytë me tmerr ia lanë,  
Kur mbylli sytë Riza Alizoti,  
Edhe strehët e shtëpive fshehtas qanë...

Sa kohë, sa kohë u bënë  
Që s'kemi folur, që s'jemi parë,  
Qante për ty e zeza nënë,  
Ti si të tjerët s'pate një varr...

As fjalë, as këngë, as kumtesa s'kanë vend,  
Veçse një shenjë, veçse një gjurmë,  
Një pllakë me germat e emrit tënd,

Mbi varrin tënd, të biem në gjunjë.

Të themi fjalët që dot s’ti thamë,  
Të zgjojmë një ëndërr, të zgjojmë një shpresë.  
Një shpresë që vitet na e vodhën,  
Të derdhim lotët që nëpër vite,  
Fshehur në zemra, për ty i mblodhëm.

Thonë, si i gjallë, vidhi rënkoi,  
Se dridhmën e fundit mbi të la një burrë,  
Rënkoi në mote, më s’gjelbëroi,  
E degë e syth s’lulëzoi më kurrë.

Le të jetë ky vend prelud i lumturiisë,  
O hyjnor i demokracisë,  
Muajt, vitet shkojnë e vijnë,  
Njeriu për njerinë ka veç Mirësinë.

Kuçovë, 3.10.2008